



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 01/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 28.01.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së parë të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 28.01.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës së Junikut z. Agron Kuçi, Nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandantin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it, Drejtorët e

Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
6. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
7. Dardane Shala – anëtare, AAK
  
8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
11. Edona Shehu – anëtare, LDK
12. Lulzim Gacaferi – anëtar, VV
13. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
14. Kreshnik Maloku - anëtar, PDK
15. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur



## Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018,
4. Fillimi i procedurave për hartimin e planit zhvillimor komunal dhe hartës zonale,
5. Fillimi i procedurave për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,
6. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim rendin paraprak të dite dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet, gjatë kësaj kohe kam pranuar edhe raportin e punës së panelit përzgjedhës të komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, e hedh në votim edhe këtë pikë fillimi i procedurave i komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, kush është për, konstatoj se me 11 vota për, 1 kundër, 3 abstenime hin kjo pikë. Me të njejtat vota 11 për, 1 kundër, 0 abstenime miratohet komplet rendi i ditës.

### I

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z. Zenel Maloku: mua nuk mu ka shkru kur kam thënë më vjen keq për zotëri Hebibi, për punën e pronës se këtij ju ka uzurpu prona në pushtetin e kaluar një kohë të gjatë dhe ju ka duft me e ble për së dyti herë, kam thënë që e ka hijeshu vendin me atë objekt dhe është mirë me e votu, nuk mu ka shkru krejt fjala, kam thënë që ne duhet me qenë të kënaqur që e ka marrë prapë pronën e vet. Mundet me ndodh këto sene, delegati çka të fol duhet me u shkru a është privat e zyrtar duhet me u shkru

z. Muharrem Krasniqi: duhet të shikohet kjo, a ka dikush diçka tjetër

z. Tahir Isufaj: unë kam kërku, se ju çdo herë thoni veç edhe një kriter se ne jemi të parët, nuk e di si po ju dalin ato raporte më të mirat, kam thënë që kërkesa kryesore për Komunën e Junikut është emërtimi i rrugëve dhe shesheve, pse nuk është kry deri më tani, sipas të gjitha gjasave ju jeni të fundit

z. Muharrem Krasniqi: nuk tu ka shkru fjala a

z. Tahir Isufaj: jo në rregull është, por përgjigje po du

z. Muharrem Krasniqi: këtë në të ndryshme e diskutojmë, diçka tjetër për procesverbal, nëse jo e hedhi në votim dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

### II

## 2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018

z. Muharrem Krasniqi: punët që i kemi arritur janë të dhëna në mënyrë tabelare, janë kalu 4 rregullore të cilat i keni të cekura aty, kanë kalu 41 akte tjera aktvendime, si kuvend i kemi mbajtur 11 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje solemne, Kryetari i Komunës dy herë në vit ka raportu para Kuvendit, i ka mbajtur dy mbledhje me qytetarë

znj. Behare Qestaj: përshëndetje për të gjithë, në të përgëzojmë kryesues për punën që e ke bërë në këtë raport dhe jemi për miratimin e këtij raporti, këtij raporti i mungojnë trupat ndihmës të këtij kuvendi, e ke cek edhe ti, është mirë që në raportet tjera e kam thënë edhe në KPF që është mirë me ju bashkangjitë edhe raportet e komiteteve ndihmëse, të jemi të njoftum si anëtarë të kuvendit çka po ndodh në këto komisione

z. Tahir Isufaj: nuk kam ndonjë vërejtje, por te tabela kam pas vërejtje edhe në KPF, më intereson nafta për ngrohje dhe derivate për gjenerator pse këtu

z. Muharrem Krasniqi: janë të bartura nga Kuvendi, sepse ka qenë e nevojshme me u shfrytëzuar mjetet për ngrohje dhe gjenerator

z. Tahir Isufaj: këtu po bëhen ato keqpërdorimet që po i lypim ne kush po i shpenzon edhe nuk po dihet nga cila vi po shkojnë mjetet

z. Muharrem Krasniqi: për këto janë nga vija ime, i kam nënshkruar unë për tjerat i pyet tjerët, ne e bëjmë ngrohjen në shkollë, në qkmf dhe komunë për litra nuk i kam matur, më kanë thënë a bën me na i jap këto mjetet mos me shku huq, ju kam thënë po

z. Tahir Isufaj: ato edhe nëse nuk janë shpenzuar është meritë e atyre që e kanë udhëhequr kuvendin, ti që nuk ke bo shpenzime, kjo është një keqpërdorim sepse populli i shfrytëzon

z. Muharrem Krasniqi: sipas jush është, sepse populli është ka i shfrytëzon në shkollë dhe qkmf, a ka dikush

z. Lulzim Gacaferi: me fal te lutem, a e ke definuar këto shpenzime 1581 euro, për cilin objekt janë nda decidivisht

z. Muharrem Krasniqi: të gjitha objektet ngrohen me naftë, këto merren prej një buxheti, është një kod aty

z. Lulzim Gacaferi: po, por për cilin objekt është fjala saktësisht, QKMF, shkollë apo cili, te drekat zyrtare 214 euro cilat janë ato dreka zyrtare, ne që jemi që një vit këtu nuk kemi qenë në dreka zyrtare

z. Muharrem Krasniqi: ato dreka i kam bërë unë, ua kam kthyer përfaqësuesve të Drenicës, me rastin e përvjetorit të dëshmorit Bashkim Leku, kanë qenë 60-70 persona ua kam qitë nga një pije jo drekë, një drekë e kam me DEMOS-in, që na ka ndihmuar në përpilimin e planeve dhe një drekë e kam pasur me përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës që kanë ardhë me e kqyrë punën tonë.

z. Lulzim Gacaferi: edhe te shpenzimet e telefonit janë 361 euro, ju e dini nga posta që i bëjnë ofertat është më duket dikur 80 euro oferta, është mirë me i kursy ato para

z. Muharrem Krasniqi: nuk i di unë ofertat, këtë ofertë që e ka Komuna dy telefona paguhen nga zyra ime, nëse nuk ka dikush diçka tjetër e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 6 abstenime kalon raporti i punës së kuvendit komunal.

### III

#### 3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete

z. Muharrem Krasniqi: fjalën e ka kryesuesja e këtij Komiteti znj. Dardane Shala

znj. Dardane Shala: përshëndetje për të gjithë, Komiteti për Komunitete për vitin 2018 ka pasur gjithsej 4 anëtarë, 2 femra dhe 2 mashkuj, kanë qenë një anëtarë nga AAK, PDK, VV dhe një i pavarur, ndërsa nga LDK ka munguar. Në vitin 2018 në përgjithësi kemi bërë një punë të arsyeshme që ka të bëjë me diskriminimin e komuniteteve, pasi që në Junik nuk kemi komunitete, pra 100% janë Shqiptaro- Ilir dhe çështjet që i kemi trajtu nuk janë lidhë ndoshta me atë pikë, por prapë jemi mundu që të lidhemi me sigurinë e qytetarëve të Junikut dhe përkrahjen e komuniteteve të tjera, prioritet kanë qenë shkollat, nxënësit i kemi marrë si pikë primare, gjithashtu edhe sigurinë në Junik. Besoj aktivitetet i keni lexuar edhe te raporti i punës, nëse dikush ka ndonjë pyetje jemi të hapur për përgjigje.

znj. Behare Qestaj: ne si grup nuk kemi vërejtje rreth këtij raporti, e përgëzojmë kryesuesen për punën e bërë

z. Tahir Isufaj: mbledhja e katër e rregullt datë 24.10.2018 është një pikë informatë lidhur me ndriqimin publik në Komunën e Junikut, çfarë teme është kjo për këta, pastaj mbledhja e gjashtë e rregullt, sukcesi dhe realizimi i planit shkollor me rastin e përfundimit të gjysëmvetorit të parë të vitit shkollor, po kalojnë në drejtori të Arsimit, informatë rreth punës së performancës së punëtorëve të mirëmbajtjes së higjienës në shkollë, informatë rreth disponimit të mjeteve për funksionimin e rregullt të mësimi, këto nuk duhet me qenë këtu

znj. Dardane Shala: siç e ceka edhe më herët, siç është e përshkruar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Komiteti për Komunitete e ka për detyrë me trajtu çfarëdo lloj çështje që ka të bëjë me diskriminimin e personave mbi çfarëdo lloj baze etnike dhe me çdo interes të komunitetit dhe pasi ndriqimi publik është i vetmi aspekt ose arsye shumë e fortë që të merremi me këtë çështje sepse nëse nuk ka ndriqim atëherë nuk ekziston as siguria dhe po lidhem prapë te siguria jonë si qytetarë e sidomos tek pjesa kryesore që janë fëmijët, unë jam vet qytetare e Komunës së Junikut dhe e kam pa si pengesë dhe kam pasur kërkesë edhe nga anëtarët e Komitetit që me ndërmarrë masa, pasi kemi pas probleme me ndriqimin publik në disa pjesë. Po ashtu sa i përket mbledhjes së gjashtë, sukcesi dhe realizimi i planit shkollor me rastin e përfundimit të gjysëmvetorit të parë, kjo është një pikë shumë e rëndësishme, pasi nuk kemi minoritete jemi fokusuar kryesisht në këtë komunitet dhe për këtë arsye është trajtu si temë.

z. Zenel Maloku: po du me e bërë një sqarim rreth deklaramit të Dardanës, tha për një delegat ka mungu në komitet për komunitete, ai nuk ka mungu, por nuk është i caktuar, këtu ta bëjmë dallimin, nuk ka pas qysh me ardhë kur nuk ka qenë i caktuar

znj. Dardane Shala: nëse një përfaqësues nga LDK, kish qenë më herët, kish me qenë më mirë dhe më e arsyeshme sepse ndoshta dikush nga ta kish pas ndonjë mendim më të mirë për me e qitë ndonjë pikë tjetër në rendin e ditës

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 6 abstenime kalon

#### IV

4. Fillimi i procedurave për hartimin e planit zhvillimor komunal dhe hartën zonale të Komunës

z. Muharrem Krasniqi: sipas kërkesës së Drejtorisë për Urbanizëm përmes Kryetarit të Komunës, fjalën e ka drejtori Hasan Krasniqi

z. Hasan Krasniqi: siç e dini Komuna ka një plan zhvillimor komunal të mirë, ka edhe planin rregullues urban dhe planin zhvillimor, për një pjesë të konsiderueshme të Komunës së Junikut, por me miratimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor në vitin 2013, është dal nevojja dhe kërkesa që komunat të hartojnë planet zhvillimore komunale, hartat zonale dhe plane të detajuara që janë në përputhje me ligjet e reja. Ne kemi pas kërkesë prej inspektorëve të Ministrisë së Ambientit, kemi planifiku herët me u marrë me këtë çështje, mirëpo në mungesë të mjeteve nuk kemi mundur më herët me e pru këtë pikë të rendit të ditës, tash kemi siguru një donacion nga DEMOS për hartimin e këtij projekti, projekti kap shumën dikun 25,000.00 Euro dhe e kemi pa të arsyeshme që këtë kohë të meret vendimi për fillimin e planit zhvillimor komunal dhe hartave zonale.

znj. Behare Qestaj: sa i përket hartimit të planit zhvillimor komunal dhe hartës zonale, ne si grup e përkrahim fillimin e procedurave për këtë pikë, meqenëse është e nevojshme për Komunen e Junikut.

z. Tahir Isufaj: unë mendoj që më parë kish qenë mirë një takim me qytetarë, që me u njoftu qytetarët çka po planifikohet, të dihet në vija të trasha

z. Muharrem Krasniqi: unë besoj që kjo do të jetë pjesë e fazave të mëvonshme të planit, gjatë zhvillimit të planit qytetarët do ta kenë mundësinë e dëgjimit publik, ne kemi edhe dy herë me e votu këtë plan parakrakisht dhe pasi të bëhet dëgjimi, kjo është vetëm për fillimin e procedurave.

z. Hasan Krasniqi: është obligim ligjor, ne duhet të fillojmë me procedura , mandej ka me e pas leximin e parë si draft dokument, ka me pas debat me qytetarë, takime të ndryshme , nëse kuvendi e sheh të arsyeshme mund të zgjaten debatet e fundit ka me qenë vota e kuvendit me të cilën do të kalojnë këto plane.

z. Lulzim Gacaferi: a keni caktuar ndonjë grup të ekspertëve për këtë plan

z. Hasan Krasniqi: do ti nënshtrohet një tenderi , do të jetë një kompani e licensuar e cila e fiton tenderin ajo ka me e bo punën kryesore, duke i marrë parasysh debatet me qytetarë



z. Zene1 Maloku: ne këto punë kemi me i bërë dert edhe në të ardhmen, secili qytetarë ka me pas mundësi me qenë i pranishëm në debate

z..Hasan Krasniqi: patjetër, sepse nga kjo varet zhvillimi i Komunës së Junikut për 10 vitet e ardhshme

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

## 5. Fillimi i procedurave për themelimin e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara

znj. Sindije Idrizi: përshëndetje për të gjithë, raporti lidhur me përzgjedhjen e komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Junikut. Pas publikimit të konkursit me datë 06.12.2018 dhe mbylljes së afatit të konkurrimit, bazuar në ligjet në fuqi, Komuna e Junikut ka themeluar panelin përzgjedhës me këtë përbërje:

- Sindije Idrizi – Kryesuese e panelit, këshilltare e kuvendit nga AAK-PDK,
- Venera Shala – aëtare e panelit nga ekzekutivi,
- Nezir Shehu – anëtar i panelit nga OJQ-të,
- Betim Gacaferi – anëtarë i panelit, këshilltar i kuvendit nga AAK-PDK,

Intervista është mbajtur me 10.01 2019 në Komunën e Junikut, paneli përzgjedhës për themelimin e anëtarëve të komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara i formuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut, ka bërë rekrutimin dhe përzgjedhjen me datë 10.01.2019 me proces të rregullt të përzgjedhjes dhe rekrutimit. Paneli konstaton se janë pranuar 7 aplikacione për komitetin konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa 7 kandidatë janë ftuar në intervistë me gojë me datë 10.01.2019 dhe kanë plotësuar kriteret sipas konkursit. Paneli intervistues i propozon Asamblesë Komunale emrat prej 7 anëtarëve për komitetin konsultativ për personat me aftësi të kufizuara këta janë:

2. Mehdi Kuqi,
3. Florijana Shala,
4. Esat Hoxha,
5. Aida Zeqaj,

6. Arbësa Llojuni,
7. Xufë Jasiqi,
8. Edonjeta Kuqi.

Dua ta cekë se një anëtar i LDK-së ka mungu, sepse nuk e kanë sjellë emrin z. Tahir Isufaj e ka propozu një anëtarë në KPF, mundet me e cek edhe tash

znj. Behare Qestaj: ne e përkrahim këtë pikë

z. Tahir Isufaj: nuk kemi diçka kundër

znj. Luljeta Jasiqi: a është vetëm një përfaqësues prej dy subjekteve opozitare apo qysh, tjerët përfaqësues qenkan të Aleancës

z. Muharrem Krasniqi: po e kemi kalu si vendim dy subjektet e keni pas një emër, nuk e keni sjellë

znj. Erleta Isufaj: unë po lidhem te kjo pjesa që, duke u bazuar në ligjet në fuqi, zakonisht duhet me e gjetë bazen juridike ose ligjore dhe të specifikohet saktë, sepse ligje në fuqi ka shumë dhe është mirë me e ditë secili prej nesh për cilin ligj po bëhet fjalë dhe me e pa a është në përputhje me atë ligj. Ju kisha rekomandu për çdo rast tjetër ligjet, pra baza ligjore duhet me u cek.

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim, dhe konstatoj se me 10 për, 1 kundër, 4 abstenime kalojnë këta emra në këtë komitet.

## VI

### 6. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: në mbledhjen e KPF, z. Tahir Isufaj ka propozu që z. Sadri Krasniqi të jetë anëtarë i Komitetit për Komunitete nga LDK, e keni mangu edhe në emërtimin e rrugëve ju lutem ti sillni emrat

z. Luljeta Jasiqi: a mundemi ta propozojmë emrin për komitetin për aftësi të kufizuara, e propozoj Fitim Pepshin

z. Zeqë Hebibi: a duhet me qenë i kuvendit a

z. Tahir Isufaj: Xhavit Velijaj për komisionin e rrugëve për arsye sepse ka qenë edhe më herët anëtarë

z. Lulzim Gacaferi: emrin tonë e keni marrë apo

z. Muharrem Krasniqi: po, tash në komitetin për komunitete është Sadri Krasniqi, në komisionin për panelin përzgjedhës për komitetin konsultativ të personave me aftësi të kufizuara është Fitim Pepshi, në komisionin e rrugëve është propozu Xhavit Velijaj, i hedh në votim këta emra dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime dhe plotësohen edhe këto tri komisione

z. Tahir Isufaj: pse nuk është kryer emërtimi i rrugëve deri me tash

znj. Leonita Jasiqi: me vendimin e Kuvendit Komunal është formu komisioni për emërtimin e zonave të qarkullimit publik, komisioni është takuar disa herë dhe është duke e bërë punën e tij, besoj që shumë shpejt do ta sjellim punën në kuvend. Ne ju kemi dërgu disa herë ftesë LDK-së që ta sjellin emrin deri me sot nuk e kanë sjellë, se shpejti do ta sjellim punën e komisionit në kuvend.

z. Lulzim Gacaferi: kur është mbajtur takimi sepse unë nuk kam marrë asnjë ftesë

z. Muharrem Krasniqi: e ke pas nga unë ftesën unë e kam thirr mbledhjen konstituive

z. Lulzim Gacaferi: nga kush e kam marrë ftesën, unë nuk kam asnjë ftesë për këtë komision, me ma pas dërgu ftesën kisha marrë pjesë

z. Muharrem Krasniqi: me ke thënë mos i qit në gjysëm të mujit sepse nuk mund të vi dy herë, për këtë komision ka qenë fjala

z. Lulzim Gacaferi: po kemi qenë me Zeqë Hebibin në zyre tënde, por nuk kam marrë kurrfar ftese

z. Zeqë Hebibi: nuk ka marrë ftesë, unë e kam lajmëruar

znj. Leonita Jasiqi: tash e tutje personalisht do të kujdesna që ftesat të arrijnë në vend të secili

z. Zenel Maloku: është mbajtur vetëm një mbledhje

z. Lulzim Gacaferi: ju e keni zyrën e Levizjes Vetëvendosje përballë Komunës, Email adresën time, numrin tim të telefonit i keni tri alternativa njëërën duhet ta shfrytëzoni. E kam edhe një pyetje për Drejtorin e Arsimit, a keni parapa ndonjë alternativë për mosfunksionimin e arsimit që fëmijët tanë kanë mbetë pa mësim që disa javë, meqenëse i kuptoj arsimtarët që janë të diskriminuar nga Qeveria e Kosovës, por dihet që fëmijët duhet ta vijnë në mësimin

z. Fatos Shala: duke e parë situatën në të cilën jemi, përveç arsimtarëve ka edhe tjerë që kanë nevojë për kushte më të mira, ne jemi duke bërë përpjekje pa presion që ti bindim arsimtarët dhe sindikatën që me gjetë alternativa dhe forma tjera të protestës që mos me e pengu procesin e mësimin, sepse po na brengos shumë që fëmijët kanë mbetë pa mësim. Duhet bashkëpunim edhe me MASHT-in dhe Kryetarin e Komunës dhe me e bo një zgjidhje, shpresojmë që deri me datën 31 kur përfundon çështja e këtij ligji për pagat të bëhet një zgjidhje

z. Lulzim Gacaferi: dmth deri me datën 31 duhet të presim, këtu duhet të gjindet një alternativë që nxënësit mos të mbesin pa mësim, ka profesora vullnetarë që mundën me jep mësim

z. Zenel Maloku: për drejtorin e urbanizmit, a e kanë qitë në tender hala çështjen e kyqjeve të krojeve nalt në Gjocaj në rrugë atje, për me i rregullu apo nuk e kanë qitë hiç. Qysh e kanë parapa këtë punë apo e kanë parapa me e lënë qashtu

z. Hasan Krasniqi: kyqjet e krojeve nuk i kemi qitë ende, kemi marrë zotim që kemi me e kry atë punë, në tenderin që e ka Ministria për hapjen e rrugës Gjocaj – Livadhi i madh, ende nuk ka përfundu ende është vendpunishte e tyre, në momentin që e kemi mundësinë financiare dhe ligjore pasi ta kryejnë ata pjesën e vet, ne në paramasë e kemi parapa një pjesë kur jemi dal në terren e kemi pa që nuk e kanë kry krejt, nuk e kemi ditë që janë aq shumë, besoj që në pranverë ka me u rregullu

z. Zenel Maloku: dmth nuk keni datë të caktuar, me thënë deri në këtë datë kryhet, për këtë po pyes sepse veç me fjalë është sikur me ti lyp 100 euro hua por datë mos me tregu kur i kthen

z. Hasan Krasniqi: nuk dua të më keqkuptohet deklarata, ju jemi mirënjohës shumë qytetarëve të Gjocaj dhe Jasiqit për kontributin që e kanë dhënë në ndihmën për hapjen e rrugës Junik – Gjeravicë, kanë lëshu prona private i kemi lënë pa ujë sa e sa kohë, Kryetari ka thënë që kemi me i rregullu dhe do të rregullohet, kushtet nuk e lejojnë tash me u kry



z. Zenel Maloku: jo për tash jeni të falur

z. Lulzim Gacaferi: e kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike por na iku, ndoshta ja përcjellni ju tjerët, kam ardhë që një javë nga Gjermania çdo ditë i frekuentoj lokalitetet e mbyllura edhe me familje por edhe me shoqëri, e kam parë që është një e keqe që është duke ju ndodhur fëmijëve tanë, njerëzve tanë, sepse në këto lokalitete konsumohet cigarja, alkooli dhe gjërat tjera, meqenëse qenka edhe Komandanti i Policisë këtu, është e pakuptueshme nëse ne shkojmë në lokale brenda futemi me familje dhe ka asni ambienti, drejtori i shërbimeve publike e ka për obligim ti dërgon inspektorat që e ka këtu pas neve, të cilët rrijnë çdo ditë i frekuentojnë lokalitetet në qendër të Junikut, dhe nuk e bëjnë punën e tyre, ashtu edhe policia e konsumojnë duhanin dhe alkoolin në orar e kam dëshmi mundem tua tregoj edhe fotot, kjo veti negative me të vërtetë është e pa pranueshme, kërkesa ime nga ju kryesues është që tja përcjellni drejtorit z. Myrtë Velijaj që tna sjell raport me shkrim. Sipas neve Levizjes Vetëvendosje qendra në Junik duhet të merren masa ndaj lokaliteteve që e përdorin cigaren dhe gjërat tjera negative dhe e shkelin ligjin

z. Tahir Isufaj: qikjo rënia e borës veç fati që u ndal, se pat me na blloku krejt hala trotuaret janë të mbyllne, mirë që nuk na ndodhi naj fatkeqësi përndryshe asnjë trotuar nuk është i qelur, a është dikush që duhet ti kryej ato punë

z. Zenel Maloku: unë mendoj që trotuaret duhet me i qel me kaci, për rrugë kamioni i ka qel, a për trotuare e di që vetem me kaci qelen, kush është i caktum me i qel trotuaret nuk e di

z. Lulzim Gacaferi: deshta ta bëj një sqarim të vogël rreth meje dhe juve kryesues i nderuar, mos prezenca ime në seancat e kaluara është për arsye se nuk kam mujt me marrë pjesë për arsye shëndetësore, ju kam dërgu një vërtetim, po ashtu kemi bisedu përmes telefonit. Ligji e thot qartë se nëse një asamblesit nuk merr pjesë 3 herë radhazi pa arsye në mbledhje e humb mandatin, kështu që unë e kam pasur një arsye edhe pse më nxerre aq shumë probleme, ma lype një vërtetim shtesë, e dërgove landen, e shkele kodin e etikës së punës, e kërkuat diagnozen se çfarë sëmundje kisha

z. Muharrem Krasniqi: jo, mua më ke thënë kam qenë smut pasi është kry mbledhja, sepse kam mendu që nuk po don me ardh. Nëse në bazë të ligjit një person nuk merr pjesë në tri mbledhje pa informu, qe psh ka mungu znj Erleta niher ka dhe lajmëruar është me arsye, unë në ato raste jam i obliguar me ta dërgu me shkrim pse nuk ke qenë në mbledhje dhe gjithë atë çka thua ti unë duhet me ja dërgu përfaqësuesit të KQZ-së në Junik.

z. Lulzim Gacaferi: po e kanë kërku diagnozën, i dërguari i juaj i KQZ-së, unë ua kam dërguar juve vërtetimin e mjekut me datë 28.12.2018, ligji e thot fare qartë se edhe 8 ditë pas mbledhjes së fundit që përfundon ajo procedura, unë e kam të drejtën legjitime ta bëj një ankesë

z. Muharrem Krasniqi: ti ankesen e bën kur të vjen vendimi, nëse të vjen negativ. Ti ke mungu tre mbledhje radhazi, e kam pasur obligim ligjor me tu drejtu ty me shkresë arsyen pse ke mungu, ti ma ke kthyer shkresën une me gjithë shkresën tënde me të gjitha dokumentet i kam dërgu sipas ligji në KQZ

z. Lulzim Gacaferi: unë ta kam dërgu me datë 28.12.2018 vërtetimin, mos e shtramo temën, nuk ke pas nevojë me më nxerrë probleme, ti nuk je ai njeri që mke sjellë mu këtu, as nuk mundësh me më hek

z. Muharrem Krasniqi: unë e kam kry vetëm një procedurë ligjore që më takon, nëse nuk keni diçka tjetër me kaq e mbylli këtë mbledhje

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:00

Procesmbajtës:  
z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues i Kuvendit:  
z. Muharrem Krasniqi

---



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 02/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 28.02.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dytë të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 28.02.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik.Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës së Junikut z. Agron Kuçi, Nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandatin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it,

Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
6. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
7. Dardane Shala – anëtare, AAK

Mungoi: Edona Shehu –anëtare, LDK

8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
11. Lulzim Gacaferi – anëtar, VV
12. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
13. Kreshnik Maloku - anëtar, PDK
14. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur

z. Muharrem Krasniqi: Këtë mbledhje e hapi me një minut heshtje në nderim të jetës dhe veprës së Dr. Abaz Krasniqi, i cili sot gjatë ditës ka ndërru jetë, e i cili ka punuar në QKMF në Junik.

znj. Edona Shehu më ka njoftuar që nuk mundet me marrë pjesë sot, për arsye familjare

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Propozim (vendim) për themelimin e komisionit komunal për ndarjen e bursave për studentë,
3. Raporti vjetor financiar për vitin 2018,
4. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: Përveç këtij rendi i kemi edhe 4 pika tjera material shtesë, sipas rregullores së pari kalohet rendi i ditës paraprak, pastaj për secilën pikë veç e veç votohet pa diskutime dhe pastaj pikat që kalojnë shtohen në rendin e ditës i cili votohet. A keni diçka me shtu për rendin e ditës paraprak.

Znj. Behare Qestaj: ne pajtohemi me këto pika të rendit të ditës

z. Tahir Isufaj: pa i votu ne dhe pa i shiku nuk votohen këto pika, është material shumë i gjerë, kemi nevojë me e shiku, me rendin paraprak pajtohemi por këto shtesë duhet shikuar, thirrre një seancë të jashtëzakonshme

z. Lulzim Gacaferi: ashtu siç tha profesori, pajtohemi me të

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim rendin e ditës pa pika shtesë dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet. Tani vazhdojmë me pikat shtesë:

1. Kërkesë e kompanisë Juniku, SH.P.K. për leje ujore, drejtori që e ka paraqitë kërkesën të na sqaroj për çka është fjala

z. Tahir Isufaj: ne nuk jemi të përgatitur për këtë, nëse doni e lëshojmë tash mbledhjen

z. Muharrem Krasniqi: në rregulloren e punës së kuvendit neni 3.6 pika 2, 3.7 pika 1

z. Tahir Isufaj: me qenë urgjent po, por kjo nuk është, ju po e dini si është situata e votave

z. Muharrem Krasniqi: këto kërkesa këta i kanë paraparë, ne i shqyrtojmë ose i hedhim poshtë ose i votojmë

znj. Erleta Isufaj: nuk mundemi me shku me votim në këtë pjesë, kur është gjithë ky material dhe ne për 5 minuta para mbledhjes me e shqyrtu, këtu ka shumë aspekt ligjor që duhet të trajtohet dhe që për neve nuk duhet me u trajtu sot si rend i ditës, nëse i keni votat me e kalu e i përdorni nuk është në rregull

z. Tahir Isufaj: pasi e keni vendos kështu ne po dalim e ju merni vendim

z. Muharrem Krasniqi: kështu e përcakton rregullorja ju lutem

znj. Erleta Isufaj: nuk është në rregull kështu, nuk është në rregull që e shfrytëzoni rregulloren në këtë mënyrë, dhe po e interpretoni kështu, nuk bëhet interpretimi kështu vetëm për pelqimin e 10 personave, sepse kjo është për krejt qytetarët e Komunës së Junikut. Është mirë me u trajtu më herët, jo 5 minuta para se me fillu mbledhja.

z. Muharrem Krasniqi: mundemi me ju jep kohë shtesë, nëse ju duhet

z. Tahir Isufaj: jo nuk kemi nevojë për kohë shtesë

z. Lulzim Gacaferi: a bën këtë temë me e trajtu në një ditë tjetër dhe me bisedu për të

z. Muharrem Krasniqi: e kanë pru për këtë ditë, është me rregullore që ka të drejtë Kryetari i Komunës apo Drejtorët me pru pika shtesë

z. Tahir Isufaj: duhet 7 ditë përpara me e pru, nuk kanë drejtë krejt pikat e gjithë vitit me i mbledh

znj. Erleta Isufaj: a është kjo e drejtë 5 minuta para mbledhjes a?

z. Muharrem Krasniqi: ne do të votojmë për këto pika

znj. Erleta Isufaj: po votoni se e dini qysh është puna e votave, jeni duke i shfrytëzu mundësitë e juve

z. Lulzim Gacaferi: pse e keni pru këtë material me vonesë, me e pru me kohë me e shqyrtu dhe me e pa se çka është puna e atij materiali, së pari nuk e dijmë kush është firma, kush është pronari, nuk po e dijmë për kënd po folni, të jetë një raport në detale

z. Zeqë Hebibi: nëse nuk lejohet diskutimi nuk marrim pjesë,

me këtë rast asambleistët e LDK-së e lëshuan mbledhjen e kuvendit.

z. Leonard Lolluni: operatori ekonomik SH.P.K. Juniku, ka bërë kërkesë pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik për me e marrë një vendim paraprakisht për leje ujore. Ky operator është që ka kontratë me Komunën që është duke investuar në fabrikën e langjeve dhe të ujit për ambalazhim. Ky operator në bazë të kontratës së ka me Komunën i ka tejkalu të gjitha pritshmëritë që ka pas me investu, e ka tejkalu edhe investimin që e ka pas me kontratë, ka ardhë në përfundim që thelbësore e ka ujin për me e bërë ambalazhimin e ujit, operatori nuk mundet me pritë edhe një muaj mbledhjen e asamblesë e me u blloku krejt investimi në fabrikë, sepse ky operator po don qysh në fillim të majit me fillu me procesu me ujë dhe me gjeneru vende të reja të punës. Ne si drejtori nuk kemi mundur me i jep leje direkte pa kalu në kuvendin komunal sepse ky ka me vazhdu hapat e mëtutjeshëm me shku në Ministri të Mjedisit dhe me u pais me leje ujore, ky është hapi i parë që ka me e marrë operatori.

z. Muharrem Krasniqi: kush është për me hi kjo pikë në rend dite, konsta toj se në sallë janë 11

anëtarë, dhe me 9 vota për, 0 abstenime, 2 kundër, kalon

z. Lulzim Gacaferi: kundër jam si është ardhë materiali, jo kundër kompanisë

z. Muharrem Krasniqi: 2. pika e dytë e materialit shtesë është kërkesa për miratimin e emrave të propozuar nga komisioni komunal për emërtimin e zonave të qarkullimit publik

znj. Leonita Jasiqi: meqenëse jemi vonu në këtë proces dhe është kërkesë e vazhdueshme sidomos e grupit parlamentar të LDK-së, sot komisioni ju ka drejtu juve me një propozim-vendim të cilin do ta sqarojmë më tutje nëse votohet si pikë

z. Muharrem Krasniqi: kush është me hi kjo pikë në rend dite, konstatoj se me 9 vota për, 2 kundër, 0 abstenime kalon, 3. pika e tretë e rendit të ditës është kërkesë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër në objektin e administratës së Komunës së Junikut me qëllim vendosjen e bankomatit

z. Hasan Krasniqi: i kemi pa shqetësimet e qytetarëve që në mungesë të bankomateve të bankave të ndryshme për me terhek mjete, po duhet me shku në Deçan ose në Gjakovë, e kemi hulumtu tregun kemi parë që ka banka të interesuara që nëse ua lëshojmë me qera një hapësirë në objektin e Komunës e vendosin një aparat. Ligji e parasheh që duhet me u marr vendimi në kuvend, është vendimi i parë sot, landa pas përzgjedhjes së kompanisë ka me ardhë prapë në kuvend dhe ju keni me e votu sipas kriterëve të përcaktuara

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon, pika e 4. Kërkesë për ndryshimin, plotësimin e vendimit nr 02/31 të datës 31.10.2018

z. Hasan Krasniqi: këtë pikë e kemi pas më herët, e kemi diskutu në KPF dhe këtu, gjatë ardhjes së materialit ka ardhë gabim vetëm numri i parcelës, është një parcelë që është përballë objektit të Qendrës për Punë Sociale, bëhet fjalë vetëm për ndërrimin e numrit të parcelës dhe sipërfaqes, i njejtë vendim mbetet vetëm ndryshohen këto

z. Lulzim Gacaferi: pse nuk e kemi këtë material

z. Muharrem Krasniqi: është vendimi për ndërtimin e qendrës shkencore, duhet të ndryshohet numri i parcelës dhe sipërfaqes, konstatoj se me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon. Pas aprovimit të këtyre ky është komplet rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Propozim (vendim) për themelimin e komisionit komunal për ndarjen e bursave për studentë,
3. Raporti vjetor financiar për vitin 2018,
4. Kërkesa e kompanisë Juniku Sh.P.K për leje ujore,
5. Kërkesë për miratimin e emrave të propozuar nga komisioni komunal për emërtimin e zonave të qarkullimit publik,
6. Kërkesë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të hapësirës në objektin e administratës së Komunës së Junikut, për vendosjen e bankomatit,
7. Kërkesë për ndryshim-plotësimin e vendimit nr.02/31 të datës 31.10.2018,
8. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: kush është për këtë rend dite, konstatoj se nga 11 prezent, 9 janë për, 2 kundër, 0 abstenime kalon rendi i ditës.

#### 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush vërejtje për procesverbalin, konstatoj se me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon pa vërejtje

pika e dytë

#### 2. Propozim (vendim) për themelimin e komisionit komunal për ndarjen e bursave për studentë

znj. Leonita Jasiqi: me datë 12.02.2019, Kryetari i Komunës ju ka drejtu juve me një propozim-vendim për themelimin e komisionit komunal për ndarjen e bursave për studentë. Ky propozim vendim e ka bazën ligjore në përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 42 pika j të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 14 pika 1.1 të rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Siç jeni në dijeni kjo legjislaturë vitin e kaluar ka miratuar një rregullore për ndarjen e subvencioneve e cila rregullore përcakton procedurat e marrjes së vendimeve për subvencione, në nenin 7 pika 1 thuhet Kryetari i Komunës emëron komisione të përkohshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike. Pra Kryetari ka të drejtë të marrë vendime për themelimin e Komisioneve, por meqenëse ka shprehë dëshirën dhe vullnetin bashkëpjesëmarrës të këtij propozim-vendimi e ka sjellë këtë propozim vendim për ndarjen e bursave për studentë. Komisioni duhet të ketë 5 anëtarë dhe propozimet janë si në vijim:

2. Arten Hamza – anëtarë,
3. Artan Krasniqi – anëtarë,
4. Turim Ganijaj – anëtarë,

5. Artin Velijaj – anëtarë,
6. Burim Kuqi- anëtarë,

Znj. Behare Qestaj: ne pajtohemi me këtë pikë dhe këta emra

z. Lulzim Gacaferi: unë nuk kam personalisht kundër këtyre djemve diçka kundër, të gjithë janë djem të mirë, por qysh i keni prurë jam kundër

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim këtë pikë dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 2 abstenime kalon kjo pikë me këta emra

pika e tretë

### 3. Raporti vjetor financiar për vitin 2018

znj. Kosovare Gacaferi: drejtoresha prezantoi raportin vjetor financiar për vitin 2018, të cilin po ashtu e kishin para vetës asambleistët

z. Lulzim Gacaferi: i kemi lexu të gjitha në material nuk ka nevojë me i përsërit

znj. Behare Qestaj: nuk kemi vërejtje sot, çka kemi pas i kemi thënë në KPF

z. Lulzim Gacaferi: i kam disa pyetje për drejtoreshën, e kam vërejtur që nga viti 2017 në vitin 2018 e keni rritur konstatin për zyrën e Kryetarit 21,491.00 Euro, nga zyra e tij paga dhe medietje, te kuvendi

komunal i shoh këto shpenzime 8250 Euro çka është ky shpenzim, te zhvillimi ekonomik gjatë vitit 2018 ka pas një diferencë të madhe të shpenzimeve mbi 300,00.00 Euro, meqenëse e keni shenu në raport por nuk e keni specifikuar e detajuar për me e ditë une dhe qytetari i Junikut se ka janë shku ato para. Për shpenzime publike e kam ngrit 3-4 herë për te lumi erenik me i mbulu ato zgafella që janë bërë, po e shoh një shpenzim që nuk i ka bo nderë vendit tonë 10,356.00Euro kjo është me tepër sesa është bërë, sepse realisht me keqardhje e them se nuk është bërë asnjë punë nga drejtoria e shërbimeve publike, në kontest në shërbim të qytetarëve të Junikut, e kam ngritë dy herë temën për Myrtën dhe Kryetarin për lumin erenik deri me tani

z. Muharrem Krasniqi: të lutem kjo është temë tjetër nuk ka të bëjë me buxhet, këtë e diskutojmë te të ndryshme

z. Lulzim Gacaferi: te shpenzimet e zyrës së kryetarit më intereson pse në vitin 2018 janë 21,491 00 Euro më shumë sesa në vitin 2017, pra paga dhe medijtje, sa punëtor janë në kontratë në vepër apo ka janë shku këto para?

znj. Kosovare Gacaferi: nuk ka të bëjë me kontrata në vepër, janë tjetër kategori, për çdo vit rritet përvoja e punës, në bazë të pagës qysh e kanë

z. Lulzim Gacaferi: nuk i rrit ato zyra e kryetarit, është qeveria e vendit që i rritë pagat, këtu nuk është e specifikime nuk ka të dhëna kurgjo, janë shumë mbi 21,000.00 Euro dallim, këto janë para të Junikut. Po ashtu 8200 euro shpenzime të asamblesë, kryesues a po e sheh që menzi po flas nuk kam as ujë me pi, nuk je kon në gjendje nga një shishe ujë këtyre djemve e vajzave me na siguru

z. Muharrem Krasniqi: kemi ujë nga kroni nuk paguajm ujë sepse e kemi shumë të mirë të Junikut

z. Lulzim Gacaferi: unë e marr mundin dhe vi nga Gjermania këtu, ma keqperdore çka thash, respektoje qëndrimin tim, nuk jam nevojshem me ma ble ti një ujë, ka kan shku 8200 Euro të Kuvendit?

Znj. Kosovare Gacaferi: tregom në cilën faqe po e sheh

z. Lulzim Gacaferi: te shpenzimet e kuvendit komunal të vitit 2017 dhe 2018, ka ma pak shpenzime 8200 Euro që i kemi kursy e ka janë shku këto para

znj. Kosovare Gacaferi: ato kanë qenë të planifikuara aq, nuk bëhen këso krahasimesh, në shtator aprovohen e gjatë vitit shpenzohen

z. Lulzim Gacaferi: para kësaj mbledhje kam bërë pyetje ka kanë shku mjetet dhe kryesuesi më ka thënë kanë shku në derivate, janë shpenzu pikërisht nga këto asamble

z. Muharrem Krasniqi: po për 2018 kemi pagu derivate për nxemje është e vërtetë

pika e katërt

#### 4. Kërkesa e kompanisë Juniku – SH.P.K. për leje ujore



z. Lulzim Gacaferi: unë personalisht dhe si përfaqësues i grupit tonë, nuk jam kundër kompanisë, e mirëpres çdo investitor që vjen në këtë vend dhe investon edhe për intereson e vet personal, por edhe për të mirën e qytetarëve të Junikut, më vjen mirë që ka investitor, nuk ka diskutim për këtë, por unë jam kundër materialit që e keni pru me shumë vonesë, ju kisha lut juve dhe Kryetarit dhe të gjithëve ta shtyjme për mbledhjen e ardhshme, për seancën e ardhshme atëher e votoj me dy duart pa asnjë problem. Ne jemi pro investimeve, çdo njeri që është normal duhet të jetë pro investimeve, por nuk e keni pas nevojën me e pru ashtu fsheht në njëfar forme, u largun edhe anëtarët e LDK-së, nuk i bën nderë Junikut, as neve nuk na bën nderë, nuk duhet të jemi kundër njëri tjetrit, kisha propozu për seancën që vjen të jetë kjo pikë.

z. Muharrem Krasniqi: kjo ka hi në rend dite tashmë, e kisha lut edhe unë ekzekutivin që sa më pak të sjell kërkesa jasht rendit të ditës, e hedh në votim dhe konstatoj se 11 janë prezent, 10 janë për, 0 kundër, 1 abstenim kalon kjo pikë

pika e pestë

5. Kërkesë për miratimin e emrave të propozuar nga komisioni komunal për emërtimin e zonave të qarkullimit publik

z. Muharrem Krasniqi: në këtë komision LDK nuk ka dërgu përfaqësues, e kemi marrë vendim me ardhë Xhavit Velijaj, e kam me shkrim kërkesën e tij që ai nuk don me marrë pjesë

z. Lulzim Gacaferi: as Vetvendosja nuk ka pas anëtarë

z. Muharrem Krasniqi: po ke qenë ti, arsyeja pse është shpejtu ky proces është sepse Tahir Isufaj disa herë ka bërë kërkesë që të kryhet emërtimi

z. Lulzim Gacaferi: po, por a kam qenë në takime, nuk më ka ardhë ftesa, kush e ka dërgu, dje të kam thirrë në telefon për këtë punë

znj. Leonita Jasiqi: meqenëse jemi vonu në këtë proces dhe ka qenë kërkesë e vazhdueshme e grupeve parlamentare që të silltet sa më shpejtë dhe të kryhet kjo punë. Komisioni ju ka drejtu me një propozim vendim për miratimin e emrave të propozuar nga komisioni komunal për emërtimin e zonave të qarkullimit publik. Komisioni ka shqyrtuar punën e komisionit paraprak dhe propozimet e qytetarëve ka vlerësuar se janë propozuar të gjitha procedurat e duhura dhe të gjitha kriteret dhe ka miratuar propozimet në listen e bashkangjitur të cilën e keni para jush.

z. Lulzim Gacaferi: cili komision e ka mar këtë vendim, kush ka vendos?

znj. Leonita Jasiqi: komisioni ka marrë vendim me shumicë votash dhe ka pranuar punën e komisionit paraprak, ne e kemi sjellë te ju për votim mund të jepni propozime shtesë, të bëni ndryshime e gjitha është në kompetencën tuaj sepse ju vendosni si Kuvend.

znj. Behare Qestaj: ne nuk kemi vërejtjem, e përkrahim

z. Lulzim Gacaferi: mbledhjen e kaluar e kemi diskutu

bashkarisht, është mbajtur një mbledhje më kanë diskriminuar nuk më kanë ftuar, për mbledhjen që e keni mbajtur dhe të kam marrë në telefon, ma kanë dërguar ftesën dy orë para orës 10:00 që e keni mbajtur mbledhjen, më ka ardhur ftesa në shtëpi, duhet me ju ardhur turp që me keni anashkaluar, ju nuk më keni sjellë mu këtu në Komunën e Junikut, qytetarët e Junikut më kanë sjellë, unë e kam marrë mundin nga Gjermania paguaj 500Euro biletë dhe vi për qytetarët e Junikut, nuk vi këtu për me diskutu me juve, por për qytetarët, duhet me u ardhur keq ky komision për neve është jorelevant, është komisi i keqja e këtij vendi, keni bërë hajgare me emrin e Bekim Berishës, e keni quajtur në një ulicë aty, njeriut që ju na lënë emrin në Zagreb në një shesh më të madhin ku e shohin e gjithë bota, me juve me punë a? Jeni e keqja e këtij vendi, duhet me ju ardhur turp, ju ma impononi me ardhur këtu.

Znj. Leonita Jasiqi: të premtën e kaluar ju kam drejtuar me një email në emailin tuaj luli23, po ashtu me datë 22.02.2019 është protokolluar ftesa e cila ju ka sjellur të shtëpia

z. Lulzim Gacaferi: mu nuk më ka ardhur asnjë email, është e pavërtetë duhet me ju ardhur trup që dy herë më keni anashkaluar, ju garantoj që ky është mandati juaj i fundit. Nga ky qast e lëshoj mbledhjen në shenjë pakënaqësie.

z. Muharrem Krasniqi: konstatoj se në mbledhje mesim 10 anëtarë, kemi kuorum

znj. Behare Qestaj: e kam një kërkesë është personale e imja, këto komisione që po bëhen e ftesat e ju kisha lutur të gjithë juve e kryesuesit e komisioneve mundësisht jo vetëm në mënyrë elektronike por edhe me i thirrë në telefon, me qenë dëshmi që ka biseduar me të, sepse anëtarët e kuvendit po kanë ankësuar për këto raste

znj. Sindije Idrizi: një pyetje për drejtoreshën e kam, te emrat e propozuar nga komisioni për miratim që është 11 dhe 13 Bajram Curri e cekur në dy pjesë në dy rrugë

znj. Leonita Jasiqi: po është një rrugë e përbashkët që lidhet

z. Hasan Krasniqi: në disa raste e njëjta rrugë i ka dy emra, kodet e rrugëve janë të caktuar më herët ne u referohemi atyre kodeve që janë, komisioni i parë ka konstatuar që duhet disa rrugë me i bo disa ndarje të reja, ose kemi pasur raste kur dy rrugë kemi pasur me i bashku, e aty ku kanë me u bashku dy rrugë për momentin figurojnë dy numra por një emër.

z. Zenel Maloku: për sa i përket ftesave të Luli, ndoshta ka mundur të bëhet gabim, të dërgohet me vonesë, munden me ndodh ato sene, por është në pyetje te një delegat, po du me thënë te një anëtarë i një komisioni, për te këta tjerët ne nuk jemi fajtorë që subjekti i LDK-së që një vit e ka pas kërkesën me e prurë delegatin, anëtarin e tyre, kërkues nuk u ka mohuar atë të drejtë, ka bërë një dorëheqje ka mujt me e prurë tjetrin ka mujt me na njoftuar, krejt këto sene kanë mujt me u rregulluar, jo tash me u anku, për te Luli ka mujt me ndodh gabim, por te tjerët krejt kanë qenë të njoftuar, pse nuk kanë ardhur është mundësi dhe dëshirë e tyre, sa i përket komisionit për te Luli është diçka tjetër ka mujt me pas gabime

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe nga 9 të pranishëm, konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon kjo pikë

pika e gjashtë

6. Kërkesë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të hapësirës në objektin e administratës së Komunës së Junikut, për vendosjen e bankomatit

z. Zenel Maloku: për bankomata, unë kam pas kërkesë mos me e pru vetëm një, por me i pru krejt sepse ka klient të të gjitha bankat, sepse nuk janë krejt njerëzit në një bankë, është mirë me qenë krejt bankomatat në Junik

z. Muharrem Krasniqi: kjo do të del në ankand, e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

pika e shtatë

7. Kërkesë për ndryshim-plotësimin e vendimit nr.02/31 të datës 31.10.2018

z. Hasan Krasniqi: bëhet fjalë për një gabim teknik, ju e dini e kemi marrë një vendim me unanimitet të votave për me e dhënë në shfrytëzim një pjesë të një parcele, edhe në atë kohë e kemi sqaru se për cilën parcelë bëhet fjalë, përballë ku ka me u maru objekti i zjarrëfikësve është QPS aty, në anën e majtë ka ti ngjiti e keni kopjen e planit edhe certifikatën e pronës, na u ka përvjedh si gabim teknik, tash kërkojmë që të ndryshohet vendimi dhe të përmirësohet për cilën parcelë është fjala

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon kjo pikë

pika e tetë

8. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: e kam një njoftim ju ka ardhë edhe me shkrim, që deri në fund të muajit mars duhet ta deklaroni pasurinë, mundemi me i bërë edhe të gjithë bashkë ose i dërgojmë vetëm secili, ka afat deri me 31 Mars

znj. Sindije Idrizi: kisha pas një kërkesë sa i përket pengesave rrugore, kisha dashtë të vendosni pengesa në rrugën të shtëpia e Sylë Zekaj, rruga që lidhet me Moronicën, pasi që mbrojtja e fëmijëve është mëse e domosdoshme dhe është pjesë e frekuentuar, banorët e kanë vendosë një pengesë me beton, mirëpo është e nevojshme me e vendos na vet dhe me e hek atë pjesë të betonit sepse është e dëmshme edhe për makinat

z. Myrtë Velijaj: gjithsesi, do të veprojmë në bazë të kërkesës

z. Muharrem Krasniqi: nëse nuk ka dikush diçka tjetër, me kaq e mbylli këtë mbledhje  
Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:50

Procesmbajtës:

z. Turim Ganiqaj

Kryesues i Kuvendit:

z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 03/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 29.03.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tretë të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 29.03.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik.Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës së Junikut z. Agron Kuçi, Nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandatin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it,

Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
6. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
7. Dardane Shala – anëtare, AAK
  
8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK.
12. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
13. Kreshnik Maloku - anëtar, PDK
14. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur

Mungoi: Lulzim Gacaferi – anëtar, VV

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Kërkesë për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal,
3. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2018,
4. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019,
5. Kërkesë për miratimin e vendimit për hartimin e hartave zonale të Komunës,
6. Kërkesë për miratimin e vendimit për hartimin e planit zhvillimor Komunal,
7. Kërkesë për miratimin e planit komunal për Eficiencë të Energjisë 2019-2021 në Komunën e Junikut,
8. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: e hapi debatin për rendin e ditës, fjala për përfaqësuesit e grupeve

znj. Behare Qestaj: pëshëndetje për të gjithë, grupi i AAK-së dhe PDK-së pajtohen me këtë rend dite

z. Tahir Isufaj: po flas në emër timin, pika 7 nuk ka kalu në KPF, ka ardhë direkt këtu, mirë ka qenë edhe në KPF me pas kohë me e diskutu. Edhe pika 5 dhe 6, është e vërtetë që Hasani ka qenë në takim, por ish dashtë me na njoftu pak më shumë

znj. Luljeta Jasiqi: pajtohem

z. Zenel Maloku: me këto pika pajtohem, por e kam një kërkesë për një pikë shtesë nëse pajtoheni edhe ju, në emër të qytetarëve të Jasiqit dhe të Gjocaj kam kërkesë nga ta, me e bërë një propozim me u shkarku nga parki nalt, mos me qenë si pjesë e parkut ne si Jasiq dhe Gjocaj, pra mos me qenë prona jonë pjesë e parkut, sepse nuk është ka shkon puna mirë atje, kemi dëshirë me qenë në pronësi të Komunës dhe në menaxhim të saj. Është kërkesë e imja me e bo si pikë shtesë të rendit të ditës, nëse bën

z. Agron Kuçi: pas shpalljes së parkut Bjeshkët e Nemura, si park nacional janë formu grupet punuese të Ministrisë dhe Komunave, ne i kemi dërgu propozimet mos me qenë Gjocaj dhe Jasiq pjesë e parkut, për shkak se është pengesë e zhvillimit ekonomik të asaj pjese, për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit jam me qenë pik e rendit të ditës, me dal një vendim edhe nga Asambleja, janë të gjitha Komunitat të pa kënaqura me këtë proces

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 5 kundër kalon ky rend dite

pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z. Muharrem Krasniqi: kemi kërku me u shkurtu pak, por kërkoj që të mos shkurtohet më shumë procesverbali, është si vërejtje e imja, a ka dikush diçka lidhur me procesverbalin

z. Zenel Maloku: unë mendoj që çdo fjalë që follet duhet me u shënu, nuk kam vërejtje tjetër

z. Tahir Isufaj: ne nuk kemi marrë pjesë, edhe pse i kam disa vërejtje kur jemi dal na çka keni bërë ju, p.sh te emertimet e rrugëve, e keni cek që unë kam kërku me e sjellë emërtimin e rrugëve, unë kam kërku me dhënë një raport pse nuk janë kry veç në Junik, pra arsyen, pse me ma përmend emrin masi nuk kam qenë këtu, nuk kam thënë ashtu siç e keni thënë ju

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim procesverbalin dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër 5 abstenime kalon procesverbali

pika e dytë

## 2. Kërkesë për miratimin e iniciatives për bashkëpunim ndërkomunal

Znj. Leonita Jasiqi: Kryetari i Komunës së Junikut, ju ka drejtuar juve me një kërkesë për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal, qëllimi i kësaj marrëveshje është aplikimi për fondet e MAPL-së, po ashtu kërkoj të merret vendimi për bashkëpunim ndërkomunal me komunat Deçan, Pejë dhe Gjakovë

Znj Behare Qestaj: ne pajtohemi me këtë kërkesë për bashkëpunim ndërkomunal

z. Tahir Isufaj: as ne nuk jemi për mos me bashkëpunu, por mirë është me e ditë në cilat pika kemi me bashkëpunu

znj. Luljeta Jasiqi: të njejtën kërkesë e kemi

z. Zenel Maloku: është shumë në rregull me bashkëpunu

znj. Leonita Jasiqi: me këto komuna Pejë, Deçan e Gjakovë jemi pajtu që me e ndërtu një qendër për trashëgimi kulturore, historike, turizëm dhe agrobiznes

z. Tahir Isufaj: ata i kanë qendrat e veta

z. Agron Kuçi: e ka lansu MAPL një formë granti që kanë me apliku 38 komuna të Kosovës fondet janë nga Demosi e Gizi, është një fond i vogël, konkurrenca është e madhe, kam arritur dakordim me këta tre kryetar me apliku me këtë projekt

z. Tahir Isufaj: nuk paskim me fitu kurgjo pse me u marrë me këtë punë

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 për, 1 kundër, 3 abstenime kalon kjo pikë

pika e tretë

## 3. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2018

znj. Kosovare Gacaferi: paraqes ndryshimet e planit të buxhetit dhe theksoj se e kemi tejkalu

planin e të hyrave me planifikim, prandaj kërkoj që shuma që është kaluar të kalohet në buxhetin e vitit 2019 në vlerë prej mbi 28,000.00Euro, të bartet në Dr vejtorinë për Zhvillim Ekonomik në

kategorinë, në kategorinë shpenzime kapitale, në projektin bashkëfinancim i projekteve me kod 46030. Pra duhet të bëhet ndryshimi i tabelave të cilat i keni para vetës.

Znj. Behare Qestaj: është për tu përshendetur, për këtë realizim të të hyrave sepse është tejkalu për rreth 28,000.00 Euro ne si grup e përkrahim këtë ndryshim.

z. Tahir Isufaj: nuk e di sa është e vërtetë kjo

z. Zenel Maloku: pajtohem me këtë raport

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 5 abstenime kalon

pika e katër

#### 4. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019

Znj. Kosovare Gacaferi: pra kemi pasur tejkalim të të hyrave, kërkojmë që shuma e mbetur në vlerë prej 87,611.88 Euro ku kërkojmë që bartja të bëhet në kategorinë shpenzime kapitale, po ashtu të gjitha të dhënat i keni të bashkëngjitur në raport. Do të bashkëfinancojmë me disa Ministri të cilat i keni të paraqitura në raportin para jush. Kjo bartje do të jetë shumë efektive sikur në të kaluarën.

Znj. Behare Qestaj: ne në KPF kemi sqaru disa projekte për të cilat kemi pasur paqartësi, përndryshe e përkrahim bartjen e të hyrave

z. Tahir Isufaj: unë po e shoh një keqmenaxhim të buxhetit, p.sh. 70-75% e mjeteve po mbesin për bartje, pse nuk janë kry ato punë dhe pse nuk kanë shku në projekte ku është dashtë, i paraqiti projektet sa % shkon në secilin projekt. Duhet me e planifiku dhe me e shpenzu buxhetin posaqërisht te investimet kapitale, sa ka me qenë % tregom

znj. Kosovare Gacaferi: nuk është keqmenaxhim i buxhetit, por ka të bëjë me dy muajt e fundit të të hyrave sepse nuk shpenzohen gjatë atij viti dhe kemi të drejtë me i bartë

z. Zenel Maloku: ska qenë nevoja me e qitë në kuvend hiq, me i pas lënë në 2018 ishin djeg, kemi mujt meniher me i qitë në 2019 dhe me vazhdu punën me to

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 8 vota për, 0 kundër, 5 abstenime kalon

pika e pestë

#### 5. Kërkesë për miratimin e vendimit për hartimin e hartave zonale të Komunës

z. Hasan Krasniqi: e kemi kalu vendimin si harta zonale dhe plan zhvillimor komunal bashkë,

është kthy ligjshmëria sepse duhet me u nxjerrë dy vendime veç e veç, me u trajtu si dy tema të ndara. Pra ti nisim procedurat për harta zonale e cila është materie e gjërë.

z. Tahir Isufaj: a kemi kapacitete ne për këto, ne vet nuk mundemi kurgjo me bo

z. Hasan Krasniqi: jo nuk kemi, por do të del në tender, na përkrahë DEMOSI

z. Agron Kuçi: ky është një dokument i ri i Ministrisë së Ambientit në krejt Kosovën, pa hartimin e krejt hartave zonale në Komuna, nuk mundet me e pas as Kosova hartën zonale, të gjitha janë në hartim e sipër, është standard i domosdoshëm për zhvillimet në Kosovë

znj. Behare Qestaj: si grup e përkahim miratimin e vendimit për hartat zonale

z. Zeqë Hebibi: a ka toka të mëhershme të uzurpuara në këtë hartim zonal

z. Hasan Krasniqi: në harta zonale trajtohen të gjitha temat zhvillimore të Komunës, pronat komunale, tokat bujqësore, zonat industriale

z. Zeqë Hebibi: a ka a nuk ka, nëse është një tokë e uzurpuar në këtë hartë, këtu duhet ta bëj pyetjen jo në të ndryshme

z. Hasan Krasniqi: po flasim vetëm për nxjerrjen e vendimit fillestar për harta janë një sërë dokumentesh, merren për bazë propozimet e delegatëve, qytetarëve etj

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 8 vota për, 4 kundër, 1 abstenim kalon

pika e gjashtë

#### 6. Kërkesë për miratimin e vendimit për hartimin e planit zhvillimor Komunal

z. Hasan Krasniqi: e kemi PZHK të mirë, por me qëllim të harmonizimit me ligjin e ri për planifikim hapësinor jemi të detyruar me fillu me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

z. Tahir Isufaj: a ka me u nda në zona

znj. Behare Qestaj: ne e përkahim këtë pikë

z. Tahir Isufaj: a kemi naj plan hartim të zhvillimit psh qendrës apo më largë, zona e parë e dytë, a ka mo a keni bërë diçka për 10 vjet a veq ato që i kam lënë unë

z. Hasan Krasniqi: e kemi një PZHK, planin rregullues urban, për mbrojtje të tragëshimisë etj

z. Tahir Isufaj: e keni pas për qendër e keni lëviz krejt e keni bërë sipas qefit

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 8 vota për, 0 kundër, 5 abstenime kalon

pikae shtatë

7. Kërkeës për miratimin e planit komunal për Efiqencë të Energjisë 2019-2021 në Komunën e Junikut

z. Hasan Krasniqi: e kemi një plan më herët për efiqencë dhe kemi pas investimet e para e kemi rregullu kulmin dhe dritaret e shkollës së mesme, mirëpo është kërkesë e IPA-së së BE-së me u harmonizu, plani për efiqencë në nivel Kosove. Andaj kërkojmë të miratohet

znj. Behare Qestaj: ky plan është i përgatitur nga ekspert ndërkombëtarë dhe vendor, drejtori i ka jep të dhënat, për neve është pak i koklavitun vetëm ekspertët e lëmisë e kuptojnë. Një pyetje për drejtorin pse nuk janë marrë parasysh objektet private në këtë plan në të ardhmen një person privat lyp leje në komunë a do të merret parasyshë plani i efiqencës në planin privat

z. Hasan Krasniqi: ky plan parasheh investimet komunale që kanë me ndodhë në këtë periudhë, në efiqencën e energjisë pra invesimet e komunës, jo ato private. Për leje është ligji i ndërtimit dhe ligjet tjera

znj. Behare Qestaj: si grup e përkrahim

z. Tahir Isufaj: a ka pas ndonjë inqizim në nivel Kosove, ose më gjërë, dmth a jemi zonë e interesit

z. Hasan Krasniqi: ne veq kemi përfitu në shkollën e mesme, me e krahasu me komuna tjera qëndrojmë shumë mirë. Bëhet fjalë për aty ku kemi shpenzime publike në ngrohje e ndriqim me i zvogëlu ato shpenzime e humbje

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet

pika e tetë

8. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka te të ndryshmet, nëse jo me kaq e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:50

Procesmbajtës:  
z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues i Kuvendit:  
z. Muharrem Krasniqi

---





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 04/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 30.04.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së katërt të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 30.04.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandatin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e

Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
6. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
  
7. Dardane Shala – anëtare, AAK
8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Edona Shehu –anëtare, LDK
10. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
11. Lulzim Gacaferi – anëtar - VV
12. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
13. Kreshnik Maloku - anëtar, PDK

Munguan: Erleta Isufaj – anëtare, LDK, Zenel Maloku - anëtar, i pavarur

z. Muharrem Krasniqi: për mungesën e tyre më kanë njoftuar znj.

Erleta Isufaj dhe z. Zenel Maloku.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i raportit vjetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2018,
3. Shqyrtimi i marrjes së vendimit për fillimin e procedurave për ndryshimin e rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020,
4. Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e kulturës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për 2019,
6. Të ndryshme.

Znj. Behare Qestaj: ne pajtohemi me këtë rend dite

z. Tahir Isufaj: unë nuk e përkrahi, por pasi i keni votat ecni

z. Lulzim Gacaferi: nuk kam diçka me shtu

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 3 kundër, 0 abstenime kalon rendi i ditës

I

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: a keni diçka lidhur me këtë pikë, e hedhi në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 0 kundër, 3 abstenime kalon

II.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2018

Znj. Behare Qestaj: sa i përket këtij raporti Janar – Dhjetor 2018, së pari e përgëzoj Kryetarin e Komunës, ekzekutivin dhe gjithë stafin e Komunës së Junikut për punën një vjeçare, falë gjithë kësaj pune e dijmë të gjithë se Komuna e Junikut për dy vite me radhë fitoj çmimin për performancë më të mirë në nivel Kosove nga MAPL. Po ashtu, Komuna e Junikut është vlerësu e para në nivel Kosove nga MAPL dhe Demosi në tri fusha dhe uroj që edhe vitin tjetër të ketë rezultate edhe më të larta. Ne si grup nuk kemi vërejtje as personalisht nuk kam, vetëm disa pyetje për Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik i kam.

z. Tahir Isufaj: kam në emër personal edhe unë

z. Lulzim Gacaferi: në emër personal kam pyetje

znj. Behare Qestaj: për drejtorin e zhvillimit ekonomik, fq 24, paragrafi 2 gjatë muajit dhjetor ju si drejtori në bashkëpunim me organizatën Era Grup keni përgatitur projekt propozimin për

bashkëpunim ndërkufitar Kosovë- Shqipëri, nëse zgjedhet si fitues ky projekt do të financohet nga zyra e unionit të evropës dhe ka vlerën 250,000.00Euro, më intereson a është fitu ky projekt? Pyetja tjetër, paragrafi 3, duke parë gjendjen alarmante në pyjet e gështënjes në Junik, drejtorja e zhvillimit ekonomik ka përgatitur projekt propozimin për shërimin e sëmundjes së gështënjes, nga insekti shkatërrues dhe ka aplikuar pranë zyrës japoneze, ky projekt kap vlerën 70,000.00 Euro edhe këtu më intereson a keni përgjigje, paragrafi 4 pas tre vite punë aktive mes drejtorisë dhe operatorit nga kroacia dhe kanada, e dijmë që i kanë vizitu beshkët e Junikut disa grupe të skiatorëve, po shkruan që kanë pas me sjell grupe tjera, më intereson a është ardhë dikush tjetër me i vizitu beshkët, edhe fq 28 paragrafi 6, parkun Moronica vazhdimisht e keni pa si objekt kryesor nga sëmundjet, keni bërë një njoftim më intereson a keni përgjigje nga AKP për këtë sëmundje dhe gjatë kësaj sezone qysh ka përfunduar nga dimri kjo sëmundje.

z. Leonard Lolluni: ne çdo vit përgatisim projekt propozime me të cilat aplikojmë në grant skemat e komisionit evropian, në këtë rast kanë hap thirrje për bashkëpunim ndërkufitar edhe me Shqipërinë, sepse me Malin e zi e kemi pas një projekt, për me mujt me apliku si Komunë duhet ta gjejmë një partner një OJQ, e kemi zgjedh Era Grup nga Peja, kemi apliku në një projekt i cili e ka qëllim kryesor që ti përkrah Agro Bizneset. Përgjigjen ende nuk e kemi marrë jemi në rrethin e ngusht ende. Sa i përket pyjeve të gështënjes ne qe 3 vite e kemi ngrit këtë shqetësim, ne kemi aplikuar në zyrën Japoneze, besoj në korrik kemi me marrë përgjigje, ashtu na kanë thënë sepse është ndërru stafi aty, sa i përket bashkëpunimit me operatorin kroat, qe 3 vite bashkëpunojmë me këtë operator dhe kemi arritur që ta sjellim në beshkët e Junikut, dhe me i ofru pakot turistike të tyre të veçanta që për momentin ofrohen vetëm në alaska, në disa beshkë të austrisë dhe në beshkë të Junikut, është një sport shumë i shtrenjtë, vetëm këtë vit kemi pasur mbi 36 grupe nga skijator të ndryshme. Ndërsa për këtë vit vetëm deri me tani këtë pako e kanë kërku mbi 20 grupe.

z. Lulzim Gacaferi: qka ka brenda pakos, ju e shihni sukses të juaj këtë apo

z. Leonard Lolluni: operatori kroat e bënë promovimin e beshkëve të Junikut, i shet pakot me bërë skijim të lirë në borë të pa shkelur, po e shoh sukses timin. Për parkun Moronica gjendja është më e mirë, për shkak të kushteve atmosferike gjatë dimrit.

z. Tahir Isufaj: për sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë, më intereson këto subvencione thatë që janë nga Ministria por më intereson këta që janë mbi 1000 Euro, që kanë subvencione me e ditë kulturen me qka meren, p.sh. shkojmë me emra. Mustafë Gacaferi, Bekim Tofaj, Leonita Kuqi, Zenun Gjota, Ilir Kuqi, Fatmir Pepshi, Leonora Gaxherri, Muharrem Gacaferi, Bajram Gaxherri, Ismet Tofaj

z. Leonard Lolluni: me krerë lopë, dele dhe me pemishte , nuk i njoh personalisht me emra të gjithë, këto i ndan Ministria e Bujqësisë. Të gjithë që kanë apliku dhe kanë plotësuar kushtet kanë përfitu të gjithë kanë drejtë me apliku kush ka mbi 1 ha tokë të mbjellur, mbi 50 dele, bletë etj.

z. Tahir Isufaj: i pava paralelet të arsimit, janë 60 nxansa e 4 paralele, për fillore dhe gjimnaz, numri i nxënësve bjen 15-16-20 për një klasë, me nxënës dhe kuadër arsimor nuk është puna kërkuar.

z. Fatos Shala: në fillore i kemi në gjeneratë nga tre paralele, ka klasë me 18 apo 27, Ministria e Arsimit ka leju që shkollat që kanë edhe 5-6 nxënës klasën dhe ka qenë rekomandim nga MASHT që asnjë arsimtarë sidomos cikli 1-5 mos me i largu nga vendi i punës, edhe nëse mbetet pa nxënës me i angazhu si ndihmës mësuesi e mos me i hek nga lista e pagave

z. Tahir Isufaj: te shendetësia, i pava 28 të punësuar, më ka ra me shku aty, kuadri është i përzier më shumë motra medicinale sesa mjek, për mjek janë 3-4 motra, po të ishte 24 orë e me u mbulu ndërrimet bën, si të hish aty janë më të interesuar ti marrin shënimet sesa me kry punë.

z. Zenel Kuqi: këtë numër e kam gjetë, nuk është i tepërt, ata punëtorë i kryejnë ato shërbime i marrin ato shënime sepse shënohet çdo vizitë, QKMF në Junik në nivel Kosove ne jemi më të mirët, në ofrim të shërbimit, në mirëmbajtje të objektit në çdo drejtim jemi më të mirët, nuk them që e kam unë meritë

z. Tahir Isufaj: a pritet shërbimi 24 orë

z. Zenel Kuqi: është dhënë si premtim ky, nuk kemi mujt me e realizu për shkak të mungesës së buxhetit, mungon numri i stafit për 24 orë dhe nuk e di sa ka nevojë me qenë shërbimi 24 orë.

z. Tahir Isufaj: unë kam parë edhe këto fshatrat përreth që vijnë, nga Reka e keqe

z. Lulzim Gacaferi: e keni cek që keni pas shpenzime shtesë për asfaltimin e rrugëve lokale, dua të di këto rrugë që i keni asfaltu te njerëzit, ju e dini që ligjerisht, çdo rrugë që komuna e asfalton duhet ta ketë në pronësi të saj, a i keni shpronësuar këto rrugë, rrugën e krrakve që shkon te quni, po ashtu rrugë tjera në bajraktarë, pepsh, gaxherr te kthesa te gurthi, edhe aty jeni fut brenda nëpër oborre, a e keni bërë shpronësimin e këtyre rrugëve nga prona private në komunale sepse është rregull ligjor, nëse nuk e keni bërë shpronësimin keni bërë shkelje ligjore

z. Hasan Krasniqi: ndihem mirë që e kemi realizu asfaltimin e rrugëve lokale

z. Lulzim Gacaferi: përgjigje konkrete të lutem a e keni bërë shpronësimin nga prona private në publike, nuk dojm me na filozofu sepse ne jemi pro asfaltimeve sipas ligjit, si shef i grupit të VV më intereson a ka ndodh shpronësimi?

z. Hasan Krasniqi: nuk flas për ata që nuk i shohin projektet, por për qytetarët, mundesh me u drejtu me shkrim

z. Lulzim Gacaferi: duhet me u përgjigj sepse jam i zgjedhur i popullit dhe jam këtu me i mbrojtë interesat e qytetarëve të Junikut, ose lëshoje asamblenë, ose do të marrë masa juridike ndaj teje, e di që je keqperdorues i buxhetit komunal ti dhe stafi juaj, ju jeni ata që me keni pru këtu dhe do tju luftoj deri në fund në mënyrën më të mirë

z. Hasan Krasniqi: i di përgjegjësitë e mija ligjore, jemi krenar sepse kemi bërë punë në të mirë të qytetarëve të Junikut, dikush nuk i sheh projektet, dikush i sheh por e pengojnë. Nuk kemi pasur buxhet me shpronësu rrugë

z. Lulzim Gacaferi: te vulat i kishi bo dy të reja, i kishi cek shpenzime ka 500euro, faqe 66, punimi i vulave të Komunës së Junikut

znj. Leonita Jasiqi: kjo është prokurimi, me vendim të Kryetarit është bërë rishikimi i të gjitha vulave janë punu, 13 vula, 11 janë rrethore, 2 janë katrore

z. Lulzim Gacaferi: e kam keqkuptuar, unë jam pro zbukurimit të qytezës, por janë 2500 euro e një vend tjetër 2480 cila është shuma, qka është zbukuru në këtë vend. Furnizimi me paisje të teknologjisë informative, qfare teknologjie e paisje keni blerë. Po ashtu furnizmi me kurora dhe buqeta lulesh qka është blerë. Po ashtu një pyetje tjetër transporti i zyrtarëve komunal në ekskurzion për festën e 1 majit 980 euro, faqe 67.

znj. Leonita Jasiqi: është fjala për furnizim për punëtorët e Komunës, disa kompjutera që kanë qenë më të dëmtuar, IT e ka bërë një raport dhe ka vlerësu sa janë të nevojshme me i ble. Për kurora më herët nuk e kemi pasur një projekt të tillë, kemi aktivitete dhe i kemi 100 të vrarë në Junik, shkojmë i nderojmë të gjithë dhe e kemi hap një tender për këtë, nuk e di për transport nuk është në përgjegjësinë time.

z. Lulzim Gacaferi: e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit a është e vërtetë që kanë mbetë nxënësar tonë pa profesor të edukatës fizike qe një kohë të gjatë, po e zëvendësojnë njerëzit që nuk janë adekuat për atë lëmi, fëmijët ma kanë thënë që ja u hudhin një top dhe u thojnë del e luni

z. Fatos Shala: është pjesërisht, kemi arsimtarë që 6 muaj skemi mujt i qit pagat, sepse nuk e kanë leju me hi në listë. Na duhet me kujdes me i planifiku orët, edukatë fizike jep Arsim Krasniqi, inspektoriat i kanë thënë që lejohet nga një shkollë në tjetrën me i ngarku me orë, kemi nga shkolla fillore në gjimnaz dhe anasjelltas. Si të kemi mundësi do të hapet konkurs

z. Lulzim Gacaferi: si nuk keni mundësi, për ka aspekti i buxhetit a, për neve dhe fëmijët tonë është më esenciale me e ditë kur doni me e sjellë një profesor që i përket asaj lami që i mëson fëmijet si duhet edukatë fizike, këtë më intereson me e ditë, ju lutem datën, muajin, vitin na jep

z. Fatos Shala: numri i arsimtarëve llogaritet me nr të nxënësarve, e nxënësit po bijnë çdo ditë, ka arsye të ndryshme mundet edhe gjykata me e pezullu një vendim, nuk e hap konkursin, vjen viti tjetër kalendarik Ministria në bazë të nxënësarve na i jep vendet e punës. Ne duhet kur të del dikush në pension me e qu tjetrin me e nxerrë orët e tij

z. Lulzim Gacaferi: nuk është arsye kjo, një sektor pa profesor po mbet e kush po jep msim, unë kam informacion të saktë që këtë pozitë jeni ka ja runi në djali nga Qoki i cili është ka e kryen fakultetin e edukatës fizike

z. Tahir Isufaj: sa kam dëgju një arsimtarë të edukatës fizike në fillore e keni lshu pa pagesë e zëvendësoni me kuadër jo adekuat

z. Fatos Shala: unë këto informata nuk i kam nga ju po i dëgjoj, të flasim pa paragjykime. Në bazë të numrit të nxënësve ne jemi një arsimtarë më shumë sesa që kemi të drejtë, duhet të miratohet buxhet shtesë që të tejkalohen këto probleme

z. Lulzim Gacaferi: orët e edukatës fizike janë obligative ligjrisht, duhet ta sjellësh profesorin, ta hapësh konkursin adekuat

z. Zeqë Hebibi: ky i Salihaj është pa konkurs, unë nuk e kam parë atë konkurs

z. Fatos Shala: nuk është pa konkurs, me konkurs ka hi dhe 6 muaj nuk kemi mujt me ja qitë pagat

z. Muharrem Krasniqi: jo nuk është pa konkurs

z. Lulzim Gacaferi: sa profesora i ki në shkollë të Junikut që nuk kanë diplomë universitare? E ki obligim me u përgjigj se je drejtor i arsimit, i ki së paku 20 të rinjë e reja që e kanë kry fakultetin e shërbejnë nëpër lokale të Junikut, sepse i qoni ty lifar lloj njeri atje brenda që fare nuk kanë të bëjnë me arsimin, a jep dorëheqje nëse ti sjelli së paku 3 njerëz që nuk e kanë diplomën

z. Fatos Shala: çdo arsimtar është i kualifikuar dhe e ka kontratën e përhershme, nëse del dikush në pension ne e qesim konkursin publik, inspektoriati i mbikëqyrë, vijnë edhe auditorët, p.sh kemi nevojë për një kuadër nuk vjen kuadri adekuat kemi të drejtë të përafërt me e marrë ose një student me e marrë para diplomimit deri me 31 gusht të atij viti pra kontratë të përkohshme

znj. Sindije Idrizi: te faqja 25, sektori për zhvillim strategjik dhe turizëm i ka bërë këto aktivitete: gjatë vitit 2018 kemi lidhur marrëveshje me 14 biznese për kryerjen e obligimeve ndaj komunës, këto marrëveshje kanë ndikuar pozitivisht sepse kanë ngritur taksën komunale. Mua më interesoj cilat janë këto 14 biznese?

z. Leonard Lolluni: ne si drejtori kemi pasur shqetësim mos shlyerjen e borxhit nga bizneset, me rregullore e kemi që bizneset të paguajnë taksë për ushtrim të veprimtarisë, ne kemi pas disa biznese që kanë pas borxhe të vjetra dhe nuk i kanë shly, ne i kemi percjell tek përmbaruesi privat dhe ju kemi jep një mundësi bizneseve që kanë shpreh interesim me ardhë me lidh kontratë para se me i percjell në përmbarim. Disa biznese kanë ardhë disa e kanë nënshkru kontratën pa shku në përmarim dhe e paguajnë me rata

znj. Sindije Idrizi: dmth bizneset në sektore të ndryshme apo

z. Leonard Lolluni: po, po ashtu kemi pasur biznese që jemi detyru me i percjell në përmbarim

znj. Dardane Shala: e kam një pyetje për drejtorinë e zhvillimit ekonomik, gjatë 2018 si drejtori keni vazhdu bashkëpunim me një organizatë me famë botërore YMCA, ku si rezultat organizata e ka përzgjedh një fëmijë nga Juniku që me e përfaqësu Junikun në Angli në një trajnim 6 mujor. Këtë informatë se kush është dhe çfarë trajnimi ka ndjek, nuk kam mundur me e gjetë në raport, nëse ka mundësi me e pas këtë informacion

z. Leonard Lolluni: po, organizata botërore YMCA, organizon trajnime për arsye që me i aktivizu të rinjët në vendimmarrje dhe në proceset që ndodhin në Komunën ku ata jetojnë. Ne kemi lidh një kontratë me ta dhe i kemi jep në shfrytëzim objektin e Valavicës, aty mbajnë trajnime dhe aktivitete me të rinjët, ata e kanë zgjedhë një të ri emrin nuk e di saktë por ka qenë djali i Hysni Tofaj që e kanë përzgjedh për me shku në Angli

znj. Dardane Shala: për çfarë trajnimi e kanë përzgjedhë?

z. Leonard Lolluni: ka trajnime për tema të ndryshme atje, si të përgatitet një projekt propozim e të tilla, me çështje të turizmit etj

z. Zeqë Hebibi: për konkurs tha që është hap konkursi, dua ta pyes a është hap konkursi për kimi? Granit Maka a ka hi me konkurs dhe a është i diplomuar, ka edhe me fakutet e master e nuk a kanë ditë që ka pas konkurs, pse nuk e qitni në derë me e pa, e kanë marrë në bazë partiake atë të Salihaj

z. Fatos Shala: po me konkurs ka hi, ju thash që na lejohet në mungesë të kuadrit me marrë deri me 31 gusht edhe pa diplomë

z. Muharrem Krasniqi: të gjitha konkurset dalin edhe në gazetë janë publike

z. Lulzim Gacaferi: për renovimin përmendores Dëshmorëve në Zharre, unë Betimi dhe Xhemajli e kena bo një kërkesë për renovim të saj, ktu e kanë cek që është bërë një pagesë një vend 2500 euro një tjetër 2442 euro, dashtë të di, a e keni përfundu këtë punë sepse kam qenë para 1 muaj e gjysëm të permendorja dhe i kam bërë disa foto aty nuk është punuar asgjë.

z. Hasan Krasniqi: po është përkrahë ajo kërkesë, e kemi nis me procedurat e prokurimit por nuk ishin edhe aq të interesuar me konkuru në këtë projekt ka qenë problemi i bartjes së materialit, ende nuk është përfundu, është kontrata shpresojmë si të rregullohet koha dhe rruga ka me u përfundu

III

3. Shqyrtimi i marrjes së vendimit për fillimin e procedurave për ndryshimin e rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020

Znj. Kosovare Gacaferi: Me ligjin e ri të tatimit në pronë, kemi disa ndryshme, e kemi pa si të nevojshme ta kryjmë një vlerësim të plotë të pronave, pra është fillim i procedurave

Znj. Behare Qestaj: jemi për fillimin e këtyre procedurave, por me intereson a kanë të gjitha objektet me u rivlerësu

Znj. Kosovare Gacaferi: Ministria do ta bëjë vlerësimin e pronave rezidenciale, ndërsa pronat tjera komunat, këtë vit na lejohet me bo vlerësim

z. Tahir Isufaj: vazhdojmë

z. Lulzim Gacaferi: vazhdojmë

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 0 kundër, 3 abstenime kalon

IV

#### 4. Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e kulturës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore

z. Hasan Krasniqi: kërkesen e Myrt Shala, kuvendi ja ka pas jep vendimin e parë e përkrah, kemi marrë edhe pelqimin e Ministrisë, nevojitet edhe vendimi ynë tash që ajo tokë të shëndërrohet nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, është atje afër bazës së asfaltit

z. Muharrem Krasniqi: Dardane Shala nuk ka të drejtë diskutimi as votimi, sepse është konflikt interesi

znj. Behare Qestaj: meqenëse kjo pikë i ka kalu të gjitha procedurat ne e kemi përkrah njëherë edhe ministria e ka jep pelqimin e përkrahim si grup kemi për ndryshimin e kulturës së kësaj prone

z. Lulzim Gacaferi: unë jam për zhvillim të Junikut dhe me e votu

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 0 kundër, 3 abstenime, prezenz ish-in 13 votuan 12, znj. Dardane Shala nuk mori pjesë në votim

V

#### 5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për 2019

z. Esat Hoxha: këtë komitet e ka formu ky kuvend, ne si grup kemi mbajt një takim dhe bërë një plan pune të cilin e keni përpara, nëse keni diçka mund të përgjigjem

znj. Behare Qestaj: e kam cek edhe në KPF se vërtetë ka qenë i nevojshem ky komitet, e përgëzoj Esatin për këtë plan dhe e përkahim

z. Tahir Isufaj: e përkrahim

z. Lulzim Gacaferi: e përkrahim

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 1 abstenim kalon

VI



## 6. Të ndryshme

Znj. Sindije Idrizi: a është në plan shpronësimi për autostradën dhe ka ka me kalu autostrada e Dukagjinit kryesisht për pjesën e Junikut

z. Hasan Krasniqi: ato procedura nuk i udhëheqim ne, do të ketë edhe debate dhe do të prezantohen kategoritë dhe pagesat, Ministria është në procedura, është një trase jo definitive, lidhur me Junikun dikun te pjesa e Rostovicës parashihet

z. Lulzim Gacaferi: i kam 5 pyetje për kryetarin dhe të tjerët, 1. Kur e keni paraparë ngritjen e një kompleksi memorial për dëshmorët e kombit në Junik, sepse Juniku është i vetmi vend në Dukagjin që nuk ka memorial për dëshmorët, ka vende të vogla me pak shtëpi që kanë bërë memorial kurse ne ende jo, ju lutem datën, muajin, vitin kur do të bëhet. 2. Kryetari i Junikut ka premtu në fushatë që qkmf e Junikut do të funksionoj 24 orë pse ende nuk është bërë, 3. Po ashtu është premtu në fushatë ndërtimi i shtëpisë së Kulturës, ne e kemi pas para lufte një shtëpi të kulturës, dua ta di kur e keni në plan me e ndërtu. 4. Sjellja e ujit të pijes nga Juniku në lagjen Agim Ramadani, pjesa më e madhe e qytetarëve tanë e konsumojnë atë uj gelqerioz i dëmshëm për shëndetin, 5. Lumi Erenik është në dëmtim e sipër, dje kesh i bona disa foto dhe eca andej, a i keni marrë masat e duhura juridike që kompania në fjalë që i ka bërë punimet për ta rinovu prapë, dua ta di këtë.

z. Hasan Krasniqi: për memorial të dëshmorëve e kemi të planifikum ndërtimin e varrezave të dëshmorëve, te rogopeqi atje

z. Lulzim Gacaferi: dëshmorët nuk qohen atje

z. Hasan krasniqi: atje i kemi si projekt varrezat e qytetit, ndërsa tash jemi duke e përgatit pjesen e projektit që sa i përket dëshmorve dhe presim që ky projekt te realizohet sivjet, jeni të gjithë të mirë se ardhur me bashkëpunu

z. Lulzim Gacaferi: unë vi por nuk na ftoni, nuk bashkëpunoni, sikur në komisionin e rrugëve që nuk kam marrë ftesë asniherë, kam qenë pjestarë i luftës, të gjithë kemi bërë aq sa kemi mujt dhe ditë për Junik, jam i gatshëm ditë e natë të punoj për dëshmorët edhe me financa të mija personale, por nuk dua kur të hi në këtë projekt me ma kthy shpinën.

z. Hasan Krasniqi: bëhet fjalë për varrezat e dëshmorëve, jo përmendore sepse ajo është në qendër. Për ujin e lagjes, kemi marrë përkrahje nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik na ka premtu që ka me na përkrah këtë vit, janë në procedura e sipër me Hidrodronin, nuk i zhvillojmë ne ato procedura. Për erenikun ka qenë projekti ku garancioni ka qenë 2 vjeçar dhe brenda atyre dy viteve nuk ka pas dëme, dëmet do të riparohen gjithsesi

z. Zeqë Hebibi: dëmet janë bërë pa u bërë dy vjet

z. Hasan Krasniqi: do të rregullohet shtrati i Lumit Erenik është në projekt e sipër,

z. Lulzim Gacaferi: renovimi duhet të bëhet sa më shpejtë, sepse sa më shumë që qendron ajo aq më shumë shkatërrohet ashtu

z. Hasan Krasniqi: e kemi një projekt 200,000.00Euro prej Ministrisë së Ambientit, do të tentojmë ta rregullojmë

z. Lulzim Gacaferi: po ashtu një përgjigje për shtëpinë e Kulturës nga Fatosi më intereson

z. Fatos Shala: në takimin e fundit që kemi qenë me Kryetarin të ministri, na është premtuar përkrahja për këtë projekt

z. Muharrem Krasniqi: me kaq e mbylli këtë mbledhje

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:10

Procesmbajtës:

z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues i Kuvendit

z. Muharrem Krasniqi

---



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 05/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 31.05.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së pest të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 31.05.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandatin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal –

Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
6. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
7. Dardane Shala – anëtare, AAK
  
8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
12. Lulzim Gacaferi – anëtar - VV
13. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
14. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur

Mungoi: Kreshnik Maloku – anëtar - PDK

## Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i raportit tre mujor financiar Janar – Mars 2019,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2019,
4. Fillimi i procedurave për plotësim ndryshimin e Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut,
5. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet rendi i ditës. Po ashtu i kemi edhe tre pika shtesë, disa pelqime nga Ministria kanë ardhë pasi ka kalu KPF dhe nuk kanë mundur të jenë edhe në KPF. I paraqes edhe pikat tjera shtesë: 1. Vendimi përfundimtar për ndryshimin e destinacionit të parcelave kadastrale 486-6, 486-8, 486-12, 846-14, 487-2, 487-4, 488-0, e hedh në votim dhe konstatoj se me 11 vota për, 0 kundër, 3 abstenime hin kjo pikë e rendit të ditës. 2. Plotësim ndryshimi i vendimit për ndryshimin e planit zhvillimor komunal e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 4 kundër, 0 abstenime hin si pikë e rendit të ditës. 3. Plotësim ndryshimi i vendimit për hartimin hartave zonale të Komunës, e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 4 kundër, 0 abstenime kalon. Tash e hedh në votim rendin e ditës bashkë me tre pikat që u shtuan e hedh në votim komplet rendin e ditës dhe konstatoj se me 12 vota për, 2 kundër, 0 abstenime kalon rendi i ditës.

z. Hasan Krasniqi: për pikën e parë ka ardhë konfirmimi nga Ministria ne veç e kemi votu njëherë, ndërsa për pikën e dytë na u ka kërku që me ju bashkangjit edhe programi i punës së realizimit të tij, pra programi i realizimit, e njejta vlenë edhe për pikën e tretë.

z. Tahir Isufaj: pse nuk po i leni për një mbledhje tjetër, ka edhe procedura tjera mund të pret për mbledhje tjetër, leni për muajin tjetër, nuk kemi kohë me i kqyr tash

z. Muharrem Krasniqi: mund të merrni kohë shtesë nëse doni, në këtë fazë nuk lejohet diskutimi për pikat shtesë

### Pika e parë

#### I. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka rreth procesverbalit të kaluar?

z. Lulzim Gacaferi: në mbledhjen e kaluar e kam cek që është bërë asfaltimi i rrugëve private, pyetja ka qenë se a është bërë shpronësimi nga prona private në publike, Hasani ka thënë që nuk du me tu përgjigj e këtu nuk shënon.

z. Tahir Isufaj: unë kam kërku te subvencionet që këta që kanë shuma më të mëdha të dihen

z. Muharrem Krasniqi: i lutem procesmbajtësit ti bëjë përmirësimet e nevojshme, e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon procesverbali



pika e dytë

#### I. Shqyrtimi i raportit tre mujor financiar Janar – Mars 2019

Znj. Kosovare Gacaferi: në vazhdim paraqiti raportin tre mujor financiar, të cilin të bashkëngjitur e kishin para vetës asambleistët, ku theksoj në detale të hyrat dhe shpenzimet.

Znj. Behare Qestaj: sa i përket këtij raporti në emër të grupit AAK-PDK, nuk kemi vërejtje, për disa pyetje që i kam pas i kam marrë përgjigjet në KPF.

z. Tahir Isufaj: unë kam vërejtje te zyra e kryetarit, shpenzimet në telefon 384 Euro, shërbimet e përfaqësimit avokatur 472 Euro, shërbimet kontraktuese tjera 2439 Euro, këto shërbimet kontraktuese tjera edhe te shërbimet publike 4237 Euro, edhe këtu janë disa karburante për automjete, po më interesojnë këto shumat e mëdha shërbimet kontraktuese tjera, më intereson paret ku janë shku. A ka puntorë me kontratë në vepër dhe më intereson në cilët resor janë?

Znj. Kosovare Gacaferi: ka punëtorë me kontratë mbi vepër, nuk është diçka e ndaluar, është ligji që e mundëson. Janë 5 persona me kontratë në vepër, 3 në shërbime publike, 1 te zyra e kryetarit, 1 te administrata.

z. Tahir Isufaj: pse me kontratë në vepër këta, çka bëjnë këta?

Znj. Kosovare Gacaferi: kemi nevojë për punëtorë e në listë nuk mundem me hi

Znj. Leonita Jasiqi: drejtorja e administratës ka një punëtorë në shërbim kontratë mbi vepër, është pastruesi i komunës, kemi bërë kërkesë me e marrë si punëtorë të rregullt por nuk është leju me e rrit numrin

z. Tahir Isufaj: a nuk janë me kontratë të rregullt ata a? E keni fry numrin tjetër ka, sepse me numer të banorëve shkon kjo

Znj. Leonita Jasiqi: jo nuk është, në komuna tjera është krejt ndryshe por ne e kemi lehtësu punën, na nevojitet një punëtorë i tillë. As numri nuk është fry.

z. Lulzim Gacaferi: unë i kam disa pyetje për kryetarin, por meqenëse po na injoron nuk po vjen kurrë, por disa mund tua përcjellë vartësve, për Kosovaren te huamarrja 14.602 Euro, çka keni mendu me këtë huamarrje? E keni cek dikund 6000Euro, dua ta di që makina zyrtare e komunës sonë, para disa muajve ka qenë e fshehur para pompës së benzinës së Qaush Tofaj, në rrugën për Dobrosh, dua të di kush e mbanë atë makinë dhe kush e ka fsheh aty? Është vozitur nga dikush i Komunës, pse është fsheh aty mundem me ua përcjell edhe me foto te pompa?

Znj. Kosovare Gacaferi: jo na nuk kena mendu, kur vjen qarkorja buxhetore është e përgatitur nga MF, është në shëndetësi i ka ndihmu niveli qendror sektorit të shëndetësisë. Janë 600 e diçka euro jo 6000.

z. Zenel Maloku: sa i përket telefonit të zyrës së Kryetarit 300 e diqka euro, nuk më duket shumë unë 100 Euro i boj shpenzime i kam edhe 2 anëtarë tjerë në shtëpi. Miftari e Jaha a janë mirëmbajtësa apo pastrues?

z. Tahir Isufaj: unë flas me 5 euro, te shkolla fillore shërbime kontraktuese tjera 1194 Euro, e shërbimet e avokaturës 400 e diqka euro, për qfar rasti bëhe fjalë këtu

znj. Kosovare Gacaferi: po është për transport të nxënësve, ndërsa për avokatur është një rast në gjykatë është i kontraktuar një avokat, më duket për rastin e Agush Llloni

z. Lulzim Gacaferi: te drekat zyrtare, kryetari jonë ja lejon vetes vet që ti ftoj gratë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës- Dega në Junik, në Restaurant Trofta në Jasiq, me rastin e 8 marsit, a është e futur qajo fakturë në këto shpenzime, apo e ka paguar subjekti juaj politik?

Znj. Kosovare Gacaferi: nuk është e futur në këtë raport, nuk e ka organizu kryetari por Aleanca e Gruas, kryetari ka shku me i përshendet si i pari i Junikut dhe Aleancës

z. Lulzim Gacaferi: ti je e sigurt që ajo fakturë nuk është futur në këtë raport

znj. Kosovare Gacaferi: po e sigurt

pika e tretë

#### I. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2019

Znj. Dardane Shala: plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019, është orientu në aktivitetet që ka me i bërë ky komitet. I kemi paraqitë disa veprime konkrete që i kemi planifiku me qëllim të përmbushjes së detyrave të tij. Ky plan gjatë zbatimit mundet me pas edhe ndryshime, pasi nuk kemi minoritete, kryesisht jemi marrë me çështjet e nxënësve, sigurinë dhe disa pika esenciale për një jetë më të mirë të qytetarëve

Znj. Behare Qestaj: e përgëzoj Dardanen për këtë plan pune, ne si grup e përkrahim këtë plan

z. Tahir Isufaj: më vjen keq nga Dardana, sepse po mundohet por ky plan nuk përputhet me atë që duhet me qenë

z. Muharrem Krasniqi: është e vërtetë, por na kanë detyru Prishtina me e bo këtë komitet, sepse skemi komunitete tjera, por duhet të jetë ky komitet ligjerisht

znj. Dardane Shala: kam bisedu me persona përgjegjës më kanë thënë që është i detyruar me ekzistuar si komitet

z. Lulzim Gacaferi: nuk kam diçka me shtu

znj. Sindije Idrizi: unë edhe në KPF, i kam dhënë disa rekomandime Dardanës, kjo e ceki edhe më herët se është marrë me temat për nxënës, i kam rekomandu që me i shtu edhe disa aktivitete

për të rinjët pasiqë me të rinjët duhet me u marrë edhe ne si asambleist sa i përket a i lejohe Dardanës për këtë komitet me ekzistë ne kemi bërë pyetje gjatë shumë trajnimeve që i kemi mbajtur, është diskutë që mundemi edhe disa aktivitete për të rinjët me i fut në këtë raport

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 8 vota për, 0 kundër, 6 abstenime kalon

pika e katër

I. Fillimi i procedurave për plotësim ndryshimit të Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut

z. Hysen Imeri: ne e kemi pas një rregullore të tillë që nga viti 2010, mirëpo plotësim/ndryshimi i kësaj rregullore është kërku sepse hyrja apo baza ligjore ka ndryshu, ka qenë udhëzimi administrativ ai është shfuqizuar dhe orari i punës është me ligje tjera të tregtisë, si është ligji i tregtisë së brendshme. Po ashtu e kemi rregulloren nga MAPL për procedurat e hartimit të akteve nënligjore komunale, ku është ndryshimi i neneve, paragrafeve e nënparagrafeve, andaj është e nevojshme të ndryshohet kjo rregullore.

z. Muharrem Krasniqi: a keni propozuar grup pune?

z. Hysem Imeri: jo ende nuk është formuar grupi

znj. Behare Qestaj: ne e përkahim meqenëse është me bazë ligjore sipas zyrarit që i dha arsyetimet

z. Tahir Isufaj: është kërkesë që duhet të vepohet, por mendoj që nuk ish dashtë me u krahasu me qytete të mëdha, ktu është një vend më i vogël. Mendoj që duhet të jetë në grup pune një përfaqësues nga bizneset

z. Lulzim Gacaferi: ne jemi pro atyre ndryshimeve

znj. Behare Qestaj: grupi punues a formohet nga drejtoria apo anëtarët e Kuvendit

z. Muharrem Krasniqi: e bijnë këta si propozim dhe i votojmë, e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon.

Pika e pestë

I. Vendimi përfundimtar për ndryshimin e destinacionit të parcelave kadastrale 486-6, 486-8, 486-12, 846-14, 487-2, 487-4, 488-0

z. Hasan Krasniqi: pas marrjes së vendimit paraprak nga ky kuvend për ndërrim të kulturës së tokës, marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, vjen kërkesa për ndryshimin përfundimtar

të kësaj pjese e cila është të Oda që është rrafshu vendi, projektin e kam këtu. Po e bëjmë një

ndërrim të kulturës dhe i mundësohet operatorit me kërku leje ndërtimi dhe me ndërtu lagje banimi, do ketë pagesa për leje të cilat do të derdhen në buxhetin e Komunës së Junikut

znj. Behare Qestaj: meqenëse kjo kërkesë i ka kalu të gjitha procedurat ligjore, si grup e përkrahim

z. Tahir Isufaj: unë kisha dashtë që drejtori me kërku falje, kur i kam thënë që diçka është ka bëhet, nëse kërkon falje mundet me pas mbështetje

z. Lulzim Gacaferi: e kemi votu edhe herën e kaluar, jemi për

z. Hasan Krasniqi: nëse e vërej që kam gabu kërkoj falje, por nuk kam gabu

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 11 vota për, 0 kundër, 3 abstenime kalon

pika e gjashtë

#### I. Plotësim ndryshimi i vendimit për ndryshimin e planit zhvillimor komunal

z. Hasan Krasniqi: ka qenë një lëshim nga ana ime këtu, ky kuvend e ka marrë vendimin për me e hartu planin zhvillimor komunal, por është dashtë të bashkëngjitet edhe programi i punës për hartimin e planit zhvillimor komunal, jemi koordinu edhe me Minsitritë e linjes andaj kërkoj të votohet

znj. Behare Qestaj: ne e përkrahim

z. Lulzim Gacaferi: e përkrahim

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 0 kundër, 3 abstenime kalon

pika e shtatë

#### I. Plotësim ndryshimi i vendimit për hartimin hartave zonale të Komunës

z. Hasan Krasniqi: vlen e njejta duhet të bashkëngjiesim programin e punës

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 0 kundër, 3 abstenime kalon

pika e tetë

## I. Të ndryshme

Znj. Kosovare Gacaferi: ne kemi pranuar qarkoren e parë buxhetore 2020/01 për komunat ku janë të përcaktuara grantet, ne jemi në planifikim duhet me e miratu në kuvend KAB-in komunal, 2020-2022. Granti i përgjithshëm për Komunën e Junikut është parashikuar të jetë 798,766.00 Euro. Kemi një rënie, Drejtoresha po ashtu paraqiti specifikat e granteve nëpër drejtori të ndryshme. Buxheti total për komunën e Junikut, sipas kësaj qarkore është 1,627.946.00 Euro. Me 7 qershor në ora 11:00 këtu në asamble do ta mbajmë një dëgjim publik, ju ftoj edhe juve.

z. Lulzim Gacaferi: me cilën datë?

Znj. Kosovare Gacaferi: me datë 7 qershor

z. Muharrem Krasniqi: me datë 6 e kemi një mbledhje të Qarshia e Jupave, me anëtarë nga Komiteti për Komunitete dhe KPF. Ua kam përcjellë agjendën në email

z. Zeqë Hebibi: te orari i punës kam kërkesë të kryhet sa më shpejtë, nëse është nevoja të thirret seancë e jashtëzakonshme, sepse qytetarët e Junikut po kanë probleme me Polici, për orar të punës. Ky orar ka filluar që një muaj

z. Muharrem Krasniqi: kjo e don kohen e vet, grupin punës, leximi i parë, diskutimi publik, leximi i dytë atëherë miratohet i don së paku 3 muaj

z. Zeqë Hebibi: kjo me polici po i bjen sikur koha policore që ka qenë, është bërë deri në 24:00 masi vet personalisht kom pas mospajtime me policinë

z. Myrtë Velijaj: është zgjatë orari nga 23:00 në 24:00, policia ka vepruar në bazë të ligjit. Bizneset kanë bërë kërkesë e me aktvendim kemi vendos deri në ora 24:00 me qenë hapur

z. Zeqë Hebibi: nuk e di që bizneset kanë bërë kërkesë që me u mbyll më herët, në Junik asnjëherë nuk ka pas probleme nëpër lokale, ku guxon polici në 10:55 me hi në lokal me i qitë myshteritë për krahi jashtë, a po doni me i shti qytetarët e Junikut me qëllim në problem a, i kam thënë të padis dhe ka thënë që Kryetari i Komunës na ka prurë rregulloren qishtë në ora 11:00 mu mshel

z. Myrtë Velijaj: nuk e ka prurë Kryetari ka qenë nga 2010

z. Lulzim Gacaferi: i kam 20 pyetje, drejtor e ke cek në seancën e kaluar dhe në fushatë keni premtur që do ta ndërtoni shtëpinë e kulturës, me thatë që jeni në diskutim e sipër, dua të marr informacion nga ju kur do të filloni këtë projekt, a pritët këtë vit

z. Fatos Shala: duhet një buxhet i madh mbi 1 milion e pa ndihmen e Minsitrive nuk mundemi, jemi në bisedime me Ministrinë

z. Lulzim Gacaferi: një pyetje për Zenelin në fushatë kryetari ka premtur, që QKMF do të jetë në shërbim të qytetarëve 24 orë, do të paiset me aparaturë moderne, dua të di kur do të funksionoj qkmf 24 orë, kur do të funksionojnë ato aparatura që janë premtur para fushatës

z. Zenel Kuqi: pyetja që ka premtu tjetri nuk bëhet, mundesh me mu drejtu pse nuk funksionon 24 orë, por mos ma lidh me fushatë e premtime

z. Lulzim Gacaferi: kryetari ka kërku që tja jepim besimin që qkmf të punoj 24 orë ti je drejtor dhe e ke pranë detyrën po ta bëj ty sepse kryetarin nuk po e shoh këtu, ky është viti i dytë pas zgjedhjeve kur kemi me e pas 24 orë

z. Zenel Kuqi: nuk ka buxhet të planifikuar për një shërbim 24 orë, duhet një vit më herët të planifikohet buxheti

z. Lulzim Gacaferi: një pyetje për Myrtën, Lumi Erenik e kam cek disa herë, atë natyrë e aset për mrekulli që na ka dhuru Zoti, serbia me na pas jep receptin e me e shkatërro nuk kishim ditë ma zi me ja bo, e kam cek këtu disa herë që Ereniku të kthehet në situatën që ka qenë më para, dua të di a keni marrë naj masë që të rregullohet te Tofaj nalt , nëse nuk keni marrë veprime unë do të marr masa juridike ndaj komunës e cila duhet me pagu gjobë, kur do të merrni masa ndaj kompanisë që Ereniku jonë me u kthi si ka qenë, Lumi është ndërtu nga Berisha deri te Makajt, me para të popullit tonë fukara e fisnik, a e keni pa që është ka shkatërrohet totalisht a keni marrë naj masë ndaj kompanisë që së paku ta riparohet atë dëm

z. Myrtë Velijaj: për te Tofaj jemi duke shiku modalitete, janë disa kompani që duan me shku me e rikthi

z. Lulzim Gacaferi: pse mos me e marrë kompania që e ka dëmtu, kur pretendoni me e realizu, në Lagjen tonë janë mbi 100 fëmijë të vegjël mos të ndodh siç ka ndodh në Prishtinë

z. Myrtë Velijaj: nuk e kam synim me e kqyr qka ka ndodh pas, por ta rregullojmë e me e kthi, jemi në bisedime me dy kompani, afate nuk kemi

z. Lulzim Gacaferi: në lagjen Agim Ramadani kur do ta sjellni ujt e pijes nga ktu, sepse është premtu gjatë fushatës, qytetarët presin nga ju e ne e kjo komunë që ta kenë ujin e pijes, sepse ata uj është gelqeror dhe i dëmshëm , kur pritet të filloj

z. Hasan Krasniqi: e kemi dërgu projektin në MZHE për furnizim me ujë, kemi marrë zotime për përkrahje, ata e kanë ritorsu projektin ja kanë dërgu kompanisë Hidrodrini dhe janë duke i shqyrtuar. Presim hapa konkret, ish dashtë sivjet së paku me fillu

z. Lulzim Gacaferi: e kam cek edhe heren e kalume për rinovimin e përmendores së Heronjeve në Zharre është nda një buxhet, është pagu një buxhet, ende nuk është punu asgjë, kur do të ndodh një gjë e tillë, kur do të riparohet përmendroja e Shkelzen Gacaferit, Avdyl Jasiqit e Arif Gjocit, sepse janë nda mjetet

z. Hasan Krasniqi: i ka marrë një pjesë të mjeteve, për aq punë sa ka bërë, materialet janë të maganinume është në përgatitje e siper mbetet vetëm montimi.

z. Lulzim Gacaferi: Juniku e ka një klub të futbollit, a keni paraparë ndonjëherë me nda ndonjë donacion për ata djem të cilët janë krenaria e Junikut, unë kam kërkesë nga ta me ju ndihmu, ju

ka ndihmu një djalë i Goqaj Emrushit me mjete të veta, unë kisha propozu në këtë seancë ta qesim në votim të ndahet një subvencion së paku 20,000.00 Euro për këta djem, që mos të kenë probleme financiare, ta zgjedhim në mënyrë institucionale këtë problem

z. Fatos Shala: ka ardhë një kërkesë për donacion e cila do të shikohet

znj. Leonita Jasiqi: Komuna e Junikut për herë të parë ka një buxhet 30,000.00 Euro për të gjitha kategoritë thirrja për klubet e futbollit është e hapur nga Zyra e Kryetarit deri me datë 6 qershor. Të gjithë munden me apliku, komisioni e bën vlerësimin dhe ndahen mjetet, po ashtu edhe bursa për studentë do të ketë për herë të parë

z. Lulzim Gacaferi: po ndodh për herë të parë, sepse ne e kemi ngrit zërin disa herë, ne ju kemi bërë presion, unë e kam diskutu vitin e kaluar dhe sivjet punën e studentave. Unë kërkoj nga ju, nuk është në interesin tim personal as se bëj për vota, na bëni të mundur ta votojmë një subvencion nga 20 deri 30 mij euro. Ato 30,000.00 Euro që janë nuk dalin edhe për sport edhe për student edhe për njerëz me aftësi të kufizuara, duhet ta bëjmë një fond për futboll.

z. Hasan Krasniqi: janë kategori e Ministrisë subvencionet nuk na lejohet me i rritë

z. Lulzim Gacaferi: po, por ka forma tjera të jau sigurojmë një fond

z. Muharrem Krasniqi: mund të bëni kërkesë e hedhim në votim dhe e shikojmë

z. Zenel Maloku: kisha dashtë me ju pyet deri ku ka shku qështja e lumit Erenik që janë mbajtur dy protesta për të, a ka përfundu hala ajo punë apo jo, a është nevoja me e qitë në votim apet me e kundërshtu kuvendi atë punë, sepse njëherë në 2015 e kemi kundërshtu. E kam një porosi nga qytetarët e Jasiqit dhe Gjocaj për Laurën që po vendoset në vendin qafa e Jasiqit, ne e dim që është e jashtëligjshme me u bë ajo, qytetarët nuk është mirë me pas pengesa në rrugë, nisnu nga vetja secili, qytetarët janë shumë të revoltuar, qytetarët edhe ktu kanë bisedu me z. Krasniqi, ajo është një paralajmërim që ajo mos me u bo aty, le të bëhet mbi fshat sa për neve 10 rampa ti bëjnë, mbi fshat por jo nën fshat unë si qytetarë nuk du me pas pengesë në rrugë. Po ashtu, është ka flitet që do të bëhet me pagesë në nivel Kosove në të ardhmen, për me shku në bjeshkë, ki me bo pagesë si në doganë, komandanti i policisë na ka thënë që Jasiq e Gjocaj kanë me i pas lejet e veqanta, thash ok, por nëse vjen miku im te unë qfarë leje ka ai, ai mund të vjen te unë me familje atij më shtrejt i kushton dogana sesa rruga. Ky është shqetësim i madh i banorëve nalt, më kanë porositë paraqite në kuvend, përndryshe mundet me ardhë deri te një rebelim. Tjetër, neve na u kanë bërë disa dëme në dy drejtime, për kroje për të cilat ka thënë drejtori i urbanizmit do ti rregullojmë, po ashtu ka rrshit dheu e ka zënë dheun krejt, ka është qel rruga kanë rënë gur nëpër livadh te Rustem Malokut, ja kanë dhënë fjalën që kemi me ti hek, as nuk i kanë hek as nuk është në atë rend, janë së paku 200 kamiona dhe që kanë rënë në livadh, kur qesin tender me e pastru vendin?

z. Zeqë Hebibi: për Erenik e kam edhe unë, çka është ka bëhet duam konkretisht me editë qka është ka bëhet, ose të thot kryetari sjemi ka mundemi me e ndal le të dalin qytetarët nëse munden me e nal, ajo veq është shku, cevati janë shtre, duhet me na jep një drejtim çka me bo

z. Hasan Krasniqi: sa i përket lumit Erenik e kemi vendimin e kuvendit, ne i kemi marrë të gjitha hapat ligjor, kryetari ka pas takim me kryeministrin e Kosovës, ka marrë përkrahje që ajo punë nuk ka me u bo, e konfirmoj kryeministri që skemi me pas probleme

z. Zeqë Hebibi: jo nuk tha ashtu, tha nuk kemi me pas probleme si të meret uji

z. Zenel Kuqi: tha nuk i përkrahi këto ide me marrë ujë kjo komunë të kjo

z. Hasan Krasniqi: Kryetari i Komunës ka pas takim ekstra për këtë çështje, me kryeministrin dhe ju ka thënë që nuk ka me u marr ata uj, ju kemi drejtu edhe Ministrit me shkrim

z. Lulzim Gacaferi: është flit disa herë që rruga Junik-Jasiq- Gjocaj do të asfaltohet sivjet, dua të di nga Hasani kur do të ndodh asfaltimi i saj, por ashtu një pyetje Leonitës e kam bërë një kërkesë te kryesuesi për emërtimin e rrugëve që ka pas një abuzim ndaj meje dhe ende nuk kam marrë përgjigje me shkrim jam duke e pritur përgjigjen

z. Muharrem Krasniqi: ta kam kthy, ashtu siç është

z. Lulzim Gacaferi: çfarë përgjigje mke kthy, ti ua ke dhënë këtyre e këta duhet mu me shkrim, mu më duhet ajo me shkrim, ose me ju qit në gjyq, ose me e qit në pikën zero kur do tma ktheni atë me shkrim, po ashtu nëse e marrin ata uj dëmtohet ekonomia agrare e Junikut

z. Hasan Krasniqi: për Erenikun kemi marrë përkrahje edhe të Kryeshefit të Parkut Nacional që nuk kemi me e leju asnjë punim në pjesën e parkut. Për Laurën, qendrimi ynë ka qenë mu ndertu ku ka qenë Laura e vjetër nuk jemi pajtu, kemi pas edhe kërcënime të hapura nga drejtori që do tju pengojmë në të gjitha projektet nëse ju na pengoni, kemi pas premtime që nuk do të ketë pagesa për qytetarët e Gjocaj e Jasiqit apo edhe të Junikut. Qendrimi i Komunës së Junikut është kundër ndërtimit të këtij objekti, ne nuk kemi lëshuar asnjë pelqim apo leje që e mundëson të ndërtohet ai objekt.

z. Zenel Maloku: së pari ai e ka thy ligjin që ka fillu ndërtim pa leje, atij duhet me ja qu inspektorët dhe me ja ndal punën masi nuk ka leje ndërtimi

znj. Erleta Isufaj: pse për ujë nuk po na lejoni neve me i shfrytëzu format ligjore, por po merret Komuna, ndërsa për këtë temë duhet qytetarët me u marrë me të e jo Komuna

z. Lulzim Gacaferi: çka boni ju ktu, ju jeni me i mbrojtë qytetarët

z. Hasan Krasniqi: ne jemi me i mbrojtë qytetarët e Komunës së Junikut dhe interesat e tyre, kemi pas kërcënime që nese e ndalim këtë objekt kanë me u ndalu projektet e mëdha siç eshte aslaftimi për Gjocaj

z. Zeqë Hebibi: ti po thu që qytetarët ta ngrisin zërin qe Zeneli e ngriti dhe prej meje po besoj prej të gjithëve e ka përkrahjen

z. Zenel Maloku: kjo punë i bjen sikur Evropa që thojke jepi territor Malit të Zi e ne ua japim vizat, nëse nuk jep tokë nuk ka viza, mua më intereson kur të shkoj te shpija mos me pas pengesa në rrugë, nëse ju e parashini me pas pengesa unë e du me e pa ligjin. Të na Polici të kontrollojë, e shumari ta lëshon dritën ty dhe familjes e aty mund të vjen deri te problemet e mëdha, jom ka ju tregoj pritni këto gjëra. Ju lutna si Komune me marr vendime, sepse këto probleme e di që janë të përbashkëta.

z. Muharrem Krasniqi: a pajtohi mbledhjen e ardhshme me e shti si pikë të rendit të ditës Laurën?

z. Zenel Maloku: jo jo mbledhjen e ardhshme asaj i qitet kulmi, kryhet ajo punë, duhet ta mbajmë një mbledhje të jashtëzakonshme

z. Muharrem Krasniqi: mundeni me bo kërkesë për seancë të jashtëzakonshme

z. Hasan Krasniqi: përderisa Komuna nuk ka dhënë asnjë pelqim, vetëm një padi në Gjykatë nga qytetarët dhe ajo ndalohet

z. Xhemë Tofaj: në bjeshkë kush ka shku nga Komuna që i ka fotografu stanet me kërku tatim

z. Hasan Krasniqi: është qëndrim i ekzekutivit të Komunës së Junikut, që stanet me pagu tatim në pronë, duhet ta ruajmë interesin e Komunës së Junikut

z. Xhemë Tofaj: e qysh me marr tatim don Komuna e me e ndal Lauren nuk mundet a

z. Lulzim Gacaferi: kurr ska ekzistuar kështu Laura, duam mbledhje të jashtëzakonshme,

znj. Leonita Jasiqi: unë deri me sot nuk kam pas kërkesë Lulzim nga ana juaj, kryesuesi është institucion tjetër, nuk kam pranuar ende kërkesë, për emërtim e keni kry ju, është kthyer nga Ministria që nuk ka shkelje ligjore

z. Lulzim Gacaferi: kush ju? Unë jo se kam votu, unë ju kam drejtu kryesuesit me kërkesë, se kam kompetencën me tu drejtu ty por kryesuesit se e kemi shef këtu ne

z. Muharrem Krasniqi: me kaq e mbylli këtë mbledhje, mbledhja përfundoi me punë në ora 15:30

Procesmbajtës:

z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues:

z. Muharrem Krasniqi

---





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 06/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 27.06.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së gjashtëtë rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 27.06.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik.Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandatin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it, Drejtorët e

Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
6. Dardane Shala – anëtare, AAK

7. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
8. Edona Shehu –anëtare, LDK
9. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
10. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
11. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur

Munguan: Kreshnik Maloku, Lulzim Gacaferi, Xhemë Tofaj, Erleta Isufaj

z. Muharrem Krasniqi: Kreshnik Maloku dhe Xhemë Tofaj më kanë njoftuar për mungesën për arsye familjare

z. Tahir Isufaj: Erleta ka probleme shëndetësore

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Formimi i grupit të punës për hartimin e planit të punës për Kuvendin Komunal për vitin 2020,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i KAB-it 2020-2022,
4. Propozim Vendimi për shpalljen qytetar nderi për Kolonel Vincenzo Grasso, Komandant i Zonës Jugperëndimore
5. Raporti i të dhënave të performancës për Komunën e Junikut,
6. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi e hedh në votim dhe konstatjo se me 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet rendi i ditës. Pika shtesë është shpallja qytetarë nderi për shtetasit amerikan, anëtarët e korpusit të paqes z. Maxwell Gruber dhe znj. Courtney Shaw, të cilët shërbyen në Komunën e Junikut si mësues të Gjuhës Angleze, e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 vota për, 1 kundër, 0 abstenime hin kjo pikë në rend dite. E hedh në votim komplet rendin e ditës me pikën shtesë dhe konstatoj se me 9 vota për, 1 kundër, 0 abstenime miratohet.

Pika e parë.

1. Shqyrtimi i procesverbalit

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka rreth procesverbalit, konstatoj se me 10 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet.

Pika e dytë

2. Formimi i grupit të punës për hartimin e planit të punës për Kuvendin Komunal për vitin 2020

z. Muharrem Krasniqi: me ligj jemi të obliguar të bëjmë raport pune për vitin që e lëmë pas dhe plan pune për vitin që po hyjmë në të, duhet ti propozoni AAK-PDK 1 anëtarë, LDK 1 anëtarë, LVV 1 anëtarë, nga shoqëria civile është Safete Shehu nga OJQ Qershiza.

Znj Behare Qestaj: për hartimin e planit të punës së kuvendit për vitin 2020 grupi AAK-PDK e propozon Dardane Shala

z. Tahir Isufaj: e propozoj Zeqë Hebibi

znj. Luljeta Jasiqi: a duhet patjetër sot emrin, shënoje emrin tim

z. Muharrem Krasniqi: për hartimin e planit të punës për vitin 2020 janë këta emra : Muharrem Krasniqi, Dardane Shala, Zeqë Hebibi, Luljeta Jasiqi dhe Safete Shehu i hedh në votim dhe me 10 vota për, 0 kundër, 0 abstenime formohet grupi punues.

Pika e tretë:

### 3. Shqyrtimi dhe miratimi i KAB-it 2020-2022

Znj. Kosovare Gacaferi: para juve paraqes Kornizën Afatmesme Buxhetore për 2020-2022, ky dokument të cilin e keni të bashkëngjitur ofron analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës, nëse keni ndonjë pyetje mund të përgjigjem.

Znj. Behare Qestaj: për këtë pikë kemi diskutu edhe në KPF, në emër të grupit nuk kemi ndonjë vërejtje, por unë në KPF personalisht kam kërku që në shëndetësi dhe në arsim me u shtu mjete më shumë, ka qenë kërkesë e imja

z. Tahir Isufaj: kemi vërejtje sa i përket drejtorive, p.sh. te ndarja e mjeteve te investimet kapitale, p.sh. te administrata e përgjithshme kapitalet 2020, janë 13,000 euro ndërsa 2021 janë 26,000 euro, ndërsa 2022 janë 20,000 euro çfarë është kjo ndarje, te shërbimet publike kapitale 130,000 për 2020, 20,000 për 2021 dhe 20,000 për 2022 pse kështu, te zhvillimi ekonomik 2020 janë 200,000, 2021 janë 264,000 e 2021 janë 167,000 pse kështu te urbanizmi 105,000 janë 2020, 100,000 janë për 2021 dhe 105,000 për 2022 pse kështu edhe këtu. Te shkolla fillore për 2020 nuk ka hiq për 2021 i ka 50,000 dhe për 2022 i ka 150,000.

Znj. Kosovare Gacaferi: këto janë shpenzime sipas planifikimeve të drejtorive ashtu siç ata i kanë projektet e tyre. Pra është shpërndarja sipas planifikimeve të tyre është te faqe 20.

z. Tahir Isufaj: te projektet, ndërtimi i rrugës Junik-Prejlep-Dranoc kuj i duhet kjo rrugë, pse mos me e rregullu rrugën që lidhet me Rastavicë, kuj i duhet ajo rrugë, ndërtimi i pishinave verore sa kushtojnë ato, ndërtimi i shtëpizës malore kuj i duhet kjo, shërimi i sëmundjes së gështënjës, ndërtimi i objektit social për banim, jam me ju ndihmu atyne, por këto janë tregu jofunksional lemi në Junik

z. Hasan Krasniqi: ky projekt ka kalu në KAB, vitin e kaluar është kodi buxhetor, ka vendos kuvendi me u realizu ai projekt, është në kuadër të objektivave tona. Në bazë të ligjit komunat janë të obliguara që qytetarët të cilët nuk kanë strehim me ju ofru strehim e kemi këtë projekt

znj. Luljeta Jasiqi: ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Agim Ramadani, a pritet me u realizu së shpejti

z. Hasan Krasniqi: jemi në negociata me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik presim që të realizohet së shpejti

z. Zenel Maloku: për ndërtimin e objektit për familjet që janë me social, ajo është puna më e mirë që bëhet në Komunën e Junikut sepse ata njerëz janë nevojshem, është nderë është mirë kur

Komuna ua siguron banimin një familje të tillë, nuk ka san më mirë se kjo punë, e nuk ka diçka më tmerr sesa ata njerëz që e kundërshtojnë këtë projekt

znj.Sindije Idrizi: kisha dashtë me e ditë a kemi ne diçka që me i mbrojtë bizneset e reja ose ndryshe Start up që mundemi me i quajt, a përkrahen personat të cilët e krijojnë një biznes të ri dhe deri në çfarë mase

z. Leonard Lolluni: ne nuk kemi pas mundësi me nda buxhet për subvencionim direkt të bizneseve Start up, mirëpo jemi mundu që në bazë të rregullores ti ndihmojmë këto biznese ku në tre vitet e para secili biznes është i liruar nga të gjitha taksat, mandej secili biznes që ka të punësuar 5 e më shumë persona lirohet nga të gjitha taksat komunale, po ashtu ka pas grante nga organizata të huaja që kanë ardhë në komunën e Junikut për këto biznese, por bizneset deri me tash nuk i kanë shkru projektet me apliku në këto donacione.

z. Muharrem Krasniqi: a e don dikush fjalën për këtë temë, nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 7 vota për, 0 kundër, 4 abstenime kalon

pika e katërt

4. Propozim Vendimi për shpalljen qytetar nderi për Kolonel Vincenzo Grasso, Komandant i Zonës Jugperëndimore

z. Agron Kuçi: kam bërë këtë propozim që të nderojmë këtë personalitet të shquar të Kforit në Kosovë pra Kolonel Vincenzo Grasso, i cili që nga ardhja e Kforit në Kosovë, gjithmonë ka qenë në interesin e përgjithshëm dhe ka kontribuar për paqen, po ashtu për lirinë e Kosovës dhe Integrimin e ushtrisë së Kosovës, është kontribues i madh. Ai Komunën e Junikut e ka vizituar disa herë, e ka përkrah me një donacion që është ngrohja në shkollën fillore. Andaj propozoj që të nderohet me çmimin qytetar nderi, kështu nderohet Koloneli dhe miqësia jonë

znj. Behare Qestaj: ne si grup e përkrahim këtë propozim të kryetarit, jemi për ndarjen e këtij çmimi

z. Tahir Isufaj: në KPF kam qenë kundër, sepse ka pas të dhëna shumë pak, edhe tash ka pak nuk po mpelqen sepse ai qenka nivel qendror, ai kontribut për shkollë nuk është i vogël.

z. Zenel Maloku: është shumë e qelluar

z.Muharrem Krasniqi: a e don dikush tjetër fjalën, nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 11 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

pika e pestë

5. Raporti i të dhënave të performancës për Komunën e Junikut

z. Hasan Krasniqi: kam nderin ta prezantoj raportin e performancës së komunave për vitin 2018 nga MAPL, siç e dini komuna e Junikut për herë të tretë me radhë shpallet komuna më e mirë, i plotëson dukshëm kriteret në krahasim me komunat e tjera, vetëm nga vendi i dytë ikim

dikund 12%. 16 komuna me radhë nuk e kanë renditjen aq sa e kemi ne vetëm, për këtë dua ta falenderoj

së pari krytarin e Komunës së Junikut z. Agron Kuçi, stafin e tij dhe juve si anëtarë të kuvendit që jeni pjesë e kësaj pune.

z. Tahir Isufaj: unë kisha besu siç thatë që komunat që kanë më pak se 20,000 banorë kanë ekstra donacione, ktu problemi më i madhi te na është se buxheti ndahet në bazë të koks së banorit, nëse kqyret pas një kohë, sepse ne ka mundësi në të ardhmen ne kemi me pësu fiasko sepse kur vjen puna te buxheti ne nuk mundemi me e mbajtë as qerekun e këtij stafi që e kemi, ose duhet me e mbyll shkollën ose shëndetësinë ose me e përgjysmu adminsitratën kjo është. Neve na duhet rininë me e mbajtë këtu dhe me hap vende pune, toka kemi dhe kemi individ me toka.

z. Agron Kuçi: sa i përket performancës, ky raport ju ka nënshtruar auditimit, ka qenë një garë e vështirë, janë ashpërsu kriteret, nuk po ju vjen Komunave tjera bash mirë që Juniku 3 herë u shpall më e mira në Kosovë. Duhet të krenohemi të gjithë, duke ju falenderu Kryeministrit Haradinaj dhe Ministrit Hamza, me iniciativën e Kryetarit të Komunës së Junikut, që nga viti 2021 do të bëhet e ligjshme që komunat me më pak se 20,000 banorë por mbi 5000 banorë do të kenë përkrahje me ligj. Ne jemi në kuadër të këtyre komunave do të bëhemi me mbrojtje të ligjit.

z. Muharrem Krasniqi: i falenderoj të gjithë ata që kanë kontribuar për këto rezultate

z. Tahir Isufaj: kur ne jemi të parët si janë tjerët, kur na nuk jemi kërkun hiq

z. Hasan Krasniqi: ka qenë sistemi online, sfidë ka qenë që të auditorët me i mbrojtë secili veç e veç të dhënat, kjo është punë e vlerësuar mirë

znj. Behare Qestaj: unë pyetje konkrete nuk kam, vetëm deshta me e përgëzuar Kryetarin e Komunës së Junikut, gjithë stafin e tij, kësaj fitore duhet me ju gëzuar jo vetëm zyrtarët por gjithë qytetarët e Junikut, kjo është një arritje vërtetë e madhe sepse që tre vite radhazi e fitojmë këtë çmim dhe shpresojmë Kryetar që edhe vitet e ardhshme të kemi suksese

pika e gjashtë

6. Propozim vendimi për shpalljen qytetarë nderi vullnetarët e korpusit të paqes z. Maxwell Gruber dhe znj. Courtney Shaw

z. Agron Kuçi: edhe Maxwell dhe Courtney shkojnë, kanë qenë dy mësimdhënës e miq shumë të mirë, shokë tonë, kanë dhënë kontribut në komunën e Junikut, kanë pas shumë aktivitete dhe me mesazhin që e kanë qu tek korpusi i paqes, mendoj që bëjmë nderë që me i shpallë qytetarë nderi

znj. Behare Qestaj: ne e përkrahim këtë propozim, sepse të gjithë e dijmë kontributin e tyre që e kanë dhënë në komunën e Junikut

z. Tahir Isufaj: edhe ne pse me jua prish këtyre, por vetëm është një problem, korpusi i paqes e ka zërin e madh por ata fshehen një sekt fetar pas këtij emri, kam qenë edhe në seli të tyre

z. Muharrem Krasniqi: këta i njoh, nuk e di për vende tjera, por për këta të dy kemi pas fat që i kemi pas këtu, kemi nxënësa që e kanë marrë vendin e parë në Kosovë në gara ndërkombëtare

me punë të tyre dhe të profesorëve tja e don dikush tjetër fjalën nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 0 kundër, 1 abstenim miratohet

pika e shtatë

## 7. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: ju ftoj në një takim nesër, shqyrtimi i projektligji për fëmijët i cili ka dal nga qeveria e Kosovës, mundemi edhe ne me e jep kontributin tonë me drejtori të arsimit, drejtor e pedagog, jemi të thirrur edhe ne aty për të jep mendimet tona, nesër në ora 10:00 në odën e Junikut.

Znj. Sindije Idrizi: dua ta bëj një propozim që mbledhjet e ardhshme të mbahen nga ora 10:00, të asamblesë dhe të KPF-së, për arsye se po kemi edhe obligime tjera, kemi fol edhe me grupin dhe jemi dakord, mundemi me e qit edhe në votim

z. Muharrem Krasniqi: kam mendu që është orar i përshtatshëm ky, orën mundem me e caktu unë me Kryetarin por do ta bëjmë në mënyrë kolegjiale, mua nuk më pengon mundemi në ora 10

z. Zenel Maloku: çështja e orarit, kam thënë edhe më herët, në ora 2 ka njerëz që janë në punë, apo e kryjnë në dy e nuk muj e nxan mbledhjen apo duhet me e marrë pushim, kam deklaruar edhe më herët në ora 10, por si të doni të gjithë

z. Muharrem Krasniqi: a e qesim në votim, ta bëjmë me konsensus, mundemi me bisedu prapë

z. Tahir Isufaj: unë e kam këtë orar me thënë atje është ndrru orari nuk ka kuptim

z. Zenel Maloku: e qite njëherë në votim pse e heke

z. Muharrem Krasniqi: me kaq e mbylli këtë mbledhje

mbledhja përfundoi me punë në ora 14:50

Procesmbajtës:

z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues i Kuvendit

z. Muharrem Krasniqi

---





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 07/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 31.07.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së shtatë rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 30.07.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Komandatin e Stacionit Policor në Junik, përfaqësues të KFOR-it, Drejtorët e Drejtorive

Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
6. Dardane Shala – anëtare, AAK
7. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK

8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
12. Lulzim Gacaferi – anëtar, VV
13. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
14. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur

Mungon: Kreshnik Maloku

z. Muharrem Krasniqi: Kreshnik Maloku më ka njoftuar se ndodhet në FSK.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raporti i Auditimit për Komunën e Junikut për vitin 2018
3. Shqyrtimi i strategjisë komunale për kujdesin parësor shëndetësor 2020-2024
4. Të ndryshme

Znj. Behare Qestaj: ne si grup jemi për këtë rend dite

z. Tahir Isufaj: në rregull

z. Lulzim Gacaferi: në rregull

z. Zenel Maloku: pajtona me këtë rend dite, por kërkoj me e shti edhe një pikë të veçantë të rendit të ditës, nëse pajtoheni edhe ju si delegat. Për do uj atje nalt, sepse jemi ka rrezikohemi për një burim të veçantë jashtë atij që po dojnë me e marrë. Nëse nuk hin si pikë e veçantë e rendit të ditës, unë do të kërkoj me mbajtë mbledhje të jashtëzakonshme, kërkoj që të kryhet sot dhe mos të vijmë prapë për seancë të jashtëzakonshme.

z. Muharrem Krasniqi: për këtë pikë, ky kuvend ka mbajtë mbledhje të jashtëzakonshme e keni një vendim e keni marrë, e ka pru Faiku, nëse ju doni na duhet me e anulë njëherë atë vendim, me mbajtë mbledhje tjetër me marrë vendim tjetër, nuk besoj që ka naj arsyeshmëri.

Znj. Behare Qestaj: Zeneli po thotë që është fjala për një burim tjetër, jo rreth këtij që kemi vendos e kemi mbajtë protestë, është fjala për një burim tjetër, nëse mundet me na sqaru edhe pak

z. Lulzim Gacaferi: a mundesh me e elaboru edhe pak, kush po e merr ata ujë

z. Zenel Maloku: po është burimi ne i thojmë te stani i Tahir Kamerit, është burim që del gati një vadë ujë aty, ne Jasiq e Gjocaj jemi shërby edhe për ujitje dhe për pije me ata ujë

z. Muharrem Krsniqi: a e ke pa projektin që merret edhe këta ujë

z. Zenel Maloku: projektin nuk e kam kqyrë, e kanë këta Junikasit që po e punojnë projektin, është burim i veçantë nuk lidhet me Erenikun.

z. Leonard Lolluni: ne kemi mbajtë takim me Ministrinë e Mjedisit e kanë pru ata projektin pelqimin që e kanë dhënë, pjesë e atij projekti është edhe ata ujë që po thot Zeneli, janë 4-5 burime që kanë me u marrë në atë projekt.

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim, unë nuk kam të drejtë vote sepse është konflikt interesi, sepse djemtë e vllaut e kanë fituar atë tender, unë nuk mund të votoi për këtë pikë

z. Zenel Maloku: ani mirë shumë hallall u koftë që e kanë fitu

znj. Behare Qestaj: neve na duhet një konsultë 5 minuta

z. Tahir Isufaj: është shumë e paqartë, duhet të na sqaroj dikush që din mirë këtë punë, sepse këtë edhe asambleja e mëhershme e ka kundërshtu

z. Zenel Maloku: asambleja më herët nuk ka vendos për këtë burim, atëherë ka qenë në pyetje lumi Erenik apo ujeza

z. Hasan Krasniqi: ne kemi kërku disa herë edhe prej ministrisë por nuk kemi pas kurrë informata të mjaftueshme për këtë projekt, në takimin e fundit na u ka prezantuar projekti kanë thënë që nuk mundemi me e pas kopje, por e kemi bërë foto, në atë projekt, traseja kalon nëpër territorin e komunës së Junikut, por deri me tani ata janë duke i ikur territorit të Komunës së Junikut, sepse e dijnë që ne nuk i lejojmë në territor të Junikut me punu, por bëhet fjalë për të gjitha ato burime të cilat pretendohet të merren, është edhe ky që po thot Zeneli. Nëse e fusim si pikë të rendit të ditës nuk besoj që kundërshtohet vendimi i parë,

z. Muharrem Krasniqi: jo nuk mundemi nuk ka kuptim për të njëjtën punë me vendos dy herë, duhet me e anuluar njëherë atë vendim, me mujt me marrë vendim të ri

z. Tahir Isufaj: ujin e menaxhon shteti, por duhet me ja u përshtat ligjeve që janë për atë fushë, edhe nëse merret ai uj, duhet me e menaxhu Juniku, meqë është pronë e Junikut, ne mundemi me pas probleme për ujitje më vonë

z. Hasan Krasniqi: po menaxhon shteti, pastaj janë këto agjencitë siç është Hidrodrini apo KRU Gjakova, Komuna nuk ka kompetenca me i ndal apo jo, ne jemi të vetëdijshëm që ata ujë kur ta marrin ka me pas dëme shumë të mëdha. Kemi propozuar merrni ujin e Botushës që e ka dy herë kapacitetin e ujit që po e kërkojnë ata, ata po kërkojnë 27 litra për sekond, përfaqësuesit e Ministrisë kanë thënë që ky vendim është i kryer, e nëse ai uj merret kompetenca tona janë shumë të vogla për mos me thënë fare. Kryetari është duke shikuar edhe format ligjore me padi në Gjykatë, edhe qytetarët duhet me qenë kompakt

z. Lulzim Gacaferi: si ka mundësi që qytetarët e Junikut të dalin ta mbojnë atë ujë, çfarë thirrjesh janë këto, çka janë këto fjalë të kota, pse nuk merrni veprime konkrete.

z. Zenel Maloku: prapë po them, ta shtijmë pikë të rendit të ditës, ta diskutojmë, përndryshe do ta mbash mbledhjen e jashtëzakonshme, sepse kur ti bëj nënshkrimet duhet me e mbajtë mbledhjen e jashtëzakonshme.

Znj. Behare Qestaj: derisa nuk qitet në votim, ne jemi ka e dimë problemin e ujit të gjithë, mund ta qesim te të ndryshmet dhe diskutojmë

z. Muharrem Krasniqi: vendim për të njëjtën temë nuk mund të marrim prapë, duhet me e shfuqizuar vendimin e parë

z. Zenel Maloku: jo more çfarë ta shfuqizumit, me mujtë me e fuqizu edhe 10 herë

z Zeqë Hebibi: a ka qenë ai vendimi i 2015

z. Zenel Maloku: po në vitin 2015

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 4 vota për, 2 kundër, 7 abstenime nuk hin si pikë e rendit të ditës, unë nuk kam të drejtë votimi. E hedh në votim rendin e ditës dhe konstatoj se me 14 vota për miratohet rendi i ditës

pika I

#### 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka për procesverbalin, konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet

pika II

#### 2. Raporti i Auditimit për Komunën e Junikut për vitin financiar 2018

Znj. Behare Qestaj: sa i përket këtij raporti të auditorit për Komunën e Junikut, ne si grup nuk kemi vërejtje, vetëm deshta me ma jep një sqarim dikush nga drejtorat, sepse Kryetari nuk qenka këtu, për rekomandimet që i ka jep auditori a ka ndërmarrë diçka komuna për ato rekomandime

Znj . Kosovare Gacaferi: është obligim ligjor brenda 30 ditëve kur e pranojmë raportin duhet me e dorëzu një plan veprimi qysh kanë me u zbatu rekomandimet më tutje, ne e kemi hartu planin dhe jemi në zbatim të tij

z. Leonard Lolluni: ne si drejtori e kemi pas një rekomandim për mbledhje të taksave për ushtrim të veprimtarisë, meniher ne këtë vit kemi fillu me atë rekomandim dhe krejt bizneset që kanë borxhe ndaj komunës i kemi qu në përmbarues privat dhe i kemi realizu ato të hyra

z. Tahir Isufaj: unë sa kam mujt me e vërejt, problemi kryesor është te investimet kapitale, edhe kur hapet tenderi ndodh që kompania i bjen njerëzit si profesionista dhe ajo kompani e fiton që është në kundërshtim me ligjin

z. Hasan Krasniqi: a mund të na sqarosh pak më shumë

z. Lulzim Gacaferi: në asfalt

z. Tahir Isufaj: nderkohe e gjej

znj. Kosovare Gacaferi: ne e kemi pas opinionin e pamodifikuar në theksim të çështjes, kemi me u mundu me e bërë regjistrimin e pasurive që nuk janë të regjisturara.

z. Tahir Isufaj: në faqe 16, operatori ekonomik në projektin asfaltimi i rrugëve lokale në lagjen Gaxherr,

z. Hasan Krasniqi: kjo lëndë ka shku në OSHP, sepse zyra e prokurimit e ka parë që personat që kanë me qenë të angazhum si mbikqyrës nuk janë punëtorë të rregullt të asaj kompanie. Lënda ka shku në OSHP dhe OSHP-ja e ka shpall atë fituese, mandej operatori ekonomik, si dhe ne e auditori e kemi parë që menaxheri apo inxhinieri nuk ka qenë i kyqur në atë projekt.

z. Tahir Isufaj: qe tjetra, në projektin e ndërtimit të rrjetit sekondar të kanalizimit, fillimisht menaxheri i kontratës është caktuar anëtarë i komisionit të vlerësimit të ofertave për këtë projekt.

z. Hasan Krasniqi: gjatë vlerësimit të ofertave ne i marim 3 anëtarë të komisionit nga komuna, kur e vlerësojnë ata ne ka pas raste që të njejtin e kemi qitë edhe menaxher të kontratës që realisht është konflikt interesi

znj. Erleta Isufaj: kur të takohet komisioni me i vlerësu ofertat, duhet me e nënshkru edhe kontratën për konflikt interesi

znj. Kosovare Gacaferi: ka edhe mungesë të stafit, për këtë arsye në urbanizëm po duhet me qenë i njejtin në të dyjat

z. Hasan Krasniqi: janë të përfshirë nga paramasa, hapja e tenderit, vlerësimi i tenderit, menaxheri i kontratës pastaj edhe tre tjetër të pranimit teknik në terren.

z. Tahir Isufaj: ose kanalin e ujitjes që e keni bo ka shpija jeme, ata duhet me e hek

pika III

### 3. Shqyrtimi i strategjisë komunale për kujdesin parësor shëndetësor 2020-2024

Z. Zenel Kuqi: para juve e keni dokumentin, është një dokument që është punuar nga maj 2018 nga grupi punues që është ngritë nga Kryetari, dhe nga AQH, komuna jonë është një nga 12 komunat përfituese të këtij projekti. Dokumenti në vete ngërthen të gjitha të dhënat që përfshijnë territorin e komunës së Junikut, është një dokument i punuar nga profesionit të lëmisë përktëse dhe është punuar me kujdes.

z. Tahir Isufaj: kjo është një temë e një studenti të masterit, jashtëzakonisht e mirë, unë veç e kisha bërë një kërkesë meqenëse është 2020-2024, mirë kish me qenë që në këtë periudhë së paku me e aktivizu ndrimin 24 orë, me bashkëpunu me komunën e Gjakovës sepse shumica e asaj ane janë pacienta këtu, mirë kish me qenë me një participim të përbashkët me e realizu 24 orë

z. Zenel Maloku: kjo ka vetëm implementim buxhetor dhe angazhimi i stafit profesional, po ka edhe mungesa të kuadrove

z. Tahir Isufaj: ka Gjakova i kemi 22 km, ka Deçani i kemi 13 km, ish dashtë edhe për shkak të

këtyre fshatrave, ato edhe ashtu shërbimet po i marrin te na.

Znj. Behare Qestaj: sa i përket kësaj strategjie si grup nuk kemi vërejtje është një dokument i punuar shumë mirë, e falenderojmë këshillin drejtues të përbërë nga 7 persona, grupin punues, ekspert të mjekësisë, Sindija ka diçka personale jo në emër të grupit

z. Lulzim Gacaferi: e kam lexu këtë projekt, deri dikun është mirë, siç tha profesori me mujt me e plotësu funksionimin e QKMF-së 24 orë, sepse na është premtu në fushatën parazgjedhore nga Kryetari i Komunës, pra është premtu që do të funksionojnë ato aparatura që kanë ardhë nga përndimi si donacion, sigurisht ju ka ardhë informacioni nga Dr. Ali Kuqi që është, se në QKMF në Junik vizitohen rreth 60.000 pacienta në vit nga Juniku dhe Reka e keqe e fshatrat përreth, mendoj që i kishi bërë mirë Junikut dhe rrethinës që QKMF me qenë funksionale 24 orë, ti gjejnë kuadrot profesional dhe tu kërkohet falje qytetarëve të Junikut për gënjeshtat që i ka bërë Kryetari i Komunës, pra është kërkesë e imja që të bëhet shërbimi 24 orë në QKMF

z. Muharrem Krasniqi: jemi duke folur për këtë strategji, fushatën mandej, vjen koha edhe për atë

znj. Sindije Idrizi: edhe në mbledhjen e KPF-së, nuk e di kryesues a keni mbajtur shënime, ato kërkesat që i kam pas, por pasi që është edhe drejtori këtu, deshta edhe një kërkesë me e fut në listë, p.sh. paisja e kartelave për personat që janë me diabet, disa komuna janë të paisur me këto kartela dmth që lirohen nga pagesat, në bazë të asaj kartele. Kërkesë tjetër e kam edhe furnizimin e QKMF-së me paisje për matjen e sheqerit në gjak, nuk e di a jeni të pajisur por ka raste që nuk ka pas, pra a ka pajisje për matjen e sheqerit në gjak si dhe pyetja për kartelat, kaq kisha

z. Zenel Kuqi: pacientet e pajisen me ato kartela për lirim nga pagesat e tjera a

znj. Sindije Idrizi: po këto kartela janë për lirim nga pagesa, me anë të kësaj kartele në çdo institucion që e ke jashtë komunës tënde mundesh me u liru nga pagesa, disa komuna janë të pajisura me këto kartela, nuk e di pse ne ende nuk jemi, po ashtu aparati për matjen e sheqerit nuk është sidomos në disa raste urgjente, unë kam hasur vet në praktikë kur nuk ka pasur, këto mjete esenciale për raste urgjente së paku me i pas

z. Zenel Kuqi: po ka aparat për matjen e sheqerit në gjak, për këto kërkesa për ndërrim 24 orë dhe për pajisje me kartela, AQH krejt kohën kërkojnë kërkesa të tilla, besoj që do të përfshihen e për 24 orë ka të bëjë me një vendim të kuvendit ose të kryetarit

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

pika IV

#### 4. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: ju njoftoj se rregulloren për orarin e punës së subjekteve afariste e kemi kalu, mirëpo grupin e punës ende nuk e kemi formu, ekzekutivi i ka pru emrat janë: Hysen Imeri, Venera Shala dhe Turim Ganiqaj, ne kemi mundësi me shku me dy apo katër propozime,

a doni

me i dërgu dy apo katër anëtarë të kuvendit, atëherë a shkojmë me dy emra këtu dhe dy nga bizneset.

Znj. Behare Qestaj: ne propozojmë Betim Gacaferin

z. Tahir Isufaj: meqenëse Zeqa merret edhe me biznes e propozojmë Zeqë Hebabin

z. Muharrem Krasniqi: edhe dy emra i marrim nga bizneset, kush është për këta emra konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon ky grup punues

z. Zenel Maloku: z. Kryesues ne e cekem edhe pak më herët çështjen e ujit, me hi si pikë e rendit të ditës, ne si pikë e parë Gjocaj dhe Jasiq kemi qenë ndër vendet më të minuara në këtë region, çështja e minimit na ka bërë të pamundur kthimin lartë atje me kohë dhe kemi mbetë këtu, është kthi naj kush aty këtu por jo në përgjithësi, edhe ne jemi Junik, mu ka mbush mendja sikur me na bo dikush për inati neve, si pikë e parë Komuna e Junikut ose njerëzit që kanë punu na i kanë kput cevat qe 6 vjet nuk është marrë kush me to, e kemi qitë këtu në kuvend 10 herë, nuk ka dashtë me ditë kush për atë punë, janë punë të pa kryera. E kemi lëshu rrugën, jemi dëmtu me tokë, me livadhe, me mal e me të gjitha nuk e kemi pas dert atë punë, veç me dal një punë e mirë, tash nuk është marrë kush me e atë punë me thënë kemi bo dëmë a diçka, pesë parë nuk i kanë dhënë për atë punë, tash edhe ujt e pijes dhe të ujitjes njerëzit e Junikut janë ka e marrin. Joos Krasniqi ka fitu tender me e marrë ujt, ja ka dhënë Florim Shehut i ka thënë qele ti kanallin, cevat ua jepi unë atyre, edhe kjo punë kryhet. Tash, kallxomni mua çka është ka mduset asfalti mua kur më ndalet ujt e pijes dhe të ujitjes , pse po e bini dhe për kë po e bini asfaltin nalt, po mdoket është interes me u lidh me Mal të Zi asfalti e jo për Gjocaj e për Jasiq, unë me Mal të zi e serbi me mujt e boj muri 12 kat e jo me u lidh me ta, ky është vullnet i imi personal. Unë po propozoj, nga sot asfalt mos të bijnë nalt, nuk është ka mduset asgjë, unë e di se më shumë jetohet pa asfalt sesa pa ujë, nëse ju e dini ndryshe kom qef mem tregu, po ashtu si Gjocaj e Jasiq kam qef ju me na tregu rrugën ka me shku na, përndryshe është porosi e qytetarëve se rrugën do ta mshelim, kur të nalet uji do të ndalet edhe rruga, për shkak të njerëzve të Junikut, sepse ata njerëz janë ka na bëjnë neve këtë, bile apet në Junik është ka merret një Erenik është ka mbet tjetri, shumë e pak qaj që po mbetë, por neve nuk është ka na mbetë pika e ujit, tash po kërkoj ju me na tregu ka me shku na, me na thënë ujt jemi ka e marrim, ka ndodh kjo, kemi prish livadhe e ceva të ujit nuk jemi lodh për atë punë hiç tash ju duhet me na tregu neve pse e bëtë këtë, pse po na merrni ujt, po drejtona te ju është edhe nënkryetari këtu, ju jeni kryesues i asamblesë.Po ashtu, kemi mbajtë protestë edhe për ujë mos me u marrë, dy protesta i kemi mbajtë, njërën jashtë territorit të Junikut, sipas mendimit tim ka qenë rregull Kryesuesi me i thirrë asamblenë e me qenë në protestë të gjithë, jo me qenë vetëm një nga 15, po edhe kryesuesi është dashtë me qenë në ballë atje ku duhet me asamblenë, sepse këtu nuk jemi ardhë me e shty këtë derë sepse jemi të fuqishëm e me hi në asamble, jo jo këtu neve na kanë pru votat e qytetarëve, këtu ne jemi ardhë për mbrojtjen e interesave të qytetarëve

z. Tahir Isufaj: edhe pse i kemi tradhtu pak

z. Zenel Maloku: jo jo te lutem, me tradhti merret ai që është marrë gjithë, ai që nuk vjen te vendi atje, e kush nuk është marrë me tradhti nuk merret kurrë

z. Muharrem Krasniqi: a e don fjalën dikush sepse kaluan pesë minuta

z. Zenel Maloku: jo nuk është punë pesë minuta, këtu kemi dert o zotni, sepse ka ardhë puna me na tregu neve ka me shku, unë po të drejtona ty si kryesues i kuvendit, nënkryetarit të komunës, me qenë këtu i drejtona edhe kryetarit

z. Lulzim Gacaferi: unë i kam 11 pyetje, janë për kryetarin disa, por ai po na injoron spo vjen kurr, e ishalla nuk vjen vetëm më mirë

z. Muharrem Krasniqi: tu kisha lut më shpejtë, këto pyetje sipas rregullores duhet me shkrim,

z. Lulzim Gacaferi: po ua lexoj këto pyetje e me siguri ja përcjellni, pyetje 1. Te lumi erenik është bërë protesta këtu dhe njëherë keni shku në vend të ngjarjes, mu qka më ka brengos më së shumti, që 10 vite Aleanca në pushtet në Junik, pse nuk e krijoni një grup inxhinieresh e profesionit tjerë që të dalin në vend ngjarje në lumin erenik dhe ta ndërtoni një digë e cila i zgjidh problemet e qytetarëve të Junikut dhe të Rekës së Keqe, nga ajo digë ishin furnizu të gjithë me ujë në të njëjtën kohë ekonomia agrare e vendit tonë e kish arritë nivelin e duhur, që 10 vite në pushtet nuk keni marrë asnjë veprim, vetëm abuzim me qytetarët dhe asambleistët dhe ndëshkim ndaj ekonomisë së vendit. Pyetja 2, te qkmf e kam thënë njëherë por kam me e thënë prapë deri sa ta realizojnë këta premtimin e vet, ambulanta nuk po funksionon 24 orë, kam pas këtë pyetje me ja bërë Agronit, duam ta dijmë një datë muaj vit kur do të funksionoj 24 orë meqenëse është premtu në fushatë parazgjedhore, nëse nuk e bëni një gjë të tillë, e keni obligim moral e njerëzor që tu kërkoni falje qytetarëve të Junikut, pyetja 3, perurimi i lapidarit të heronjëve të kombit Shkëlzen Gacaferi, Avdyll Jasiqi dhe Arif Gjoci, më është bërë një ftesë nga Kryetari i Komunës në perurimin e lapidarit, më falni ju lutem aty nuk ka pas perurim, atë e kemi ndërtu ne bashkëluftetarët e tyre në vitin 2001 ose 2002, kemi qenë njëri nga bashkëluftetarët që kam punu 5 javë fizikisht në atë kodër ku është i vendosur lapidari, ne kemi bërë kërkesë unë Xhemalji edhe Betimi për restaurimin e këtyre rrethojave në vlerë 2500 euro, mos manipuloni, më vjen shumë keq nga familjarët e këtyre heronjëve që i kanë leju njerëzit që të manipulojnë me gjakun e këtyre heronjëve, sepse dëshmorë nuk njih parti është i kombit, kjo është e pa pranueshme dhe e turpshme më vjen keq që ka ndodh kështu. Pyetja 4. Është premtu gjatë fushatës, që dëshmorët e Junikut ta kenë një memorial të vetin dhe të gjithë do të varrosen në një vend, nga Kryetari, për 10 vite pushtet Aleanca asnjëherë nuk e moret mundin me kryetar, drejtor, nënkryetar e kryesues që ne si Junik të kemi një mermorial të ngritur të Dëshmorëve të Kombit, fshatrat e Rekës së Keqe, Batusha, Sllupi, Vokshi e shumë tjerë që janë fshatra me nga 50 shtëpi e kanë bërë nga një gjë të tillë, për çfarë arsye e kemi Komunën pse nuk e keni bërë që 10 vite. Unë bëra homazhe te varri i heroit Arif Gjoci, aty është therra e gjemba vendi as nuk ka shtiz të flamurit as rrugë as kurgjo, 5. Lagjia Agim Ramadani është premtu që qytetarët tanë që jetojnë në atë pjesë do ta kenë ujin qysh e kemi ne lagjet tjera të Junikut, për 10 vite pushtet Hasan Krasniqi asnjë veprim konkret duhet me ju ardhë turp Nr 6. Asfaltimi në prona private e kam lyp një sqarim më herët se a keni bërë shpronës im nga prona private në publike, sepse për ta asfaltuar një rrugë duhet ta bësh së pari shpronësimin atëherë asfaltimin. 7. Asfaltimi rreth pronës së kryetarit të Komunës së Junikut, sepse është nda një buxhet rreth 270,000 euro për atë pjesë e deri në fshatin drenoc si është e mundur të bëhet kjo kur në Junik kemi lagje të pa ndërtuara, e kemi rrugën e Nezir Gjocit i cili i ka investuar dikun rreth 200,000 Euro ose më shumë veç me e hap rrugën nga Moronica e deri te shtëpia e vet, pse nuk e moret mundin që ky

asfalt sa shkon ka prona e Agronit që ka me ndërtu lagje, me shku ka rruga e Rexhep Nezirit, por jeni në komune dhe e shfrytëzoni paranë e taksapaguesve tanë. 8 te restaurimi i lumit Erenik e kemi diskutu disa herë, jam bërë bajat por nuk mundem me i ikë kësaj teme, lumi Erenik në lagjen Berishë është në shkatërrim e sipër, më ke premtu është në procesverbal ke thënë që ne do ta qojmë një ekipë që do ta rishikoj lumin dhe do të riparohet, ju lutem ma jepni një dite muaj dhe vit kur kryhet

z. Myrtë Velijaj: së shpejti hapet tenderi dhe do të kryhet

z. Lulzim Gacaferi: nr 9 ndërtimi i shtëpisë së kulturës, është premtu që do të ndërtohet për 10 vite pushtet asnjë veprim konkret nuk është, kur do ta bëni data muaj viti, nuk është interes i imi personal por i qytetarëve të Junikut, ne e kemi pas një shtëpi kulture para lufte, 20 vite pas lufte ende nuk kemi kjo është turp, po ashtu Kryetari i Junikut për të gjitha këto gënjeshttra e ka për obligim që tu kërkon falje morale qytetarëve.

z. Muharrem Krasniqi: nuk lejohen inqizime nga qytetarët, është e ndaluar me rregullore, po ashtu është hera e parë që na mbanë kështu konferencë, i ke 5 minuta për një çështje, pyetjet që i ke i bën me shkrim dhe i deponon në sekretari të kuvendit, nuk shkon kjo si me qenë në fushatë 30 min duke bërë pyetje

znj. Behare Qestaj: të lutem kryesues herën tjetër zbatoje rregulloren

z. Muharrem Krasniqi: me kaq e mbylli këtë mbledhje

mbledhja përfundoi me punë në ora 15:00

E përgatiti  
z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues i Kuvendit  
z. Muharrem Krasniqi

---



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 08/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 30.08.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tetë rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 30.08.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik.Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, nënkryetarin z. Faik Tofaj, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

## Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
6. Dardane Shala – anëtare, AAK
7. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK

8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
12. Kreshnik Maloku – anëtar, PDK

Munguan: z. Zenel Maloku, z. Lulzim Gacaferi dhe znj. Luljeta Jasiqi

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrije fshirjeve në Komunën e Junikut për vitin 2019
3. Informatë për përgatitjet e vitit shkollor 2019/2020
4. Të ndryshme

Znj. Behare Qestaj: ne pajtohemi me këtë rend dite

z. Tahir Isufaj: pajtohem

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim rendin e ditës dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

1 Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka rreth procesverbalit, konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

pika e dytë:

2. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrije fshirjeve në Komunën e Junikut për vitin 2019

z. Muharrem Krasniqi: fjala për ju të nderuar kolegë

znj. Behare Qestaj: si grup nuk kemi diçka për të shtuar

z. Tahir Isufaj: e kishi shkruar që toka e Junikut është shumë mirë, ka rendimente të mira, e nuk e ka as ujitjen as kanalet qka i keni bërë ju

z. Muharrem Krasniqi: për këtë pikë nuk votohet

pika e tretë:

3. Informatë për përgatitjet e vitit shkollor 2019/2020

z. Fatos Shala: po ua paraqes përgatitjet për vitin shkollor, vlen të ceket se këtë javë kemi pasur takime me Ministrinë e Arsimit dhe kemi biseduar për objektin e ri të shkollës në shkollën fillore dhe sallën sportive në gjimnazin e Junikut presim që shpejt ato dy projekte me fillu. Raportin e keni të bashkëngjitur

znj. Behare Qestaj: nuk kemi diçka për të shtuar



z. Tahir Isufaj: kam në emër të grupit dhe timin, në shkollën fillore janë 646 nxënës e gjithsej 30 paralele e që i bjen 22 nxënës për klasë, shkolla e mesme i ka 210 nxënës, me 10 paralele, që i bjen 21 nxënës në klasë, si po e mani kuadrin shkollor. Shqetësuese është te klastë e X 3 paralele me 73 nxënës, te klastë e XI 3 paralele me 71 nxënës, si është e mundur

z. Fatos Shala: kjo është gjendja reale, kjo gjendje është në krejt Kosovë, Ministria e Arsimit kur e ka pa që po largohen fëmijet, na ka rekomandu që asnjë nxënës mos me e largu nga procesi i mësimi, edhe nëse ndonjë mësues mbet pa nxënës mos me e largu por me e aktivizu si ndihmës.

z. Muharrem Krasniqi: në gjimnazin e Junikut janë 2 drejtime, tash ka ardhë edhe Mjekësia janë bërë 3, prandaj nr i nxënësve mundet me qenë një klasë më i vogël një më i madh. E sa i përket 22 nxënës për një klasë nuk janë pak. Është me ligjin parauniversitar e cekne mbi 35 nxënës klasa duhet me u nda në dy.

z. Tahir Isufaj: klasët e X, janë 3 paralele me 73 nxënës, ne jemi ka e mashtrojmë veten këtu.

Znj. Behare Qestaj: testi i maturës, që ka qenë me 30 gusht po më intereson sa maturantë kanë marrë pjesë në këtë test?

z. Fatos Shala: kanë qenë 30, kanë hi në test 26, ndërsa 4 nuk kanë pas drejtë me hi në test

pika e katër

#### 4.Të ndryshme

z. Tahir Isufaj: e kisha bërë një propozim që për mbledhjen e ardhshme me i diskutu këto investime që janë bërë deri me tani për këtë vit edhe me e ditë qka është bërë dhe qka është ndërtuar, sidomos për rrugën Junik-Drenoc dëgjova që edhe kanalizimi po hyn andej, këtë kemi me e sqaru përndryshe ajo si lëndë do të shkoj tjetër kund

z. Muharrem Krasniqi: besoj që kemi me e pas në Janar raportin e Kryetarit dhe i trajtojmë të gjitha, a ka dikush diçka tjetër nëse jo me kaq e mbylli këtë mbledhje

Takimi përfundoi me punë në ora 14:25

E përgatiti  
z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues i Kuvendit  
z. Muharrem Krasniqi

---



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 09/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 27.09.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së nëntë rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 27.09.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik.Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e

pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
6. Dardane Shala – anëtare, AAK
7. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
  
8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
12. Lulzim Gacaferi – anëtar, VV
13. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur

Munguan: Kreshnik Maloku dhe Luljeta Jasiqi

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raporti 6 mujor financiar janar-qershor 2019.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020 leximi i parë
4. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit 2020-2022
5. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2019
6. Kërkesë për lirim nga detyra dhe zëvendësimin e anëtares së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara znj. Aida Zeqaj
7. Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë së KPSH-së 2020-2024 leximi i dytë
8. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: Kreshnik Maloku më ka njoftuar që mungon, ndërsa Luljeta Jasiqi jo

znj. Behare Qestaj: ne si grup e përkrahim këtë rend dite

z. Tahir Isufaj: edhe unë pajtohem, por mendoj që ish dashtë me e diskutu pak dëmtimin e pyjeve, sepse ka qenë një aksion i policisë, ne i kemi dy asete ujt dhe pyllin të dyjat po na dëmtohen e për çka është komuna e pushteti ktu

z. Lulzim Gacaferi: pajtohem me këtë rend dite

z. Muharrem Krasniqi e hedh në votim dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 1 abstenim kalon rendi i ditës

I

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: e kam lexuar, te preambula e ka shënuar i ka mbetur ashtu ku kam përshëndetur komandatin e policisë e të Kforit, janë të shënuar, kam biseduar me atë djalë është rregulluar, i ka mbetur ashtu. A keni vërejtje apo diçka tjetër për procesverbal, nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 asbtenime kalon me atë përmirësim të preambula.

II

2. Raporti 6 mujor financiar janar-qershor 2019

Znj . Kosovare Gacaferi: Drejtoresha prezantoi raportin 6 mujor Janar- Qeshor 2019, ku theksoj se buxheti i aprovuar në Asamblenë Komunale ka pësuar disa ndryshime për të hyrat nga

donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2018. Si dhe të hyrat e bartura për shpenzim në vitin 2019. Për më gjerësisht Drejtoresha ua paraqiti anëtarëve të kuvendit raportin me tabela të të hyrave dhe shpenzimeve.

Znj .Behare Qestaj: sa i përket këtij raporti ne kemi biseduar edhe në KPF, e kemi konsumuar këtë temë, unë Drejtoreshë, vetëm dua tu përgëzoj për punën e bërë në këtë raport sidomos për grumbullimin e të hyrave është një lajm shumë i mirë për komunën e Junikut, çka kam pyet në KPF besoj nuk ka nevojë me i përsëritë, ne si grup nuk kemi vërejtje në këtë raport.

z. Tahir Isufaj: kam pyet edhe në KPF, për mjete si kanë shkuar, po fillojmë nga zyra e Kryetarit shpenzimet e telefonit jashtëzakonisht të mëdha është 1164euro, administrata 586, zhvillimi ekonomik 409, te zyra e kryetarit janë shpenzimet e përfaqësimit avokaturë, që janë të sektorëve udhëheqëse, shpenzime kontraktuese tjera këtu fshehen ata njerëzit që i mbani me kontrata mbi vepër, në shërbime publike janë mbi 7400euro këto shpenzime, e kam një bindje që shumica e këtyre mjeteve shkojnë tjetër ka, por ju i keni qitë këtu, karburant për automjete 700 euro i ka zyra, administrata 1500, shërbimet publike me siguri hyjnë edhe zjarrëfikësat është shifër e madhe 1800, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve mu ka dok shifër e madhe 1900 euro te zyra e kryetarit. Janë shifra që nuk përputhen me realitet. Zhvillimi ekonomik mirëmbatja e rrugëve lokale i ka qit sdi çka ka qitë aty, unë kam kërku edhe më herët që për këto investime të bëhet një komision.

Znj. Kosovare Gacaferi: këto janë shpenzime operative që është normale me funksionu ni komunë, sqarimet i kam dhënë edhe në KPF.

z. Tahir Isufaj: duhet edhe tjerëve, psh shpenzimet kontraktuese tjera, pse nuk thoni që i kemi kaq njerëz me kontrata mbi vepër

znj. Kosovare Gacaferi: nëse e ke fjalën për këto 7000 euro në shpenzime publike është një pjesë e kontratës për mirëmbajtjen e hapësirave publike, për grumbullim të mbeturinave që paguhet nga ai kod, ta kam sqaru edhe në KPF besoj e ke mbajt mend

z. Lulzim Gacaferi: e kam një pyetje për kryetarin

z. Muharrem Krasniqi: sa i përket pyetjeve se atë ditë ke bërë shumë pyetje, dua ta sqaroj me rregullore të Kuvendit Komunal të Junikut neni 48, pyetjet shtrohen pas miratimit të procesverbalit, anëtarë mund të shtrojnë më së shumti dy pyetje, kohëzgjatja e një pyetje është 1 minutë, pyetjet bëhen gojarisht apo dorëzohen në formë të shkruar

z. Lulzim Gacaferi: e dijmë atë rregullore nuk kemi nevojë për sqarime, te pagat dhe mëditjet dua të di se sa punëtorë janë të punësuar me kontratë mbi vepër, kishte qenë mirë të na informoni kush janë ata dhe cilën punë e kryejnë, si dhe telefonatat janë mbi 1000 euro, këtu ka sigurisht pako si në perëdim ku me 10 euro në muaj fol 24 orë mu duk shumë e pa kuptim kjo shumë si dhe te shpenzimet e avokatëve dua të di se çka keni bërë për me pagu avokat a e keni vrarë ndo kënd a

znj. Kosovare Gacaferi: në paga dhe meditje përfshihen punëtorët e rregullt të komunës, qkmf-së dhe arsimit e jo kontratat mbi vepër, për shpenzime të telefonit nuk është vetëm një person, për avokat kemi pas një rast me padi e kemi kontraktu një avokat civil i cili e ka mbrojtë këtë rast, e kemi fitu këtë rast

znj. Erleta Isufaj: pasi është fitu rasti pse është përsëritë disa herë, ka mujt me një herë me u kry, edhe mundet zyrtari ligjor

znj. Kosovare Gacaferi: ka qenë periudhë 6 mujore

znj Leonita Jasiqi: disa raste i mbrojnë edhe zyrtarët ligjor të komunës

III

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020 leximi i parë

Znj Kosovare Gacaferi: nga MF departamenti i tatimit në pronë kemi udhëzim që komunat nuk mund të bëjnë vlerëim për pronat rezidenciale vetëm për kategoritë tjera të pronës, andaj ne kemi kriju një komision i cili ka kryer vlerësim të pronave, bashkëngjitur e keni edhe raportin.

Znj. Behare Qestaj: ne si grup jemi për miratimin e kësaj rregullore

z. Tahir Isufaj: këto banimet për banim në zonën e parë që janë, sa është m<sup>2</sup> në zonën e parë

znj. Kosovare Gacaferi: ato janë prona rezidenciale jemi duke pritur nga departamenti i tatimit në pronë, jemi duke i pritur vlerësimet zyrtare që ka me i bërë Ministria e Financave, ndërsa për objekte tjera vlerësimet i ka bërë komuna.

z. Lulzim Gacaferi: te shitoret e keni cek 490 ndersa te fabrikat 290 euro, fabrika është një diçka që prodhon, ndërsa shitorja e varur nga tregu, si keni ardhë në këtë përfundim, nuk është e detajuar, psh një njeri që e ka në mahallë timen menzi që mbet gjallë me e pas 490

Znj. Kosovare Gacaferi: është e sqaruar në raport nga komisioni

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se kjo pikë kalon me 12 vota për, 0 kundër, 0 abstenime

IV

4. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit 2020-2022

Znj. Kosovare Gacaferi: prezantoj buxhetin 2020 si dhe KAB 2020-2022, për vitin 2020 komuna e Junikut ka pasur një ulje të grantit të përgjithshëm për shkak të kontigjencës që e kam përsëritë edhe në qershor, totali i buxhetit për vitin 2020 është 1,627.946 Euro, paga dhe mëditje janë 1,161,458 euro, mallra dhe shërbime 172,899 euro, shpenzimet komunale 36,200 Euro, subvencionet dhe transferet 30,500Euro, shpenzimet kapitale 226, 889Euro. Po ashtu ka me hy në fuqi ligji i pagave i cili e prek komunën e Junikut kemi me pas një minus për rreth 200, 000Euro në këtë kategori të cilin besojmë që ka me mbulu Ministria e Financave. Buxhetin e keni të bashkëngjitur para jush me tabela ku janë të gjitha propozimet dhe ndarjet në drejtori.



Znj. Behare Qestaj: ne si grup jemi për miratimin e këtij buxheti

z. Tahir Isufaj: te investimet kapitale po dëmtohen shumë, kjo është pjesa ku përfitojnë qytetarët duhet me qyr me përmirësu këtë pjesë

z. Lulzim Gacaferi: këtu te minus 200,000Euro, a e keni paraparë ndonjë strategji që ta tejkalojmë këtë situatë që në fund të 2020 të mos jemi në këtë minus

znj. Kosovare Gacaferi: është strategji që kanë me e paraparë në nivel qendror

z. Muharrem Krasniqi: nëse nuk ka dikush diçka tjetër e hedh në votim dhe konstatoj se nga 13 anëtarë prezent, për janë 13, 0 kundër dhe 0 abstenime pra miratohet buxheti për vitin 2020

z. Agron Kuçi: me gjithë përpjekjet tona që buxheti të mbahet stabil për shkak të heqjes së kontigjences dhe rritjes së pagave me ligjin e ri, me kërkesën tonë e përkrahjen e Ministrit Hamza kemi arritë që nga viti 2021 e tutje buxheti i Komunës së Junikut tek linja e investimeve kapitale nuk ka me zbrit më nën 460,000Euro

V

#### 5. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2019

Znj. Kosovare Gacaferi: për të hyra vetanake në 2019 kemi planifiku 113,557Euro, gjatë periudhës janar-gusht kemi arritë të inkasojmë 124,149.91Euro, pra dikun 10,000 më shumë. Në periudhën shtator-dhjetor besojmë që do të arrijmë të inkasojmë 125,000Euro për me i rritë të hyrat. Kjo rritje prej 25,000Euro do të bartet në drejtorinë e Administratës së Përgjithshme në programin 163 20, Administrata Junik, kodi funksional 0133 në kategorinë e shpenzimeve kapitale sipas këtyre specifikave 5000Euro në projektin ndertimi i aneksit në objektin e komunës, si dhe 20,000Euro në një projekt të ri ndërtimi i E-kioskut në objektin e Komunës.

Znj. Behare Qestaj: ne si grup e përkrahim këtë kërkesë

Znj. Erleta Isufaj: për ne është në rregull, mirë është me u investu aty ku ka nevojë, pasi te invesimet kapitale është buxheti i vogël nuk është keq që të barten këto të hyra

z. Lulzim Gacaferi: çdo rritje të të hyrave në komunën tonë, ne e mirëpresim

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

VI

#### 6. Kërkesë për lirimin nga detyra dhe zëvendësimin e anëtares së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara znj. Aida Zeqaj

z. Muharrem Krasniqi: sipas raportit të kryesuesit të këtij komiteti, kjo ka mungu 6 herë dhe e

ka humb statusin e anëtares së këtij komiteti, po kërkoj që i njehti panel ta vazhdoj procedurën për

zgjedhjen e anëtares së re. Së pari duhet të shkarkohet kjo dhe kërkesa e dytë a pajtohi që i njeiti panel ta qet konkursin e ri.

z. Zeqë Hebibi: a kanë pasur ndonjëherë takim këta a, unë nuk jam ftu asnjëherë dhe këtë çikën nuk po e njoh

z. Zenel Maloku: unë pajtohem me juve me kry punë sa më shpejtë

z. Muharrem Krasniqi: po kanë takime e sjellin te unë raportin në fund të vitit, ti je caktu masi është kry paneli, kjo është e Berishës vajza e Ismet Himës, kush është për shkarkimin e kësaj zonjës, 12 janë për, 0 kundër, 0 abstenime shkarkohet, kush është me mbeti i njeiti panel, Sindije Idrizi, Betim Gacaferi, Zeqë Hebibi, Venera Shala dhe Nezir Shehu, 12 janë për, e lus panelin që sa më shpejtë ta hap konkursin

VII

## 7. Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë së KPSH-së 2020-2024 leximi i dytë

z. Ali Kuqi: ky është një dokument i rëndësishë së veçantë për komunën tonë, në leximin e parë ka kalu pa vërejtje, por procedurat e kërkojnë që të jetë edhe leximi i dytë, vërejtjet që i kenë dhënë në leximin e parë janë të inkorporuara tani, gjatë diskutimit publik nuk ka pas vërejtje as plotësime të dokumentit. Ne kemi punuar një grup i caktuar që e kemi bërë një punë shumë të mirë, dua tu njoftoj për metodologjinë e punës së këtij dokumenti, përpilimi i strategjisë është paraqitur si nevojë e kohës, për një planifikim gjithëpërfshirës dhe bazuar në nevojat e situatës, hartimi i tij është mbështetur nga AQH, është shkurtës për kujdesin shëndetësor të qasshem dhe cilësor, ata na kanë sugjeru që të bëjmë këtë strategji e cila do të na i tregoj kornizat e qarta të zhvillimit të shëndetësisë në Komunën e Junikut për 4-5 vitet e ardhshme. Kryetari i Komunës ka themeluar komitetin në përbërje 7 anëtarësh, kjo strategji është themeluar në bazë të dy parimeve, i pari është qasja gjithëpërfshirëse dhe parimi i dytë është planifikimi bazuar në evidencë përfshirë edhe vlerësimin e nevojave shëndetësore të komunitetit. Me mbështetjen e AQH-së në janar 2018 është mbajtur punëtorja e parë një ditore e facilituar nga ekspertë ndërkombëtarë, në prill 2018 komuna jonë ka marrë pjesë në punëtorinë e dytë mbështetur nga AQH ku është bërë analiza vendimarrësve dhe palëve të interesit si dhe janë definuar hapat konkret për hartimin e kësaj strategjie. Këshilli punues është emëruar nga Kryetari i Komunës me përbërje ndërsektoriale kanë marrë pjesë në trajnim dy ditorë nga AQH në korrik 2018, ky këshill ka formuar grupin punues gjithëpërfshirës 8 anëtarësh ku janë caktuar detyrat specifike për hartimin e këtij dokumenti. Janë mbatur dy takime me përfaqësues të komunitetit, të ojq-ve dhe përfaqësues të institucioneve relevante të komunës, vërejtjet dhe sygjerimet e tyre janë përfshirë në faqen 30 në dokument. Planin e veprimit e kemi kriju i cili është i qartë për dy vitet e ardhshme, do të bëhet edhe për tre vitet tjera, sepse është sygjeru që plani të ketë aktivitetet e qarta për dy vitet e para

znj. Behare Qestaj: unë konsideroj që janë plotësu të gjitha kushtet për miratimin e këtij dokumenti pra të strategjisë për shëndetësi, ne e kemi pasur edhe në lexim të parë e kemi parë që është një dokument shumë mirë i punuar, i përgëzohet të gjithë ata që kanë marrë pjesë në

përpilimin e këtij dokumenti, po ashtu edhe sygjërimet e anëtarëve të kuvendit janë marrë parasysh, kështu që jemi për miratimin e këtij dokumenti.

Znj. Erleta Isufaj: e kemi përkrahë edhe në leximin e parë e përkrahim prapë

z. Lulzim Gacaferi: e përkrahim

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet

VIII

## 8. Të ndryshme

z. Zenel Maloku: po më intereson rruga Junik-Jasiq- Gjocaj pse është ndërpre

z. Hasan Krasniqi: nuk është ndërpre, sot me Kryetarin dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike, ishim në mbikqyrje të projektit është ka punohet në Jasiq te kthesa

z. Zenel Maloku: jo jo, rruga është ka punohet ka hoteli, po hypim në kerr dhe po shkojmë nëse nuk del ashtu nuk kam me ardhë më këtu hiç, drejt trego pse janë ndërpre punimet, rruga në projekt a shkruan Junik-Jasiq- Gjocaj apo Junik- hotel, sqaroma këtë mua rruga është ka punohet andej ka hoteli, a është ka punohet në projekt apo privat, sepse në projekt shkruan Junik-Jasiq- Gjocaj

z. Hasan Krasniqi: kjo rrugë është tenderuar është ka punohet në atë projekt dhe presim që brenda afatit ligjor të kontratës të përfundohet

z. Zenel Maloku: unë propozoj që ky person që e ka marrë me e kry këtë rrugë, mirë kish me qenë kur të hapen tendera apert në Komunë të Junikut dhe të vjen me konkuru, mirë është mos me ja pranë dokumentet hiç, me i thënë ti je rrenc, ti rrenë, ti nuk e kryen punën, ti i bën të zezat, ti je e keqja e dëmi i Junikut dhe e bën padinë ai në gjyq dhe me shku drejt në gjykatë dhe me i thënë se neve rrencat nuk na duhen për këto sene. Nuk është mirë që projekti që shkruan Junik-Jasiq-Gjocaj me marrë kahje tjetër, përpara është shtrur rruga Rastavicë-Qendër sesa rrugët lokale, unë e di ashtu, ti nëse e din më mirë tregom, tash janë ka shtrohen rrugët anësore jo rruga Junik-Jasiq-Gjocaj, leni ato projekte e sene, janë muzika ato unë po them nuk është mirë me bo kështu, më vjen keq nga Kryetari, me këtë punë e dëmtoni kryetarin, vetën e komunën, unë të veti për rrugë ti më tregon për projekt i cili ka marrë kahje tjetër, nëse thu që nuk ka marrë kahje tjetër shkojmë dhe e shikojmë. Tjetër asgjë nuk keni bërë vetëm dëme atje naltë, as nuk keni bërë ceva të krojeve, veç dëme e tash e keni ndërpre rrugën, keni bërë mbrojtëse poshtë pse nuk i bëtë edhe lartë, e kam parë vet që rruga ka marrë kahje tjetër.

z. Lulzim Gacaferi: a është e vertetë që është ndru drejtimi i rrugës

z. Hasan Krasniqi: jo, absolut në asnjë mënyrë, projekti apo kontrata për kryerjen e punimeve Junik-Jasiq-Gjocaj, parasheh asfaltimin e rrugës nga Syl Mehmet deri te ereniku i ujezës përmbi

hotel, deri te ura atje, si dhe kthimin për Jasiq e Gjocaj deri te ura e dytë përmbi Ganiqaj atje, muret e betonit, nuk janë bërë ende as 20% të mureve kanë me u bërë edhe 80% të mureve

z. Zeqë Hebibi: kjo është e padrejtë pse me qu rrugë atje ka hoteli, edhe mbledhjen e kaluar profi e ka lyp me ja sqaru dikush me dokument për lagjet atje nuk keni pru asgjë, ujrë ezeza ende në qender nuk janë lidhë e ju doni me i qu atje

z. Muharrem Krasniqi: neni 48 i rregullores thotë që pyetjet parashtrihen pas miratimit të procesverbalit dhe neni 49 thotë anëtarë në një mbledhje mos të shtrojnë më së shumti dy pyetje

z. Hasan Krasniqi: për pjesën poshtë janë politikat e punës që i udhëheqë operatori ekonomik, sipas tij nuk është ka punohet për Jasiq e Gjocaj sepse nuk i kanë bërë ende muret mbrojtëse, kontrata ka afat deri në qershor më duket të vitit tjetër, ndërsa te asfaltimi i rrugës Junik-Dranoc është një projekt i mirë që e kemi bërë, ky projekt ka ardhur në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal në mes komunës së Junikut dhe Deçanit është një projekt ku trajtohen edhe ujërat atmosferik, në momentin që do ta rregullojmë rrugën Junik-Rastavicë do të trajtohen edhe rrugët tjera për ujërat atmosferik e nëntokësorë, pra në atë projekt nuk janë ka punohen kanalizime, është ka punohet në asfaltimin e rrugës dhe trajtimin e ujërave atmosferike.

z. Lulzim Gacaferi: sa banorë e shkelin atë asfalt Junik-Drenoc të cilin është ka e ndërton kryetari

z. Hasan Krasniqi: është bashkëpunim ndërkomunal ju tregova për këtë projekt na ka përkrahë ministria e Infrastrukturës

z. Lulzim Gacaferi: hajt se sa ta marrim pushtetin Levizja Vetvendosje e ju kallxoj unë juve, gjysa keni me shku në burg

z. Zeqë Hebibi: një pyetje që e bëri për pyje profi, qka është ka bëhet me to nuk e dha dikush një sqarim

z. Leonard Lolluni: me pyjet që janë mbi 700 metra me të cilat menaxhon parku kombëtar, nën 700 metra menaxhojmë që janë pyje private kryesisht, sa i përket pyjeve ne kemi ngrit zërin për dëmet të organet e rendit të cilat kanë marrë masa, këta të parkut po thonë që nëpërmjet një traseje që po e merr ujit komuna e Gjakovës e kanë shfrytëzuar edhe këta dhe i kanë dëmtuar pyjet tona, ku prokuroria ka nisur hetim për ata persona

z. Zeqë Hebibi: ajo është pasuri e Junikut, munden vetë me e pre e me thënë është park nacional na duhet me e mbrojtë vet, unë qat ditë që i kanë ndalë policia traktorat i kam parë 12 kamiona me dru kanë ardhë

z. Leonard Lolluni: fatkeqsisht parku është ka menaxhon me atë pjese e ata i kanë bërë letrat kishe për trase atyre kamionave

z. Muharrem Krasniqi: ne kemi mundësi komandatin e policisë me e angazhu që kontrollo me qenë me e ashpër kur bijnë jashtë atij territori



z. Zeqë Hebibi: çfarë sigurie është ka i bëhet qytetarëve të Junikut dhe bizneseve, a janë thy krejt shitoret e Junikut edhe Banka, po i mshelim lokalet në 22-23 ora ajo është vetëm dëm, nga sektori privat paguhet sektori publik, tjetra dalin kishe po bëjnë diçka i hekin kerret nga trotuarët, së pari duhet me e bërë zgjidhjen atëherë me i dënu njerëzit

z. Muharrem Krasniqi: siguria në Junik është shumë më mirë sesa në qytete tjera, nëse nuk ka dikush diçka me kaq e mbylli këtë mbledhje

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:10

E përgatiti:  
z. Turim Ganiqaj

Kryesues i Kuvendit:  
z. Muharrem Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 10/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 31.10.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dhjetë rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 30.10.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, nënkryetarin z. Faik Tofaj, përfaqësuesen e OSBE-së, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e

pranishëm

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues, AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
6. Dardane Shala – anëtare, AAK
7. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK

8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
12. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur
13. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV

Munguan: Lulzim Gacaferi dhe Kreshnik Maloku të cilët siç tha Kryesuesi nuk e kanë njoftuar për mungesën

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për plotësim ndryshimin e rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Kuvendit Komunal të Junikut për vitin 2020,
4. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: a e don dikush fjalën lidhur me këtë rend dite, nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon. Siç ju kam dërguar material shtesë Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka bërë kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2019 dhe kërkon që të bëhet shfuqizimi i vendimit paraprak me nr prot. 03/30/19, i datës 30.09.2019 fjala për drejtoreshën

znj. Kosovare Gacaferi: Ministria na ka thënë se aq sa kemi tejkalim të të hyrave aq duhet me bërë kërkesë për ndryshim, pra është dashtë me e kthyer edhe njëherë me e marrë një vendim të ri në Kuvend.

z. Muharrem Krasniqi: pra ndryshimi është aq sa kemi të hyra me tepër, aq mund të kërkojmë nga buxheti me na i leju, kjo pikë nuk diskutohet vetëm votohet, kush është për, 8 janë për, 0 kundër, abstenim 5. Tash është ky rend dite i kompletuar

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për plotësim ndryshimin e rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Kuvendit Komunal të Junikut për vitin 2020,
4. Shfuqizimi i vendimit për ndryshimin e buxhetit për vitin 2019 dhe marrja e vendimit të ri për ndryshimin e buxhetit për vitin 2019
5. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon ky rend dite

pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka rreth procesverbalit, nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime, miratohet ky procesverbal, me disa vërejtje

që i kam pasur të preambula e të cilat janë përmirësuar në ndërkohë.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për plotësim ndryshimin e rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut

z. Muharrem Krasniqi: e falenderoj grupin punues që e ka punu këtë rregullore ka bërë një punë shumë të mirë, vërejtjet që i kemi dhënë në KPF, besoj që do të rregullohen

z. Hysen Imeri: grupi punues i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës ka punu në rregulloren në fjalë. Këtë rregullore ne e kemi pasur që nga viti 2010, kështu që i kemi përfshi ndryshimet të cilat janë bërë, në nenin 1 ndryshohet dhe plotësohet rregullorja nr01/3579 e datës 07.12.2010, për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në Komunën e Junikut. Në vazhdim paraqes të gjitha ndryshimet e neneve në këtë rregullore, këto ndryshime i keni të bashkëngjitura dhe për çdo sqarim mund të bëni pyetje. Hartimi i kësaj rregullore është bazuar edhe në rregulloren e Ministrisë së Administratës Publike nr 01/2017 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave.

z. Muharrem Krasniqi: te orari i punës nëse nuk ndërrohet ora, mbetet e njejta orë/kohë, ka mundësi edhe ne me i taku asaj zone që nuk e ndrojmë më orën, në rregullore të ceket nëse mbetet ora verore mbetet orari veror. Edhe te neni 22-23, personat juridik 200-300, personat fizik 100/150, nuk janë të cekura kriteret.

Znj. Behare Qestaj: ne këtë rregullore e kemi shqyrtu edhe në KPF, aty i kemi jep edhe disa vërejtje, ndërsa te neni 9 te orari i punës gjatë ditëve të diela, në disa vende po shkruan që depot nuk punojnë, ndërsa në disa që punojnë nga ora 08-18, drejtoresha e ka cek që kemi diskutu dhe kemi marrë vendim në Bord të Drejtorëve që nuk do të jetë ditë pune, tash nëse mundeni me na dhënë një sqarim a do të jetë dita e diel ditë pushimi apo pune me rregullore. Po ashtu, te neni 18 ose të shtohet një nen i ri që të dihet arsyeja pse po zgjatet orari i punës, sepse me këtë tekst në nenin 18 nuk është e qartë të gjitha pikat në këtë nen janë në rregull përveç pikave e) ku shkruan aktvendimi për plotësimin e kushteve higjienike, teknike, sanitare të lokalit, këtë pikë e shoh të panevojshme si kriter për shtim të orarit, ky dokument lypet për hapje të një biznesi kjo mendoj që duhet me u hek, edhe nen f) për aktivitete të organizuara në hapësirën publike nevojitet pelqim për shfrytëzim nga drejtoria për shërbime publike, të plotësohen kushtet për parking dhe qarkullim të lirë të transportit edhe kjo mendoj që duhet me u hek sepse nuk duhet me qenë kriter për zgjatje të orarit kjo, edhe nën g) pagesa për zgjatje të orarit është në rregull. Këto dy pika janë të panevojshme janë për me hap biznes jo me e zgjat.

z. Hysen Imeri: Veprimtaritë afariste të cilave u lejohet zgjatja e orarit të punës në bazë të pagesave përkatëse janë: hotelet, motelet dhe restaurantet mund të zgjasin orarin vetëm deri në ora 02:00. Kafenete dhe diskotekat në zonat para urbane deri në ora 02:00. Furrat e bukës, qebaporet dhe gjelltoreset mund të zgjasin orarin deri në ora 02:00, dyqanet e qendrat tregtare mund të punojnë 24 orë.

z. Zenel Maloku: mua po më intereson ditën e diel, a do të jenë hapur të gjitha veprimtaritë apo një pjesë po, një pjesë jo, apo do ta bëjnë me rend apo si e keni paraparë ju. Mendimi im është që dita e diel me qenë ditë pushimi, veç një shitore me kon qel me e bo me rend të gjitha me e pas pushim atë ditë punëtorët, a vlen kjo edhe për lokalet tjera apo jo

z. Hysen Imeri: po këto marketet do ta bëjnë me rend, ndërsa lokalet hapur, depot me rend do ta kenë si dhe pikat e karburanteve me rend.

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim kush është që kjo rregullore të kalojë me propozimet e bëra, 13 për, 0 kundër, 0 abstenime.

pika e tretë

### 3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Kuvendit Komunal të Junikut për vitin 2020

z. Muharrem Krasniqi: dua ta falenderoj grupin punues që ka marrë pjesë, znj. Luljeta me arsye ka mungu, kurse një mbledhje ka mungu edhe z. Zeqë, planin e kemi diskutu bashkë, ky plan bazohet në planet paraprake, sidomos në ndihmen që e ka jep DEMOS-i për realizimin e këtij plani, kuptohet me disa ndryshim/plotësime duke ju përshtatur nevojave dhe kërkesave që i kemi ne tash. Kuvendi si organi më i lartë, ka për objektiv krijimin e kornizës ligjore brenda së cilës do të funksionoj administrata, do të mbikëqyrët aktiviteti i administratës, siguron që parimet e një shoqërie demokratike janë të qëndrueshme. Planin vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Junikut shërben si mjet për të arritur qëllimet e më poshtme, përmes një planifikimi të plotë e të kujdesshëm, ky plan siguron që Kuvendi i Komunës së Junikut t'i përmbush obligimet ligjore, shërben si një instrument me anë të të cilit Kuvendi i Komunës mund të mbikëqyrë punën e administratës, funksionin si mjet që shton gjasat për arritjen e objektivave të Komunës së Junikut, ngritë transparencën e kuvendit të Komunës së Junikut, qytetarët janë të informuar për aktivitetet paraprakisht, duke dhënë kontributin në vendimet që kanë rrjedhojë afatgjata dhe të rëndësishme financiare dhe sociale në komunën e Junikut. Aktivitetet për secilin muaj i keni veç e veç, ka mbetur që për muajin gusht të diskutohet a do ta bëjmë pushim, apo të punojmë, sepse këtë vit kam pasur pak ankesa pse nuk ka ke lënë pushim gushtin. Po ashtu, ka mbetur të shqyrohet edhe kërkesa e Behares, se a mund të bëhet dy pika njëherë, raporti 3 muajor të përfshihet në 6 muajor, mos të jepet në dy pika, pra nëse lejon Ministria të bëhet vetëm një raport 6 muajor, ku përfshihet edhe raporti i fundit 3 muajor.

Znj. Behare Qestaj: ju përgëzoj kryesues juve dhe grupin, për këtë punë që keni bërë në këtë plan pune, në KPF e kam pyet kryesuesin për muajin korrik, këtu që janë pikat e rendit të ditës, që pika 1 dhe 2 janë shumë të ngjashme, është raporti i kryetarit të komunës së Junikut rreth gjendjes ekonomiko-financiare të komunës së Junikut për periudhën janar – qershor 2020, prapë pika e dytë është mars-qershor unë kam mendu që këtu janë të dhënat e njejtë, pra bisedohet e njejtë temë, a të kërkohet ty nga Ministria e Financave apo mundesh me e heq njërin.

Znj. Kosovare Gacaferi: mund ta heqim, i kam tregu kryesuesit që nuk është e nevojshme me qenë ajo sepse unë raportoje çdo 3 muaj. Pra duhet të mbetet Janar- Mars, Janar- Qershor, Janar-Shtator dhe Janar-Dhjetor.

z. Zenel Maloku: ke fjala a me punu në muajin gusht, unë mendoj që duhet me punu edhe në muajin gusht, edhe nëse janë 8 persona së paku kuorum ka

z Muharrem Krasniqi: pra në plan duhet të përfshihen Janar- Mars, Janar- Qershor, Janar-Shtator dhe Janar-Dhjetor, si dhe muajin gusht ta bëjmë punë, ne jemi të deleguar nuk jemi me ditë pune, kush është për pushim 4 për pushim, 8 për punë, pra mbetet edhe gushti me punu. E hedh në votim kush është për këtë plan pune me kalu, konstatoj se me 8 vota për, 1 kundër, 3 abstenime kalon



pika e katër

4. Shfuqizimi i vendimit për ndryshimin e buxhetit për vitin 2019 dhe marrja e vendimit të ri për ndryshimin e buxhetit për vitin 2019

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka lidhur me këtë pikë, e hedh në votim dhe konstatoj se me 9 për, 4 abstenime, 0 kundër kalon

pika e pestë

5. Të ndryshme

z. Tahir Isufaj: qe 2-3 mbledhje po lypj sqarim për dëmtim të pyjeve dhe shfrytëzim të ujit, ne i kemi dy asete, ujt dhe pyjet, ujt po mduket e kemi shitë veç kemi bërë zhurem, e tash pyjet çka është në pyetje

z. Agron Kuçi: muajin e ardhshëm do të merrni përgjigje për të dyjat, do të bëjmë raport

z. Zenel Maloku: unë e kam një kërkesë, ujt që ka qenë në qendër këtu a është ndalë me qëllim a e ka nal dikush apo ka defekt, po ashtu aty te xhamia po vjen autobusi aty nuk e ka vendin e caktuar me u ndalë po ndalet në mes të rrugës dhe po bënë pengesë në komunikacion, unë kisha propozu me ja bërë vendin që autobusi me hi aty me i marrë udhëtarët e me vazhdu e mos me pengu askënd, taksistat me i hekë e me i qu te autobusat atje poshtë, këto janë propozimet e mija

z. Tahir Isufaj: unë jam edhe postën me e hek prej qendrës

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka tjetër, nëse jo me kaq e mbylli këtë mbledhje

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:45

E përgatiti:  
z. Turim Ganiqaj

Kryesues i Kuvendit:  
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 11/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 27.11.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së njëmbëdhjetë të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 27.11.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, nënkryetarin z. Faik Tofaj, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

## Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
6. Dardane Shala – anëtare, AAK
7. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
  
8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
12. Lulzim Gacaferi- anëtar, VV
13. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV
14. Kreshnik Maloku – anëtar, PDK
15. Zenel Maloku- anëtar, i pavarur

z. Muharrem Krasniqi: para se ta hapi mbledhjen, ju kisha lut që me një minut heshtje, ti nderojmë të gjitha viktimat e fatkeqësisë natyrore, tërmetit i cili ka ndodhë dje në shtetin Shqiptar, LAVDI!

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020, leximi i dytë,
3. Raporti nëntë mujor financiar Janar-Shtator 2019,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimit të rregullores për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e Komunës së Junikut, leximi i dytë
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm për vitin 2018,
6. Të ndryshme

Znj.Behare Qestaj: ne si grup jemi për këtë rend dite

z. Tahir Isufaj: në rregull është

z. Lulzim Gacaferi: edhe nga ana ime është në rregull

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim këtë rend dite dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet ky rend dite

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: unë e kam lexuar procesverbalin, nuk kam ndonjë vërejtje, besoj që është shkruar korrekt gjithë ajo çka kemi diskutu mbledhjen e kaluar, nëse ka dikush diçka fjala për ju, atëherë pasi nuk ka e hedh në votim dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet procesverbali

pika e dytë

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020, leximi i dytë

z. Muharrem Krasniqi: këtë projekt rregullore e kemi pas edhe njëherë, ka qenë edhe në dëgjim publik, vërejtjet tona i kemi dhënë edhe në KPF, fjala për Drejtoreshën

znj. Kosovare Gacaferi: meqenëse herën e parë ka kalu në kuvend, ka qenë edhe në diskutim publik 15 ditë, gjatë kësaj kohe ne kemi pasur me i prit edhe rezultatet dhe vlerësimet zyrtare që kanë pas me ardhë nga departamenti i tatimit në pronë nga MF, për pronat rezidenciale, janë të bashkëngjitura sesi ka me u bërë vlerësimi për këto prona, janë më të ulëta për vitin

2020

znj. Behare Qestaj: meqenëse kjo rregullore i ka kalu të gjitha procedurat të cilat i kërkon ligji, ne si grup nuk kemi vërejtje e përkrahim këtë rregullore,

z. Tahir Isufaj: e përkrahim

z. Lulzim Gacaferi: e përkrahim

z. Zeqë Hebibi: më duket që tha ka zbritje për vitin 2020, pse në material ka 5% ngritje

znj. Kosovare Gacaferi: po ka zbritje për pronat rezidenciale shtëpitë private, apartamentet dhe garazhet, është fjala për vlerësimet që i ka prurë Ministria e Financave për pronat Rezidenciale, ndërsa prej Komunës janë shifrat minimale

z. Zeqë Hebibi: jo nuk është minimale, se Komuna e Junikut i ka taksat më të mëdha në Kosovë, ne nuk kemi caktuar 5% rritje

z. Muharrem Krasniqi: jo, jo, ato ne i kemi caktuar vjet bashkë këtu, të gjitha i kemi diskutuar këtu

znj. Kosovare Gacaferi: për pronat komerciale dhe industriale Komisioni Komunal ka paraparë që për 2020 të ketë 5% rritje, ata kanë vleruar dhe e kemi raportin e punës së tyre

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 8 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime kalon

pika e trete

### 3. Raporti nëntë mujor financiar Janar-Shtator 2019

Znj. Kosovare Gacaferi: në vazhdim po prezantoj raportin nëntë mujor financiar me të gjitha shpenzimet dhe të hyrat, ky raport ka pësuar ndryshime për të hyrat nga donacionet në vlerë prej mbi 75,000.00 Euro dhe të hyrat e pa shpenzuara të vitit 2018 të bartura për shpenzim në vitin 2019. Raportin gjëresisht të shkruar para juve e keni të gjithë për ndonjë pyetje eventuale mund të japim sqarime

Znj. Behare Qestaj: së pari të përgëzoj Drejtoreshë për punën që ke bërë në këtë raport, konkretisht si grup nuk kemi vërejtje, unë në faqën 8 të shpenzimet kapitale të alokuara në vlerë prej 565,904.00 Euro ndërsa janë shpenzuar vetëm 157,763.00 Euro, ku është arsyeja që nuk janë shpenzuar këto mjete, diçka tjetër nuk kemi e përkrahim

Znj. Kosovare Gacaferi: po, këto janë qitë në fazën e tenderimit, pasi janë nënshkru kontratat punët janë duke vazhdu, gjatë kësaj periudhe ka pasur punë të kryera e pagesat besoj do të paraqiten në raportin tjetër përfundimtar

z. Tahir Isufaj: me përjashtim të kësaj që është te shpenzimet kapitale, shuma e vogël, nuk kemi ndonjë vërejtje tjetër, nuk e di pse, sepse aty është mosmenaxhimi i mirë faza e tenderimit është dashtë të jetë nga marsi, tash i ka veç edhe një muaj

znj. Kosovare Gacaferi: kanë qenë nga marsi, niher faza e tenderimit, nënshkrimit të kontratës e punët vazhdojnë, kjo është për Janar – Shtator, nuk dmth që në tetor e nëntor nuk ka pas pagesa tjera ato përfshihen në raportin një vjeçar

z. Lulzim Gacaferi: dashta një sqarim shtesë të telefonatave, e kemi diskutuar edhe njëherë këtë temë e keni cek se shpenzime vjetore janë 6853 Euro, në faqe 10 është

znj. Kosovare Gacaferi: ky raport përfshinë edhe pagesën e dy muajve të fundit të vitit 2018

z. Lulzim Gacaferi: ju e dini mirë që në Kosovë, Posta dhe Telekom bënë oferta me minuta dhe internet, me çmime shumë më të lira, nëse ju nuk e bëni këtë punë më autorizoni mua, afërsisht ua sjelli për 1500Euro në vit, nëse e bëni një gjë të tillë, e keni rastin të kurseni dikun 4500-5000Euro para të taksapaguesve tanë. Për automjete e keni cek se 10, 174.00 Euro, i bjen që çdo makinë e Komunës sonë çdo ditë pune i ka shpenzu 37 litra derivate, keni mundësi me i kursy karburantet mos i kurseni për mu po për qytetarët

znj. Kosovare Gacaferi: ka raste që kanë takime apo trajnime dy grupe të zyrtarëve e që shkojnë me dy makina e që është 400 km për të dyjat vajtje ardhje, janë 9 muaj, po ashtu 2 muajt e fundit të vitit të kaluar, po ashtu janë kamionat e zjarrëfikësve dhe autoambulanca

z. Zenel Maloku: pa e ditë numrin e makinave nuk mundesh me nxerrë përgjigje

znj. Leonita Jasiqi: në nivel Kosove ne kursejmë më së shumti sepse nuk e kemi luksin dhe komoditetin me shpenzu, kompania që e kemi kontraktuar thotë që jemi shembull sepse një spital apo një QKMF e një qyteti shpenzon më shumë sesa ne si Komunë

z. Zeqë Hebibi: ka veturë që nuk është dhez që 5 vite e është pronësi e Komunës

z. Lulzim Gacaferi: unë vetëm dua të ju them me kursy për qytetarët e Junikut, një sqarim për shërbime kontraktuese tjera

znj. Leonita Jasiqi: janë punë që kryhen por që nuk kanë kod ekonomik, janë disa materiale shpenzuese që nuk kanë kod ekonomik, p.sh. lulet për varreza

z. Zeqë Hebibi: a bën me e ditë sa vetura funksionale janë në Komunën e Junikut, me zjarrëfiksa e me krejt

znj. Leonita Jasiqi: ua kam sjellur njëherë raportin, mund tua sjelli prapë

z. Zenel Maloku: unë kisha propozu veturat me i ndërru, mos me i mbajtë të gjitha toyota sepse hargjojnë shumë, p.sh. me i mbajtë dy kerre toyota për terren ku janë rrugët e këqija, ndërsa kerret tjera me qenë markë tjetër që hargjojnë më pak

znj. Leonita Jasiqi: edhe ne kishim dashtë me pas vetura tjera më të reja që shpenzojnë më pak, por nuk e kemi atë luks, këto i kemi donacion dhe me to funksionojmë

z. Tahir Isufaj: këto shërbimet kontraktuese te zyra e kryetarit, administrata, zhvillim ekonomik janë shifra shumë të mëdha, po më intereson sa punëtorë i keni kontratë mbi vepër, prej cilave pare ua paguni rrogën

znj. Kosovare Gacaferi: çdo muaj po të përgjigjemi në këtë pyetje, secila drejtori i ka punëtorët e vet të angazhuar

z. Tahir Isufaj: karburantet janë administrata 2274, zyra e kryetarit 1409 euro, regjistrimi i automjeteve veç te zyra e kryetarit 1928 euro, po ashtu një qira që është 660 euro po më intereson çfarë objekti është

znj. Leonita Jasiqi: janë shpenzime për 11 muaj të administratës dhe të drejtorive tjera, ndërsa te zyra e kryetarit janë regjistruar automjete te zjarrëfiksive

z. Hasan Krasniqi: për impiantin e ujërave të zeta kemi qira mujore 220 euro, pagesa e tillë është për 3 muaj

z. Lulzim Gacaferi: ku është ndërtu ajo gropë septike aty, ju keni bërë një kontratë, me ja ndërtu një pjesë të shtëpisë si ka mundësi me pagu qera tash, diçka është ndërtu më duket

z. Hasan Krasniqi: ne nuk kemi pas marrëveshje të tillë, ish kryetari Tahiri mundet me na jep sqarim, nuk kemi gjetë marrëveshje me shkrim, ne ja paguajmë Kujtim Gaxherit 220 euro në muaj

z. Lulzim Gacaferi: mua më intereson shpenzimet që i keni bërë jashtë kuvendit 2340Euro, dua ta di si janë bërë këto shpenzime për udhëtime, kush ka udhëtu, si dhe te reklamat dhe konkurset çka është puna te këto shpenzime

znj. Kosovare Gacaferi: për udhëtime zyrtare nuk është e nevojshme emër e mbiemër, këto janë shpenzime që i lejohen secilit zyrtarë me ligj, ndërsa për reklama dhe konkurse që bëhen e kemi obligative me i qit edhe në gazetë, çdo lloj njoftimi të tillë duhet me e publiku në gazetë normal edhe me e pagu

z. Zeqë Hebibi: subvencion ka qenë për një gazetë, më duket projekti ka qenë 1000Euro, pse me ju jep atij kur paguhen këto

znj. Kosovare Gacaferi: subvencionet janë tjetër e pagesat për reklama tjetër, për reklama duhet në një gazetë që shtypet apo printohet

z. Lulzim Gacaferi: e këto shpenzimet te avokati

znj. Kosovare Gacaferi: ka qenë pagesë që e kemi kontraktu një avokat për një rast të Gjon Lollunit e Komuna e ka fitu atë rast

z. Tahir Isufaj: shërbime kontraktuese, te arsimi fillor dhe arsimi i mesëm, fillori 10,709 Euro, i mesmi 2573 euro

z. Fatos Shala: është transporti i nxënësve, kodi është ashtu pika e katër

4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit ndryshimit të rregullores për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e Komunës së Junikut, leximi i dytë

z. Muharrem Krasniqi: kjo ka kalu në leximin e parë dhe në dëgjim publik, ne e kemi pas edhe në KPF para se me ardhë këtu, i kemi jep disa vërejtje të cilat nuk janë përcjel në material

z. Hysen Imeri: po ka kalu kjo rregullore në leximin e parë, i ka disa vërejtje, i kemi rregullu por për shkak të kohës së shkurtër kuvendi e ka marrë qysh e kemi pas në leximin e dytë në KPF, është bërë ndryshim të preambula apo baza ligjore, sipas Ligjit për Tregtinë e Brendshme, ku ka dal ndryshim plotësimi i ligjit, pra i kemi përdorë të gjitha ligjet dhe rregulloret e reja të cilat janë në fuqi sot. Dita e Diel është ditë pushimi për të gjitha subjektet afariste, po ashtu është edhe zgjatja e orarit të punës së subjekteve afariste, zgjatja do të bëhet për subjektet e cekura në rregullore, të cilët do të bëjnë kërkesën dhe së bashku me kërkesën do të bëjnë edhe arsyeshmerinë për çka dojnë me e zgjatë orarin e punës si dhe do ta bëjnë pagesën në bazë të tarifave që i kemi në rregullore. Të dielën nuk do të punojnë dyqanet zejtare, përveç salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve dhe furrave të bukës, ndërsa depot e materialit ndërtimor në shumë komuna nuk punojnë ditën e diel e as te ne nuk do të punojnë

z. Muharrem Krasniqi: mendoj që një depo duhet me punu të dielën, sepse njerëzit kanë nevojë

z. Hysen Imeri: në nenin 8, orari i punës për gjelltoret dhe qebaptoret është kërkuar nga ora 06:00-24:00, pastaj veprimtaritë në pikën 1 nuk do të punojnë të dielën, përveç dyqanit kujdestar , ndërsa veprimtaritë e tekstilit nuk do të punojnë. Ndërsa veprimtaritë të cilave u lejohet zgjatja e orarit të punës janë hotelet, motelet dhe restaurantet mund të zgjasin punën deri në ora 02:00, kafiteritë dhe disko klubet deri në ora 02:00, ndërsa ato në zona urbane nuk ju lejohet zgjatja e orarit të punës.

Znj. Behare Qestaj: sa i përket kësaj rregulloreje, pasi procedurat konform ligjit janë plotësuar e përkrahim si grup, vetëm unë personalisht në faqen 5 që kam kërku në KPF me e bërë ndryshimin te pika c dhe pika 3 që janë ndesh njëra me tjetrën,

z. Hysen Imeri: është hequr pika c

z. Zeqë Hebibi: po dua me e ditë me kënd ka punu në grup Hyseni për këtë rregullore, mua nuk më kanë ftu asnjëherë, përveç një mbledhje që kemi qenë bashkë, mua nuk më kanë ftu po ashtu e kemi lënë me e thirrë dikënd të bizneseve e kjo nuk ka ndodh, për këtë arsye kjo bjen poshtë

z. Muharrem Krasniqi: është dashtë edhe në lexim të pari ti jepni këto vërejtje

z. Zeqë Hebibi: i kam dhënë, a je taku me dikënd ti

z. Hysen Imeri: të kam thirrë në telefon dhe më ke thënë sjellma rregulloren dhe është në rregull, unë jam takuar me Turimin dhe Venera Shalën

z. Lulzim Gacaferi: te supermarketet neni 9, e keni cek periudha verore nga ora 07:00-23:00, ligjerisht na e kemi obligim me e mbrojtë klasen punëtore, pse duhet me punu deri në oran 11 të natës, a po dojmë me hi në BE, a e keni parë në Evropë si punojnë njerëzit, në shtetet evropiane punohet nga ora 06:00-20:00, mendimi im është deri në ora 20:00 me punu

z. Muharrem Krasniqi: mundet me i mbajtë dy ndërrime, ligji i punës e rregullon këtë

z. Agron Kuçi: te shërbimet gastronimike, gjelltoret e qebaptoret a kanë ndonjë ditë pushim

z. Hysen Imeri: po të dielën

z. Agron Kuçi: është në traditë, në botën demokratike në Evropë, shërbimet e gastronomisë e kanë një ditë pushim, nuk dmth që e kanë të shtunën apo të dielën, mundet me qenë në lirinë e secilit subjekt të gastronomisë cilën ditë, por një ditë në javë duhet me e pas pushim, ditën ta zgjedhin vet cilën, por një ditë gjithsesi obligativ

z. Zeqë Hebibi: e kemi diskutu këtë, ky material duhet të kthehet nga fillimi dhe të punojmë në grup

z. Zenel Maloku: në ETC këtu, punëtori e ka një ditë pushim, nuk është e thënë të dielën, por çka është më e keqja se dy ndërrimet shkon deri në 11 të natës, po ashtu pas orës 11 deri ti dorëzojnë raportet pra e kalon 8 orëshin ndërrimi

z. Muharrem Krasniqi: ne vetëm për orar të punës e kemi, këto tjerat i rregullon ligji i punës

z. Agron Kuçi: a e keni shiquar edhe kohën verore dhe dimërore

z. Hysen Imeri: po është e cekur

z. Muharrem Krasniqi: pasi ka shumë vërejtje, komisioni të takohet prapë për këto vërejtje, e hedh në votim dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime nuk kalon kjo rregullore dhe kthehet prapë te grupi punues për përmirësime

5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm për vitin 2018,

Znj. Kosovare Gacaferi: Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, e ka miratuar një rregullore të punës së tyre për vitin 2019, ku është paraparë që të bëhet një ndryshim, dmth këtë plan që e kemi dërgu për shqyrim është plan që dorëzohet 30 ditë pasi që ta pranojmë Raportin e Auditorit Gjeneral çdo vit, ne e kemi dorëzu, ata e kanë parë të nevojshme të shqyrtohet në Kuvend dhe dy herë në vit të raportohet se deri ku kemi arrit me zbatim të rekomandimeve Komunat. Pra ne jemi duke e punu raportin, ndërsa planin e kemi sjellë këtë muaj për shqyrtim, gjatë korrikut këtë e

kemi dorëzuar në zyrën e Auditorit Gjeneral, tash e kemi sjellë për shqyrim planin që të mos marrim rekomandim.

Znj. Behare Qestaj: ne si grup e përkrahim këtë plan të veprimit, sepse është një plan vërtetë i nevojshëm për Komunën e Junikut, që të ndërmerret diçka për planifikimin e këtyre rekomandimeve që i ka dhënë Auditori i Jashtëm, vetëm kisha kërku nga Drejtoresha që pas kalimit të këtyre afateve që i ke jep në plan të veprimit me na jep një raport se a janë plotësuar ato rekomandime, përndryshe e përkrahim

Znj. Kosovare Gacaferi: po në bazë të asaj rregulloreje, dy herë në vit jemi të obliguar me raportu

z. Tahir Isufaj: Auditori i Jashtëm ka gjetë vërejtje jashtëzakonisht të mëdha, që ish dashtë që dikush me u thirrë në përgjegjësi, jo veç po përmirësohemi, unë e kam kqyrë në detale, janë lëshime që nuk ish dashtë me u bërë.

Znj. Kosovare Gacaferi: Raporti i Auditorit ka qenë i pa modifikuar që është mirë për neve, me theksim të çështjes për moskompletim të listës së pasurisë, që është problem i përgjithshëm në nivel vendi, e këto tjerat kanë qenë me prioritet të ulët dhe të mesëm

z. Muharrem Krasniqi: raporti i pamodifikuar është më i miri, mundeni me i gjetë në internet janë raportet për të gjitha Komunat, është një ndër raportet më të mira që i ka ardhë Komunës sonë në krahasim me Komunat e tjera.

Pika e gjashtë

## 6. Të ndryshme

z. Muharrem Krasniqi: materialin që e ka kërku profesori Tahir, për ujt që është marrë, keni raport të detajuar që e ka përgatit Drejtori Myrtë Velijaj, unë në bashkëpunim me Kryetarin kisha me jep një propozim që të krijohet një shtab i emergjencës për krizën që ka ndodh në Shqipëri, mund të na kërkohet që të vijnë qytetarë nga atje, ose ndihma tjera, unë po propozoj që në këtë ekip të emergjencës të jenë katër anëtarë të partive, dhe 3 nga ekzekutivi, e hedh në votim dhe konstatoj se me 15 vota për, 0 kundër, 0 abstenime formohet ky shtab i emergjencës, ju lutem emrat, u propozuan Afrim Hoxha, Albert Gjocaj dhe Zeqë Hebibi. Kërkesën e prof Tahirit a doni me e shqyrtu tani apo e merrni me vete. Po ashtu Drejtori i Zhvillimit Ekonomik, ua dorëzoj raportin me shkrim për gjendjen e pyjeve.

z. Tahir Isufaj: e marrim dhe e shikojmë në detale

z. Lulzim Gacaferi: e kam një pyetje për Kryetarin pasi që është këtu, është thënë në fushatë në vitin 2017 se ujt në Lagjen Agim Ramadani do të jetë të Junikut, që e pijmë edhe ne, pra keni premtu që do ta sjellni ujësjellësin e Junikut në atë lagje

z. Agron Kuçi: ne e kemi të paraparë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik bashkë me Hidrodrinin, sivjet kemi pas me e zbatu marrëveshjen, megjithatë nuk është zbatu, ata kanë ndarë

mjete por jo të mjaftueshme për këtë çështje, ndërsa ne do të shikojmë mundësitë vitin e ardhshëm ose nga GIZI ose nga DEMOSI

z. Lulzim Gacaferi: pra vitin e ardhshëm përfundon a

z. Agron Kuçi: po, fjalët i kemi pas për sivjet por nuk është bërë

z. Lulzim Gacaferi: po ashtu një sqarim shtesë ma kan lyp qytetarët, ne i kemi disa invalidë që kanë luftu për çlirimin e atdheut, dikush e ka humb dorën dikush këmbën, disa kanë edhe afarizëm të hapur e kemi një është Qamil Jasiqi, ligji e parasheh që nëse është invalid bile tatimin mbi pronën me ja lehtësu a kemi mundësi që së paku këta njerëz me i fal nga ky tatim shtesë.

Znj. Kosovare Gacaferi: po i kemi tre raste të tilla, p.sh. ligji i veteranëve e invalidëve i liron këta, por Ligji i tatimit në pronë nuk e liron askënd, pra ka qenë konflikt ligjesh që nuk ka qenë e rregulluar nga niveli lokal por ai qendror, unë ju kam drejtu departamentit të tatimit në pronë për këtë çështje a kemi mundësi me i liru nga tatimi në pronë, më kanë thënë që nuk e parasheh ligji me i liru

z. Zenel Maloku: tatimi në pagë për invalid nuk bëhet, për tjerat nuk e di

znj.Behare Qestaj: e kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë, në QKMF a ka aparat të EKG-së, dikush thotë ka e dikush nuk ka

z. Zenel Kuçi: po ka është donacion, nuk e di për momentin a është në funksion

z. Agron Kuçi: e kemi aparatën e EKG-së nga Norvegjia, unë e di që funksionon

z. Zenel Maloku: unë e kam një pyetje për punën e taksistave, në qendër kur po vjen autobusi po nalet aty po bën pengesë në komunikacion, a ka mundësi masi u bo me i liru trotuaret me i hek edhe taksistat prej atyhit me i qu te autobusat atje poshtë

z. Lulzim Gacaferi: e kemi bërë prerjen e asfaltit në lagjën tonë, por pasi e pash edhe në lagje tjera asfalti shumë i dëmtum, unë e kam bërë një pagesë ku e kam prerë asfaltin për me u riasfaltu ajo pjesë e ato punë ende nuk janë bërë, po ashtu i pash disa shtylla elektrike të rrëzuara rreth qendrës shëmtim i panevojshem ishte

z. Agron Kuçi: ju e dini se çdo prerje e asfaltit ka kosto, këtë vit kemi kërkesa mbi 200% me e pre asfaltin pagesën nuk e bëjnë, ne ua kemi refuzu disa herë sepse kanë pasur kyqje të rrymes e të ujit, tash kompanitë nuk vijnë për aq pak me e asfaltu duhet me pritë deri të ka asfaltime më të mëdha

z. Lulzim Gacaferi: mua më është thënë se duhet bërë pagesën dhe ne e bëjmë asfaltimin, është dashtë mem thënë që asfaltimin duhet me e bërë vet, është anomali kjo

z. Hasan Krasniqi: nuk është anomali sepse kur po prehet asfalti kurrë nuk po bëhet si ka qenë më parë

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka tjetër, nëse jo me kaq e mbylli këtë seancë

Seanca përfundoi me punë në ora 15:20

E përgatiti  
z. Turim Ganiqaj

---

Kryesues i Kuvendit  
z. Muharrem Krasniqi

---



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                       |                                                       |
|-----------------------|-------------------------------------------------------|
| REFERENC-Ë:           | Numër: 02– 12/19                                      |
| PËR/ZA/TO:            | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik                     |
| NGA/OD/FROM           | Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A                | 27.12.2019                                            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal                                          |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

### **PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dymbëdhjetë të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut për vitin 2019 me datë: 27.12.2019, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti, Kryetarin e Komunës z. Agron Kuçi, nënkryetarin z. Faik Tofaj, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm

## Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi -kryesues,AAK
2. Behare Qestaj – anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj – anëtar, AAK
6. Dardane Shala – anëtare, AAK
7. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK
8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK
9. Erleta Isufaj – anëtare, LDK
10. Edona Shehu –anëtare, LDK
11. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK
12. Lulzim Gacaferi- anëtar, VV
13. Kreshnik Maloku – anëtar, PDK
14. Zenel Maloku- anëtar, i pavarur

## Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të Punës së Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2020,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e orarit të mbledhjeve dhe takimeve të Kuvendit Komunal të Junikut për vitin 2020,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Zhvillimit Institucional të KPSH-së 2020-2024 (plotësim ndryshim pas leximit të dytë),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim ndryshimit të Rregullores për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut,
7. Kërkesë për ndërrimin e destinacionit të tokës nga z.Agim Kapell,
8. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve nga Auditimi i Jashtëm për vitin 2018,
9. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: a e don dikush fjalën sa i përket rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime miratohet ky rend dite

pika e parë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: unë e kam lexuar provesverbalin, nuk kam ndonjë vërejtje personalisht, nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit fjala për ju

z. Lulzim Gacaferi: e pata cek seancën e kaluar, tek shpenzimet e derivateve, kam thënë që 24 orë nuk punojnë të gjitha veturat, por një veturë që ecën sipas llogaritjeve i shpenzon 37 litra çdo ditë, një makinë mesatarisht jo të gjitha.

z. Muharrem Krasniqi: kërkoj nga procesmbajtësi ta mbajë shënim, do të rregullohet, a ka dikush diçka tjetër rreth procesverbalit nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon, me vërejtjet e Lulit

pika e dytë

2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020

Znj. Dardane Shala: besoj që dokumentin orientues për kryerjen e aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2020 e keni pranuar dhe e keni lexuar. Ky dokument mundet me pas ndryshime varësisht nga nevojat që paraqiten ndërkohë, jam munduar me i cek disa pika që kanë të bëjnë kryesisht me interesat e qytetarëve të Junikut, pasi që nuk kemi minoritete

z. Muharrem Krasniqi: unë të falenderoj për punën që ke bërë me gjithë grupin, për planin që e keni sjellë, është diçka tjetër që nuk kemi komunitete, por janë disa çështje tjera praktike, mua më ka pelqy si plan pune

znj. Behare Qestaj: sa i përket këtij plani të punës ne e kemi diskutu edhe në KPF, nuk kemi pas vërejtje, e përgëzoj Dardanën me gjithë grupin që kanë punu kështu që e përkrahim këtë plan

z. Tahir Isufaj: nuk mundemi me ndryshu asgjë, sepse nuk kemi komunitete

z. Lulzim Gacaferi: nuk kam diçka për të shtuar

z. Muharrem Krasniqi: a e don dikush tjetër fjalën sa i përket këtij plani, nëse jo e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon ky plan

pika e tretë

3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të Punës së Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2020

z. Esat Hoxha: planin e punës e kemi dorëzu me kohë, e keni përpara, mundeni me e lexu dhe ndonjë vërejtje apo sugjerim që keni do ta marrim parasysht

z. Muharrem Krasniqi: unë të falenderoj për punën që keni bërë, i keni cek disa nevoja që janë të arsyeshme dhe të nevojshme për komunën tonë

znj. Behare Qestaj: e përgëzojmë z. Esatin për punën që ka bërë, vërtetë i ka prek disa tema që kanë nevojë me u trajtu për këtë komunitet pra për personat me aftësi të kufizuara, ne si grup e përkrahim.

z. Tahir Isufaj: e përkrahim

z. Muharrem Krasniqi: nëse keni ndonjë pikë e sjellni dhe e shtim në rend dite, siç është qasja në ambulantë dhe në këto tjerat e kemi parë shumë të rëndësishme, nëse ka mundësi ekzekutivi që të intervenoj që tu bëhet sa më e lehtë këtyre personave

z. Lulzim Gacaferi: i përgëzoj komitetin, me të vërtetë janë pika për të cilat kjo kategori kanë nevojë tërë kohën, andaj ne e përkrahim

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

pika e katër

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e orarit të mbledhjeve dhe takimeve të Kuvendit Komunal të Junikut për vitin 2020

z. Muharrem Krasniqi: këtë propozim e kam bërë unë në marrëveshje me kryetarin si qelës

është marrë me qenë dita e fundit e muajit, përveç rasteve kur ka me u dorëzu ndonjë material në ditën e fundit të muajit, pra është fjala për ditë pune, ose në rastet kur binë festat si p.sh. në fund vit

znj. Behare Qestaj: ne si grup nuk kemi vërejtje në këtë propozim vendim

z. Tahir Isufaj: unë e kam një vërejtje, mirë kish me qenë me qenë një ditë kështu, përndryshe janë krejt ditë të javës, më lehtë kish me qenë për ne me e mbajtë në mend, p.sh. dita e premtë

z. Muharrem Krasniqi: kemi pas probleme ashtu, ndonjëherë na bjen shumë larg. P.sh data 24 ose shumë afër, është një problem tjetër që duhet me u përgatitë materiali për KPF, ku deri me datë 11-12 vijnë pikat e rendit të ditës e materiali dërgohet 7 ditë përpara edhe 7 ditë në kuvend dmth 14 ditë, plus 2 ditë që mbahen mbledhjet prandaj është problem sepse ka mundësi me ra me 23-24 e premtë

z. Zenel Maloku: unë po pajtohem me këto fjalë e pika, vetëm nuk jam pajtu me orar të mbledhjes, sepse shumë herë e kemi cek mbledhja me u mbajtë në ora 10:00, jo në ora 14:00, sepse kam thënë shumë herë që po kemi probleme me këtë kohë

z. Muharrem Krasniqi: nëse pajtohemi të gjithë e ndryshojmë, nëse jo e lëjmë këtë orar, sepse është fundi i orarit të ditës 14-16 e nuk dëmtohet orari

z. Zenel Maloku: po, por dikush në ora 14:00 ndoshta ka me e fillu punën

z. Muharrem Krasniqi: po edhe në ora 10:00 ndoshta dikush tjetër e fillon punën

z. Zenel Maloku: puna fillohet në 08:00 kryhet në 14:00, askush nuk e fillon në ora 10:00

z. Muharrem Krasniqi: kjo është kompetencë e imja, me rregull as nuk votohet, orarin e caktojmë unë dhe Kryetari, por ju nëse pajtoheni të gjithë, propozoni një orar dhe e hedhim në votim, e hedhi në votim këtë propozim vendim, së pari kush është me e ndryshu orarin me e bërë të gjitha të premtëve, konstatoj se 5 janë për, 9 kundër, 0 abstenime nuk kalon ky propozim i profesorit Tahir. Tash e qes në votim kush është për me mbetë ky plan si është 9 për, 5 kundër, 0 asbtenime miratohet ky orar

pika e pestë

##### 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Zhvillimit Institucional të KPSH-së 2020-2024 (plotësim ndryshim pas leximit të dytë)

z. Muharrem Krsniqi: ne e kemi kalu në leximin e dytë, Ministria e Shëndetësisë na ka kthyer ka thënë që Komuna nuk ka të drejtë me bo strategji, ekipi punues ka punu dhe i ka ndryshu vetëm titullin dhe i ka shtu disa anekse ekonomike, pra është i njejt material që e kemi kalu, sepse pa një plan Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF në Junik, nuk po munden me marrë fonde e investime nga të huajt

znj. Behare Qestaj: nuk kemi vërejtje, sepse i kemi dhënë në lexim të parë dhe të dytë, e pëkrahim



z. Tahir Isufaj: e vetmja vërejtje është që pasi aty ishin 32 të punësuar, mirë kish me qenë me qenë shërbimi 24 orë

z. Lulzim Gacaferi: kishte me qenë mirë me punu 24 orë, sepse kryetari në fushatën elektorale 2017 ka premtu që QKMF do të jetë 24 orë në shërbim të pacientave të Komunës së Junikut

z. Zenel Maloku: unë mendoj që edhe Kryetari ka dëshirë me qenë 24 orë, me kon në pyetje veq të kryetari e të Junikasit e të Komuna, e kam atë bindje që të gjithë kanë dëshirë me punu 24 orë, po ajo nuk varet prej neve, ne e kemi me borxh Kryetari me njerëzit e vet me i bërë kërkesat në Prishtinë atje sa të mundet, e a bëhet varet nga ata atje

z. Muharrem Krasniqi: mbledhjen e ardhshme do të jetë këtu Drejtori dhe do të kemi informata lidhur me këtë, e hedh në votim dhe konstatoj se me 14 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon kjo pikë

pika e gjashtë

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim ndryshimit të Rregullores për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e Komunës së Junikut

z. Muharrem Krasniqi: këtë rregullore e kemi kalu në lexim të parë, në lexim të dytë e kemi kthyer për disa ndryshime

z. Hysen Imeri: ne i kemi mbajtur edhe dy mbledhje me grupin punues, ku e kemi pas një vërejtje ne faqe 2 te neni 8, ku e kemi bërë orarin nga ora 05:00-20:00 ndërsa ka qenë nga ora 06:00-20:00 për periudhën verore. Nuk kemi pas ndryshime tjera

znj. Behare Qestaj: ne e përkrahim këtë rregullore

z. Lulzim Gacaferi: i kam dy vërejtje faqe 2 neni 5 dhe faqe 3 neni 9, subjektet e tregtisë me pakicë mund të punojnë nga e hëna deri të shtunën dhe atë, qka keni mendu me këtë dhe atë

z. Hysen Imeri: dhe atë është nën a dhe nën b, kohën verore dhe dimërore

z. Lulzim Gacaferi: ne jemi asamble komunale e kemi edhe kryetarin këtu, jemi të obliguar që punëtorët të mbrojmë e jo të dëmtojmë duke punuar nga ora 06:00-24:00 duke pas parasysh që njerëzit që punojnë këtu diskriminohen nga A deri në ZH

z. Muharrem Krasniqi: ky është orari sa punon, i ka puntori 40 orë në javë, ai përgjigjet para inspektoriatit me sa ndërrime e ka është problem i tij. Ai ka të drejt me e mbajtur lokalitetin që në këtë orar, nuk jemi lëshu në atë sa punëtorë e sa orë i mbanë

z. Lulzim Gacaferi: ne po pretendojmë që të integrohemi në struktura evropiane, nëse vazhdojmë kështu po e degradojmë vetën tonë, institucionin tonë dhe po i dëmtojmë punëtorët tanë orari i punës zgjat nga ora 06:00-20:00 atje jetoj e kësaj po i referona, unë dua me i mbrojtë punëtorët që punojnë, kjo mbrohet me orar të punës. Po ashtu e kam një vërejtje të orarit të punës të

ndërmarrjet ndërtimore, ndërtimet e ulëta dhe të larta, është faqe 3 neni 9 periudha verore nga ora 7 deri në ora 18 kurse periudha dimërore nga ora 08 deri në 17, unë e kam kështu të shkruar ndoshta janë gabim,

z. Muharrem Krasniqi: unë e kam ndryshe, ndoshta gabim në material, sipas këtij neni kështu e kemi ne tjerët orari i punës për periudhën verore është 07-20, ndërsa periudha dimërore 08-18, kështu e kemi ne

z. Lulzim Gacaferi: unë e kam ndryshe, ju e dini që punëtorët që bëjnë punë fizike, sipas ligjeve evropiane ata punojnë vetëm 8 orë në ditë dhe mbrohen ligjrisht në çdo formë, ju e dini që punëtorët që e bëjnë punën e ndërtimit në Kosovë, fillojnë në ora 7 e mund të zgjat deri në ora 20, pse nuk e keni cek periudhën verore nga ora 7-15, pse nuk është cek se punëtorët që punojnë në këtë sektor të dielën ta kenë pushim, këta që punojnë në ndërtim tu zvogëlohet orari i punës, mos ti diskriminojmë këtë klasë punëtore të cilët çdo ditë po ikin nga ky vend

z. Hysen Imeri: e kemi cek që është pushim ti e paske rregulloren e vjetër

z. Muharrem Krasniqi: kjo rregullohet me rregullore të punës, orët shtesë paguhen janë të cekura krejt, është punë e inspektoriatit me i kontrollu, ndërsa për gabimet në material herën tjetër të kontrollohen më mirë Naim

z. Zenel Maloku: mua po më intereson për këto ndërmarrjet e ndërtimit komuna a ka inspektoriat me dal me i kontrollu a janë ata punëtorë të siguruar apo jo, a paguan shefi i tyre sigurimin e tyre dhe si janë me letra

z. Muharrem Krasniqi: nuk është kjo pikë për këtë punë, por vetëm me e caktu orarin e ndërmarrjeve sa kanë të drejtë me punu, e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 1 kundër, 0 abstenime kalon

pika e shtatë

## 7. Kërkesë për ndërrimin e destinacionit të tokës nga z.Agim Kapell

z. Hasan Krasniqi: në bazë të kërkesës së znj. Sevdije Dervishaj e më vonë edhe të z.Agim Kapell, kuvendi i Komunës së Junikut e ka marrë vendimin paraprak për ndërrimin e destinimit të kulturës së tokës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, me datë 20 nëntor kemi marrë edhe pelqimin prej Ministrisë përkatëse, kërkojmë nga ju miratimin e vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit nga tokë bujqësore në ndërtimore për parcelat i keni në material bëhet fjalë për 79 ari dhe 9 metra, janë plotësu të gjitha kriteret në bazë të ligjit dhe PZHK dhe PRRU

znj. Behare Qestaj: e kam një pyetje në emër të grupit, kërkesën e keni për dy parcela , në këtë material është edhe e treta parcelë, a ka mundësi me na sqaru votimi jonë a shkon për dy apo tre parcela, sepse herën e parë kemi votu për dy ndërsa tani janë tre parcela, nëse mund të na sqarosh për çka po votojmë

z. Hasan Krasniqi: në kërkesën me të cilën ju kam drejtu dhe në pelqimin e paraparë bëhet fjalë për dy parcela, parcela e tretë është kur është nxerrë certifikata e pronës dhe kopja e planit ai i ka pas ato parcela dhe nuk i kemi përjashtu, ajo është certifikata e pronës që ai ka pasuri edhe tjera, por që nuk do ti nënshtrohen ndërrimit të kulturës, pra bëhet fjalë për dy parcela të cilat i keni votu edhe herën e parë

znj. Behare Qestaj: pasi janë dy parcelat që janë në kërkesë e që i kemi votu edhe herën e parë, ne si grup e përkrahim

z. Tahir Isufaj: unë edhe në KPF kam qenë kundër, sepse kur kam kqyr në hartë e kam parë që toka është pothuajse në zemrën e tokës bujqësore të Junikut, nëse ja nisim të gjitha ato toka me i shëndërru në ndërtimore nuk e di nga çka kemi me jetu më vonë, bazën e jetesës e kemi nga bujqësia, kështu edhe atje për bagera i pata thënë këtij drejtorit tha veç po rrafshohet toka bujqësore, le u rrafshu por u bënë edhe tunele aty. Sipas statistikave të para 10-15 vjete, Juniku i ka pas dikun 1200 shtëpi, ndërsa me statistika të sotit rreth 500 shtëpi janë të zbrazta

z. Hasan Krasniqi: ju e keni shtëpinë në zemër të tokës bujqësore, qëllimi jonë është në Junik me u bërë më shumë shtëpi, gjithnjë sipas kriterëve të percaktuara me ligj e jo si në të kaluaren pa kriterë

z. Zenel Maloku: pasi e kemi votuar herën e parë për ata tjerët, nuk është mirë me u koritë, ndërsa toka bujqësore më shumë është ka mbetë therra e bagrena sesa që është ka punohet, është ka don me u bo mal krejt, kështu më mirë me u bërë ndërtesa bile hijeshohet vendi

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 për, 4 kundër, 0 abstenime kalon

pika e tetë

8. Shqyrtimi i raportit për zbatimin e rekomandimeve nga Auditimi i Jashtëm për vitin 2018,

Znj. Kosovare Gacaferi: në bazë të rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planit të veprimtimit që janë marrë nga zyra e auditimit gjeneral, është kërku nga komunat me raportu dy herë në vit me planet për zbatimin e rekomandimeve. Nga 12 rekomandime që i ka pasur Komuna e Junikut për vitin 2018 ne i kemi zbatuar 7 e 5 janë pjesërisht të zbatuara. Raportin e keni para vetës mund të shqyrtoni

Znj. Behare Qestaj: dua ta përgëzoj Kryetarin e Drejtoreshën e stafin, për zbatimin e këtyre rekomandimeve që i ka jep auditori i jashtëm, shpresoj në të ardhmen edhe këto pjesërisht të zbatohen plotësisht

z. Tahir Isufaj: auditori i jashtëm çka të shkruan ose ki me e zbatu ose me ja nu qelsin, por neve na duhet me gjetë të gjetura sa më pak, e nëse ka shkelje a ka marr dikush vërejtje

z. Lulzim Gacaferi: ne e dim si kanë lëvizur gjërat, nuk po shtoj diçka më shumë se çka tha Profesori



pika e nëntë

## 9. Të ndryshme

z. Lulzim Gacaferi: i kam disa pyetje

z. Muharrem Krasniqi: me rregullore ki të drejtë dy pyetje

z. Lulzim Gacaferi: pasi është Kryetari këtu, asnjëherë nuk ta parashtroj pyetje në aspektin individual por si Kryetar Komune për hir të qytetarëve të Junikut, ju keni premtuar gjatë fushatës së vitit 2017 se me ardhjen tuaj si kryetar Komune për herë të tretë, që Junikasit do e kenë një shtëpi të kulturës, kur keni planifiku që kjo të ndërtohet meqenëse ne një shtëpi të kulturës e kemi pas paralufte, pyetja tjetër është: ju keni thënë që ambulanta ka me funksionu 24 orë në shërbim të pacientëve të Komunës së Junikut, pse nuk është bërë, kur pritet me u bo 24 orë, unë e di dhe kam informacion që është një aparat rentgen që quhet i cili ka ardhë si donacion, e keni ndërtu një dhomë të posaçme për atë aparat, është një djalë që punon aty Aziz Miroci, por rentgeni nuk funksionin na është thënë vitin e kaluar që rrymë nuk ka të mjaftueshme, tash rrymen e keni sjellë, e dëshiroj të di se kur ky aparat do të jetë në shërbim të pacientëve të Komunës së Junikut, e kisha një rast me një kusheri me të ardhja të vogla ekonomike shkova i ndihmova dhe i paguva 30 euro për të, kërkoj që të funksionalizohet sa më shpejtë ajo aparaturë për pacientat e Komunës së Junikut.

z. Tahir Isufaj: masi kryetari dhe drejtori janë këtu, rruga nga lagja anej si po ndertohet kush po investon dhe sa është vlera

z. Agron Kuçi: rruga Junik-Prejlep- Dranoc-Sllup financohet nga Ministria e Infrastrukturës, ndërsa për vlerën e saj nuk e di saktësisht. Interes ka kjo rrugë sepse i lidh katër vendbanime, nuk e di që ndonjë rrugë në Junik ka mbetë pa asfaltu. Ndërsa edhe Kryetari i Komunës dikund duhet me e pas tokën, ma gjeni një shtëpi apo një fermë bujqësore në Junik që nuk e ka rrugën e asfaltuar. Ndërsa sa i përket pallatit të kulturës, lokacionin e kemi të përshtatshëm ku ka qenë edhe kooperativ dikur është shëndërru kinema, kemi pas zotime shumë të forta se kanë me na dhënë grand, që kanë me e ndërtu pallatin e kulturës, projektin e kemi nga viti 2011

z. Lulzim Gacaferi: kur do të realizohet

z. Agron Kuçi: unë kam besu që sivjet do ta nënshkruajmë me Ministrin e Kulturës, por Ministri nuk ka qëndru në fjalë, këtë mandat patjetër do ta nisim në atë lokacion. Sa i përket QKMF-së, ne kemi marrë shumë aparate donacion, rrymen e kemi stabilizu, përveç kësaj këtë vit e kemi dërgu edhe një gjenerator të ri. Aziz Miroci është teknik por i ka pas disa trajnime për rengten, a funksionon nuk e di do të angazhohem për këtë çështje

z. Muharrem Krasniqi: është aparati që punon me filma digjital, që e marrin mjekët direkt fotograimin

z. Lulzim Gacaferi: e ndiva vetën keq për atë kusheririn tim, ai aparat duhet të funksionalizohet, si dhe ambulanta a do të punoj 24 orë

z. Hasan Krasniqi: ai projekt është në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal Junik-Deçan është dikun rreth 200,000 Euro nuk jam i sigurtë saktësisht por aty dikun

z. Agron Kuçi: po do të punoi

z. Zeqë Hebibi: a ka mundësi Kryetari me ja bërë një kërkesë stacionit Policor të Junikut, gjatë këtyre 2-3 jave që janë bashkëatdhetarët mos me ju nxjerrë probleme për parking. E kam parë një rast që i kanë marrë me familje me gru e fmi e i kan qu në polici, kjo është shumë e keqe

z. Agron Kuçi: natyrisht që do ta bëjmë një kërkesë për këtë periudh të festave

znj. Behare Qestaj: e kam një kërkesë për një gropë që është hap te xhamia, nëse munden me e rinovu apo zhavor me e mbushë, pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, qytetarët po ankohen për atë gropë sepse është në mes të rrugës

z. Myrtë Velijaj: është një gyp aty, por besoj që do të intervenojmë së shpejti ka mundësi sot

z. Zeqë Hebibi: edhe dy shakte janë mbetë pa kapak po bijnë njerëzit në to

z. Lulzim Gacaferi: po ashtu Kryetari ka premtu në vitin 2017 ujin e pijshëm për lagjen Agim Ramadani

z. Agron Kuçi: kemi shpresu këtë vit, por besoj në vitin 2020 do të fillojmë me atë projekt

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka tjetër, nëse jo me kaq e mbylli këtë seancë

Seanca përfundoi me punë në ora 15:00

E përgatiti  
z. Turim Ganiqaj

Kryesues i Kuvendit  
z. Muharrem Krasniqi

---

---